



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DEKLARATA E RISQEVE FISKALE

PËR VITIN **2024**

Tiranë 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

Akronime	5
Përmbledhje Ekzekutive	6
Hyrje	8
1. Treguesit Fiskal	9
2. Risqet Fiskale të Lidhura me Zhvillimet Makroekonomike	12
2.1. Zhvillimet makroekonomike në vend	12
2.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës	13
2.3. Të dhëna analitike	15
3. Risqet e Lidhura me Shpenzimet e Përgjithshme dhe Detyrimet e Prapambetura	16
3.1. Planifikimi i Shpenzimeve Buxhetore	16
3.1.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës	16
3.1.2. Risqet e mundshme	17
3.1.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara	17
3.1.4. Të dhëna analitike	17
3.2. Shpenzimet Buxhetore për Investimet Publike	18
3.2.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës	18
3.2.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës	18
3.2.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara	19
3.2.4. Të dhëna analitike	20
3.3. Menaxhimi i Shpenzimeve Buxhetore	20
3.3.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës	20
3.3.2. Risqet e lidhura me performancën e zbatimit të buxhetit	21
3.3.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara	21
3.3.4. Të dhëna analitike	22
3.4. Detyrimet e Prapambetura	23
3.4.1. Menaxhimi i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura	23
4. Risqet Fiskale të Lidhura me Borxhin Publik dhe Mjetet Monetare Disponibël	25
4.1. Borxhi Publik	25
4.1.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës	25
4.1.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës	25
4.1.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara	27
4.1.4. Të dhëna analitike	28
4.2. Mjetet Monetare Disponibël	29

4.2.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës	29
4.2.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës	30
4.2.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara	30
4.2.4. Të dhëna analitike	30
5. Risqe Fiskale të Lidhura me Financat Vendore	31
5.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës	31
5.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës	31
5.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara	33
6. Risqet Fiskale të Lidhura me Koncesionet/PPP me mbështetje buxhetore	35
6.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës	35
6.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës	36
6.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara	37
7. Risqet Fiskale të Lidhura me Ndërmarrjet Publike me Kapital Shtetëror	38
7.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës	38
7.1.1. Sektori Energjetik	41
7.1.2. Detyrimet e ndërsjella të Ndërmarrjeve të Sektorit Energjetik/MF/DPT dhe ML/IB	43
7.1.3. Risqet e sektorit energjetik	43
7.1.4. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara	44
7.2. Ndërmarrjet e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve	44
7.3. Të tjera	46
8. Risqet Fiskale të Lidhura me Detyrimet Kontingjente	47
8.1. Vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)	47
8.2. Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit	47
8.3. Vendimet gjyqësore administrative, të formës së prerë (Qendrore + Vendore)	49
9. Risqet Fiskale të Lidhura me Fatkeqësitë Natyrore	50
9.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës	50
9.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës	50
9.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara	52
9.4. Rekomandime për përmirësime të mëtejshme	53
9.5. Sfidat	54

Grafiku 1. Produkti i Brendshëm Bruto dhe Borxhi Publik Bruto në % të PBB-së për vitet 2019-2027.....	8
Grafiku 2. Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve në % të PBB-së, Balanca primare në % të PBB-së dhe Deficiti në % të PBB-së, për vitet 2019-2027 (plan vitet 2025-2027).....	9
Grafiku 3. Devijanca e shpenzimeve sipas PBA-së krahasuar me buxhetin fillestar vjetor.....	16
Grafiku 4. Devijanca e shpenzimeve kapitale sipas PBA-së krahasuar me buxhetin fillestar	18
Grafiku 5. Plani dhe fakti i shpenzimeve korente për vitet 2020-2024 (në miliardë lekë).....	22
Grafiku 6. Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme	23
Grafiku 7. Garancitë sipas sektorëve	28
Grafiku 8. Detyrimet e prapambetura në nivel vendor.....	31
Grafiku 9. Transferata e pakushtëzuar në periudhën t-3 deri në t+2 dhe ritmi i ndryshimit të saj	32
Grafiku 10. Ndarja e kontratave me mbështetje buxhetore sipas sektorëve	35
Grafiku 11. Shpenzimet buxhetore për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore	36
Grafiku 12. Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve	38
Grafiku 13. Ecuria e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore (Qendrore + Vendore).....	49
 Tabela 1. Zërat kryesor të të ardhurave dhe shpenzimeve, për vitin 2024	10
Tabela 2. Zërat kryesor të të ardhurave dhe shpenzimeve (Fakt 2024/Plan 2025).....	11
Tabela 3. Parashikimet alternative për secilin skenar	15
Tabela 4. Shpenzimet totale sipas PBA-së për periudhën 2020-2027 dhe buxheti fillestar.....	17
Tabela 5. Shpenzimet kapitale për periudhën 2021-2027 dhe buxheti fillestar	20
Tabela 6. Treguesit e riskut	28
Tabela 7. Pagesat dhe Kthimet e Garancive të Huaja	28
Tabela 8. Pagesat dhe Kthimet e Garancive të Brendshme.....	28
Tabela 9. Devianca Janar-Dhjetor 2024 e gjendjes së TSA.....	30
Tabela 10. Treguesi i performancës sipas strategjisë së PFM 2023-2030.....	30
Tabela 11. Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor në periudhën t-3 deri në t+2.....	33
Tabela 12. Koncesionet/PPP aktive me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit	36
Tabela 13. NSH-të në pronësi të MEKI dhe MIE për vitin 2024	39
Tabela 14. NSH-të e monitoruara për vitin 2024.....	39
Tabela 15. Treguesit ekonomik dhe financiar lidhur me NSH-të kryesore dhe dy entiteteve të tjera (jo me status sh.a) të monitoruara për vitin 2024, në milionë lekë.....	40
Tabela 16. Detyrimet nënhua dhe garanci të ndërmarrjeve shtetërore ndaj MF.....	41
Tabela 17. Subvencionet për ndërmarrjet shtetërore nga viti 2016-2024.....	41
Tabela 18. Mbështetja buxhetore e sektorit të energjisë (plan/fakt) për periudhën 2022-2024.....	42
Tabela 19. Të dhëna mbi impaktin e sektorit të energjisë në financat publike	42
Tabela 20. Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarrjeve të sektorit energjetik, ML/IB,MF dhe DPT	43
Tabela 21. Shoqëritë Ujësjellës-Kanalizime me stokun më të lartë të detyrimeve të prapambetura (principal) ndaj OSHEE Group sh.a, për 12M 2024	45
Tabela 22. Detyrimet nga vendimet e GJEDNJ-së (në euro) deri në fund të vitit 2024	47
Tabela 23. Detyrimet për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në euro).....	48
Tabela 24. Tabela e fatkeqësive natyrore në Shqipëri gjatë vitit 2024.....	51
Tabela 25. Një përmbledhje e humbjeve për periudhën krahasimore 2023-2024.....	51

Akronime

AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtes Civile
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve
BB	Banka Botërore
BSH	Banka e Shqipërisë
DMB	Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit
DRF	Deklarata e Risqeve Fiskale
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GJEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
IB	Institucione Buxhetore
INSTAT	Instituti i Statistikave
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
KMBL	Komiteti i Menaxhimit të Borxhit dhe Likuiditetit
KMF	Kuadri Makroekonomik-Fiskal
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
ML	Ministritë e Linjes
MTRS	Strategjia Afatmesme e të Ardhurave
NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
NSH	Ndërmarrje Shtetërore
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PPP	Partneriteti Publik Privat
QQ	Qeverisë Qendrore
QV	Qeverisë Vendore
SAA	Strategjia Afatmesme e të Ardhurave
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SAMB	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit
SIFQ	Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë
U-K	Ujësjiellës Kanalizime
LOB	Ligji Organik i Buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
TSA	Llogaria e Unifikuar e Thesarit (Treasury Single Account)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Përmbledhje Ekzekutive

Deklarata e Risqeve Fiskale është një dokument i Ministrisë së Financave që përfshin mbledhjen, përpunimin, analizimin, mitigimin (kur është e mundur) dhe raportimin e risqeve kryesore fiskale në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse, si një instrument në shërbim të vendimmarrjes së Qeverisë. Ky dokument hartohet dhe miratohet, bazuar në përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.35 datë 29.12.2022 “Për procedurat standarde të raportimit dhe monitorimit të risqeve fiskale nga njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme dhe njësi të tjera të sektorit publik”. Ecuria e risqeve kryesore fiskale për vitin 2024, sipas fushave përkatëse, paraqitet si më poshtë:

Treguesit Fiskal

Për vitin 2024, të ardhurat buxhetore rezultuan më të larta se plani fillestar me 34.2 miliardë lekë (+1.37% ndaj PBB-së), ndërsa shpenzimet rezultuan më të ulëta me 8.8 miliardë lekë (-0.35% ndaj PBB-së). Rritja e të ardhurave erdhi kryesisht nga TVSH-ja e brendshme, tatimi mbi fitimin dhe të ardhurat personale, si dhe nga të ardhura jotatimore dhe kontribute të fondeve speciale. Kontributin kryesor në devijimet pozitive e dhanë faktorë si zbatimi i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe reforma e rritjes së pagave. Në anën e shpenzimeve, u vërejtën reduktime në shpenzimet për interesa dhe në shpenzimet kapitale. Planit për vitin 2025 parashikon rritje të mëtejshme të të ardhurave dhe shpenzimeve, me theks te investimet kapitale dhe forcimi i sistemit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Zhvillimet makroekonomike

Ekonomia e vendit ka treguar një qëndrueshmëri dhe elasticitet të konsiderueshëm përballë krizave madhore të viteve të fundit. Gjatë vitit 2024, PBB-ja reale u rrit me rreth 4.0 përqind, kryesisht nga kërkesa e brendshme dhe turizmi, ndërsa inflacioni zbriti në 2.2 përqind, ndjeshëm më i ulët se në rajon dhe BE. Deficiti buxhetor për vitin 2024 ishte 0.7 përqind e PBB-së, ndërsa balanca primare rezultoi pozitive në 1.4 përqind. Politika fiskale synon uljen graduale të borxhit dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, ndërkohë që risqet kryesore lidhen me goditjet në çmimet e mallrave, luhatshmërinë e kursit dhe recesionin e mundshëm në Europë.

Shpenzimet e përgjithshme

Planifikimi i shpenzimeve buxhetore bëhet mbi bazë programi dhe performance, duke financuar fillimisht politikat ekzistuese dhe më pas propozimet e reja sipas prioritetit strategjik dhe hapësirës fiskale. Ky planifikim ndikohet nga treguesit makroekonomikë, të ardhurat, deficiti dhe politikat sociale duke u shoqëruar me vlerësime shpesh më konservative se buxheti i miratuar. Reforma e pagave në 2023 dhe Planifikimi i Rritjes së Ballkanit Perëndimor ndikuan në devijancat e projeksioneve për vitet 2024–2025. Ndërkohë, investimet publike planifikohen duke u fokusuar në projektet në vazhdim dhe prioritetet qeveritare, megjithatë realizimi i tyre gjatë vitit 2024 është përballur me vështirësi në zbatimin e procedurave të reja, mungesës së analizave të thelluara në propozimet e projekteve, rishpërndarjeve të fondeve dhe krijimit të detyrimeve të prapambetura. Nga ana tjetër, zbatimi i buxhetit ka vijuar të fokusohet në monitorimin e performancës dhe krahasimin e realizimit faktik me objektivat e planifikuara, për të identifikuar devijimet dhe ndërmarrë masa korrigjuese që sigurojnë përdorim efikas dhe transparencë të fondeve publike.

Borxhi publik dhe Mjetet disponibël

Gjatë vitit 2024, borxhi publik u menaxhua në përputhje me objektivat makro-fiskale dhe strategjinë afatmesme të borxhit, duke mundur rifinancimin e detyrimeve ekzistuese dhe mbulimin e deficitit buxhetor. Huamarrja bruto arriti në 404.2 miliardë lekë, kryesisht nga burime të brendshme. Në përputhje me prioritetet e Strategjisë së Menaxhimit të Borxhit, u rrit pesha e instrumenteve afatgjatë me norma fikse, duke sjellë përmirësim në treguesit e riskut të rifinancimit dhe të normave të interesit. Në fund të vitit 2024, borxhi në valutë përbënte 41.9% të totalit, duke shënuar ulje të mëtejshme të ekspozimit ndaj riskut të kursit të këmbimit. Masat për zbutjen e risqeve do të vijnë, përmes kontingjencave buxhetore dhe fokusit në tituj afatgjatë me kosto të qëndrueshme.

Ndërsa menaxhimi i likuiditetit gjatë vitit 2024 ka qenë i mjaftueshëm dhe efektiv, me pagesa në kohë dhe përmirësim të parashikimeve ditore dhe mujore të fluksit monetar. Janë përdorur instrumente të ndryshme financiare për sigurimin e likuiditetit, ndërsa janë identifikuar dhe zbutur disa risqe operationale, duke propozuar masa shtesë për përmirësimin e parashikimit dhe transparencës në menaxhimin e buxhetit.

Financat Vendore

Gjatë vitit 2024, financat e pushtetit vendor shënuan performancë pozitive, me të ardhura që tejkaluan planin me 103% dhe një ulje të ndjeshme të stokut të detyrimeve të prapambetura me 1.58 miliardë lekë. Megjithatë, risqet kryesore mbeten detyrimet e prapambetura, realizimi i buxhetit dhe ndikimi i ndryshimeve demografike në ndarjen e transfertës së pakushtëzuar. Ministria e Financave po vijon me masa të strukturuar për konsolidimin fiskal dhe menaxhimin e këtyre risqeve në nivel vendor.

Koncesionet/PPP-të

Gjatë vitit 2024, Ministria e Financave ka vijuar monitorimin e 11 kontratave koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, për të cilat janë realizuar pagesa faktike në vlerën prej rreth 13.29 miliardë lekë, ose 2.22% e të ardhurave tatimore të vitit paraardhës, nën kufirin ligjor prej 5%. Monitorimi institucional i kontratave është forcuar përmes standardizimit të raportimit. Për vitin 2025, pagesat e planifikuara vijnë të mbeten brenda kufirit fiskal, duke ruajtur qëndrueshmërinë buxhetore.

Spektori i Ndërmarrjeve Shtetërore

Ndërmarrjet publike me kapital shtetëror mbeten një burim i rëndësishëm risqesh fiskale për buxhetin. Performanca financiare e tyre gjatë vitit 2024 paraqet një tablo të përzier, me disa ndërmarrje që shfaqin stabilitet dhe të tjera që shfaqin vështirësi të lidhura kryesisht me faktorë të jashtëm si kushtet atmosferike. Spektori energjetik vijon të mbajë peshën kryesore të portofolit total të ndërmarrjeve, me një ndikim fiskal për vitin 2024 në masën 6.05 miliardë lekë, ndërkohë që performanca financiare e ndërmarrjeve në sektorë të tjerë varion ndikuar kryesisht nga risku i likuiditetit. Ministria e Financave ka vijuar monitorimin tremujor të performancës së ndërmarrjeve shtetërore duke përfunduar më tej analizat nëpërmjet implementimit të mjetit të SOE HCT.

Detyrimet kontingjente

Detyrimet kontingjente përfshijnë kryesisht vendime të GJEDNJ-së dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar, të cilat paraqesin një barrë të konsiderueshme për buxhetin e shtetit. Ministria e Financave ka vijuar zbatimin e vendimeve të formës së prerë duke respektuar afatet ligjore dhe duke propozuar mekanizma për shlyerje graduale, në përputhje me mundësitë buxhetore. Gjatë vitit 2024, janë realizuar pagesa prej rreth 288,749 euro për vendime të GJEDNJ-së dhe 4.88 milionë euro për çështje të Arbitrazhit Ndërkombëtar. Vijnë të theksohet rëndësia e skedulimit të shlyerjeve dhe forcimit të rolit negociues për të shmangur ndikimin negativ të detyrimeve kontingjente në buxhetin e shtetit.

Fatkeqësitë natyrore

Në vitin 2024, Shqipëria u përball me situata emergjente nga fenomene të ndryshme natyrore, duke përfshirë kryesisht një sezon të rëndë zjarresh me 168 zjarre që shkatërruan 46,534 hektarë tokë, kryesisht nga zjarrvënja e qëllimshme. Gjithashtu u regjistruan 28 lëkundje tërmeti me magnitudë 3.0-4.5 Rihter pa dëme në infrastrukturë. Megjithatë Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) ka përfunduar menaxhimin e riskut nëpërmjet kuadrit ligjor dhe masave operationale, sfidat mbeten të mëdha, sidomos në parandalimin e zjarrvënjeve që shkaktojnë dëme të konsiderueshme, si dhe në koordinimin efektiv të burimeve financiare dhe njerëzore. Për vitin 2024 janë regjistruar 1,676 ngjarje fatkeqësive natyrore me 50 jetë të humbura dhe dëme në banesa, bujqësi dhe blegtori. Duke konsideruar që risku i fatkeqësive natyrore për shkak të efekteve nga ndryshimet klimatike është në rritje, AKMC-ja dhe Ministria e Financave vijnë bashkëpunimet me ekspertë të modelimit të riskut për të vlerësuar ekspozimet në të ardhmen.

Hyrje


Parashikimet dhe supozimet e përdorura në përgatitjen e buxhetit vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) janë subjekt i pasigurisë. Nëpërmjet një vlerësimi sistematik të parashikimeve ekonomike dhe fiskale si dhe duke kuptuar arsyet e çdo devijimi midis planifikimit dhe realizimit faktik, qeveria synon të forcojë dhe përmirësojë kuadrin ekzistues për raportimin fiskal në Shqipëri. Me kalimin e kohës, synohet që ky proces do të përmirësojë kapacitetet për të menaxhuar risqet fiskale.

Një sërë goditjesh në ekonominë shqiptare dhe në pozicionin e saj fiskal kanë pasur ndikime të thella vitet e fundit. Në përgjithësi, ekonomia shqiptare i ka përballuar këto goditje në një pozitë më të fortë se pritshmëritë dhe qeveria edhe për vitin 2025 do të vazhdojë në qeverisjen me objektiva specifike fiskale. Përmbytja e këtyre objektivave do të kërkojë një vëmendje më të madhe për të kuptuar, identifikuar dhe menaxhuar risqet fiskale.

Në parashikimet makroekonomike merren për bazë një shumëllojshmëri informacioni, përfshirë vlerësimet mbi zhvillimet ekonomike, parashikimet për inflacionin, ecurinë e tregjeve financiare si dhe risqet dhe pasiguritë që rrethojnë parashikimet.

Grafikët e mëposhtëm ndihmojnë për të ilustruar ndikimin e përgjithshëm që kanë pasur ngjarje të tilla si tërmeti i vitit 2019, pandemia COVID-19 në 2020 dhe 2021 dhe lufta në Ukrainë nga viti 2022 e në vijim, duke reduktuar madhësinë e ekonomisë dhe duke çuar në deficit dhe borxh publik më të lartë, krahasuar me parashikimet e kryera në Janar 2019.

Grafiku 1. Produkti i Brendshëm Bruto dhe Borxhi Publik Bruto në % të PBB-së për vitet 2019-2027



*Për vitin 2020 është vendosur si bazë referuese muaji korrik pasi, në vitin 2020 Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal u rishikua në muajin korrik.

Burimi: Ministria e Financave (2025)


Edhe gjatë vitit 2024, ekonomia e vendit vijoi sërish të performojë me një rritje pozitive. Të dhënat treguan se, ekonomia u rrit përkatësisht me 4.0 përqind krahasuar me vitin 2023. Në përgjithësi kjo rritje është nxitur nga ecuria e mirë në sektorin e turizmit, nga kërkesa e brendshme nëpërmjet konsumit privat (me +2.5 përqind), po ashtu edhe nga investimet me rritje përkatësisht 1.1 përqind krahasuar me vitin 2023. Kërkesa e huaj neto pati një kontribut lehtësisht negativ në rritjen ekonomike në vitin 2024, përkatësisht -0.1 përqind, ndikuar nga rritja më e shpejtë e importeve të mallrave dhe shërbimeve dhe rënia e eksporteve të mallrave. Nga pikëpamja sektoriale, rritja ekonomike u nxit kryesisht nga rritja e aktivitetit në sektorët e shërbimeve dhe të taksave neto. Sektori i administratës publike ka kontribuar me rreth 1.2 pikë përqindje, ndikuar kjo nga rritja e pagave në sektorin publik. Kontribuesi i dytë më i madh ishte sektori i tregtisë, transportit dhe akomodimit me 1.1 pikë përqindje, si dhe sektori i ndërtimit me 0.8 pikë përqindje. Në të kundërt, sektori i industrisë ka vijuar të japë kontribut negativ duke u ulur me rreth 0.7 pikë përqindje, veçanërisht nga sektori i përpunimit, i cili është reflektuar edhe në uljen e eksporteve të mallrave. Gjithashtu, kontributi i bujqësisë në rritje rezultoi negativ, me 0.2 pikë përqindje.

1. Treguesit Fiskal

Vitet e fundit, përpara goditjes nga pandemia, financat publike kishin hyrë në një trajektore të sigurt dhe optimale të konsolidimit fiskal, materializuar në parametrat më të rëndësishëm të qëndrueshmërisë. Së pari, kjo u materializua në uljen e deficitit të përgjithshëm buxhetor nga 5 përqind e PBB-së në vitin 2013, në poshtë nivelit prej 2 përqind në vitin 2019. Ndërsa në vitin 2020 dhe 2021, si kundërpërgjigje kryesore me qëllim amortizimin e goditjeve negative (nga tërmeti dhe sidomos pandemia), u ndërmor një politikë fiskale mjaft ekspansioniste. Për rrjedhojë, në vitin 2021 deficitin total buxhetor arriti në rreth 4.6 përqind të PBB-së dhe borxhi publik u rrit në rreth 74.1 përqind të PBB-së, pra me rreth 9.1 pikë përqindjeje krahasuar me fundin e vitit 2019. Përgjatë këtyre periudhave është krijuar hapësira e nevojshme fiskale për të akomoduar elementë të ndryshëm, me qëllim zbutjen e ndikimit të krizës për aspekte të ndryshme sociale dhe ekonomike. Gjatë vitit 2024, ekonomia vazhdoi rritjen duke treguar një stabilizim të aktivitetit ekonomik. Të dhënat treguan se ekonomia u rrit përkatësisht me 4.0 përqind krahasuar me vitin 2023.

Grafikët e mëposhtëm ndihmojnë për të ilustruar ndikimin e përgjithshëm që kanë pasur ngjarje të tilla si tërmeti i vitit 2019, pandemia COVID-19 në 2020 dhe 2021 dhe lufta në Ukrainë nga viti 2022 e në vijim, duke parashikuar të ardhura dhe shpenzime jo në linjë me rezultatet faktike.

Grafiku 2. Totali i të ardhurave e shpenzimeve, Balanca primare dhe Deficiti, në % të PBB për 2019-2027



Burimi: Ministria e Financave (2025)

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna mbi zërat kryesor të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 (fakt/plan) si dhe devijimi i tyre në përqindje ndaj PBB-së nominale¹.

¹ Bazuar në KMF më të fundit të publikuar për periudhën 2026-2028, PBB nominale e vlerësuar për vitin 2024 është 2,494,208 milionë lekë.

Tabela 1. Zërat kryesor të të ardhurave dhe shpenzimeve, për vitin 2024

Të Ardhurat					Shpenzimet				
Zërat kryesor të të ardhurave (në milionë lekë)	Plan 2024 (buxheti fillestar)	Fakt 2024	Diferenca Fakt-Plan 2024	Diferenca në % ndaj PBB-së	Zërat kryesor të shpenzimeve (në milionë lekë)	Plan 2024 (buxheti fillestar)	Fakt 2024	Diferenca Fakt-Plan 2024	Diferenca në % ndaj PBB-së
Tatimi mbi vlerën e shtuar	211,203	213,999	2,796	0.11%	Shpenzimet e personelit	119,836	112,699	(7,137)	-0.29%
Tatimi mbi fitimin	53,679	56,995	3,315	0.13%	Interesat	66,177	54,459	(11,718)	-0.47%
Akciza	63,602	63,437	(164)	-0.01%	Shpenzime operative mirëmbajtje	67,058	80,208	13,151	0.53%
Tatimi mbi të ardhurat personale	65,206	66,163	957	0.04%	Subvencionet	1,850	1,794	(56)	0.00%
Taksa nacionale dhe të tjera	44,292	47,418	3,127	0.13%	Shpenzime të tjera sociale	30,450	30,931	481	0.02%
Taksa doganore	9,021	8,973	(48)	0.00%	Shpenzime për buxhetin vendor	71,249	74,407	3,157	0.13%
Të ardhura nga fondet speciale përfshirë*:	157,625	161,780	4,156	0.17%	Shpenzime për fondet speciale përfshirë:	248,877	251,791	2,914	0.12%
<i>Sigurimi shoqëror</i>	136,239	139,404	3,165	0.13%	<i>Sigurimi shoqëror</i>	178,038	188,626	10,588	0.42%
<i>Sigurimi shëndetësor</i>	20,481	21,543	1,062	0.04%	<i>Sigurimi shëndetësor</i>	58,052	58,771	719	0.03%
<i>Fondi i kompensimit të pronarëve</i>	905	833	(72)	0.00%	<i>Shpenzim për kompensim pronarësh</i>	5,000	4,394	(606)	-0.02%
Të ardhura nga pushteti vendor	29,114	40,331	11,217	0.45%	Shpenzime kapitale	129,381	115,433	(13,948)	-0.56%
Të ardhura jotatimore	25,401	43,694	18,293	0.73%	Të tjera	2,500	6,850	4,350	0.17%
Të ardhura nga ndihmat	16,957	7,797	(9,159)	-0.37%					
Total	676,098	710,587	34,489	1.38%	Total	737,378	728,572	(8,806)	-0.35%

*Arkëtimi i kontributeve shoqërore dhe shëndetësore duke përfshirë dhe F.S.K.D.Sh dhe I.S.Sh

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme, lidhur me devijimet fakt/plan 2024 në përqindje të PBB-së nominale, disa nga faktorët kryesor që kanë ndikuar në zërat e të ardhurave tatimore janë si vijon:

- Devijimi pozitiv (fakt/plan 2024 në përqindje të PBB-së) në zërin 'TVSH' erdhi si pasojë e rritjes së të ardhurave nga TVSH-ja e brendshme, si rezultat i zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) dhe Planit të Veprimit 2024-2027. Konkretisht nga rritja e TVSH-së së paguar në sektorin e ndërtimit dhe akomodimit përtej nivelit të targetuar, zgjerimit të numrit të tatimpaguesve në sektorin e turizmit, si dhe rritjes së përgjithshme të tatimpaguesve me përgjegjësi për TVSH-në në të gjithë sektorët.
- Devijimi pozitiv në zërin 'Taksa nacionale dhe të tjera' erdhi si pasojë e kontabilizimit one-off të disa taksave nacionale të mbledhura nga administrata doganore (si psh. taksa e lëndës djegëse e përdorur si karburant për mjete lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi jashtë territorit të Shqipërisë, taksa e qumështit pluhur, taksa e pijeve të homogjenizuara, etj.), si dhe rritjes së të ardhurave nga taksa e qarkullimit, taksa vjetore e mjeteve të transportit dhe taksa e karbonit, të ndikuara nga rritja e sasive të karbonit.
- Devijimi pozitiv në zërin 'Të ardhurat nga fondet speciale' erdhi kryesisht nga rritja e sektorit të shërbimit dhe rritja e sektorëve të prodhimit dhe tregtisë.
- Devijimi pozitiv në zërin 'Tatimi mbi të ardhurat personale' erdhi kryesisht si pasojë e rritjes së pagave në sektorin publik, të punësuarve në sektorin privat dhe të ardhurave nga 'Tatimi mbi të ardhurat nga interesat'.

Informacion më i detajuar lidhur me devijimet pozitive në të ardhurat dhe shpenzimet nga pushteti vendor gjendet në kapitullin 5 "Risqet fiskale të lidhura me Financat Vendore", ndërsa mbi realizimin e shpenzimeve buxhetore dhe devijimin e tyre nga plani vjetor gjendet në kapitullin 3 "Risqet e lidhura me Shpenzimet e Përgjithshme dhe Detyrimet e Prapambetura".

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna mbi zërat kryesor të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 dhe planifikimin për vitin 2025, si dhe devijimi i tyre në përqindje ndaj PBB-së nominale të parashikuar për vitin 2025².

² Bazuar në KMF më të fundit të publikuar për periudhën 2026-2028, PBB nominale e parashikuar për vitin 2025 është 2,620,732 milionë lekë.

Tabela 2. Zërat kryesor të të ardhurave dhe shpenzimeve (Fakt 2024/Plan 2025)

Të Ardhurat					Shpenzimet				
Zërat kryesor të të ardhurave (në milionë lekë)	Fakt 2024	Plan 2025	Diferenca Plan 2025 – Fakt 2024	Diferenca në % ndaj PBB-së	Zërat kryesor të shpenzimeve (në milionë lekë)	Fakt 2024	Plan 2025	Diferenca Plan 2025 – Fakt 2024	Diferenca në % ndaj PBB-së
Tatimi mbi vlerën e shtuar	213,999	236,784	22,785	0.87%	Shpenzimet e personelit	112,699	127,929	15,230	0.58%
Tatimi mbi fitimin	56,995	65,749	8,754	0.33%	Interesat	54,459	68,552	14,093	0.54%
Akciza	63,437	67,620	4,183	0.16%	Shpenzime operative mirëmbajtje	80,208	75,684	(4,525)	-0.17%
Tatimi mbi të ardhurat personale	66,163	70,705	4,542	0.17%	Subvencionet	1,794	1,950	156	0.01%
Taksa nacionale dhe të tjera	47,418	49,637	2,219	0.08%	Shpenzime të tjera sociale	30,931	28,150	(2,781)	-0.11%
Taksa doganore	8,973	11,078	2,105	0.08%	Shpenzime për buxhetin vendor	74,407	89,911	15,505	0.59%
Të ardhura nga fondet speciale përfshirë*:	161,780	169,893	8,113	0.31%	Shpenzime për fondet speciale përfshirë:	251,791	263,838	12,047	0.46%
<i>Sigurimi shoqëror</i>	139,404	146,343	6,939	0.26%	<i>Sigurimi shoqëror</i>	188,626	192,338	3,712	0.14%
<i>Sigurimi shëndetësor</i>	21,543	22,645	1,102	0.04%	<i>Sigurimi shëndetësor</i>	58,771	63,132	4,361	0.17%
<i>Fondi i kompensimit të pronarëve</i>	833	905	72	0.00%	<i>Shpenzim për kompensim pronarësh</i>	4,394	3,000	(1,394)	-0.05%
Të ardhura nga pushteti vendor	40,331	40,774	443	0.02%	Shpenzime kapitale	115,433	162,374	46,941	1.79%
Të ardhura jotatimore	43,694	25,800	(17,894)	-0.68%	Të tjera	6,850	6,700	(150)	-0.01%
Të ardhura nga ndihmat	7,797	18,995	11,198	0.43%					
Total	710,587	757,036	46,449	1.78%	Total	728,572	825,088	96,517	3.68%

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme, faktorët kryesor të marrë në konsideratë për planifikimin e zërave të të ardhurave tatimore për vitin 2025, janë si vijon:

- *Planifikimi i zërit 'TVSH' bazohet kryesisht në rritjen e të ardhurave nga TVSH-ja që gjeneron rritja ekonomike shtesë dhe indeksi i çmimeve, fokusimi për rritjen e të ardhurave nga sektorët në ekspansion (si turizmi, akomodimi, ndërtimi dhe gjithë sektorët e tjerë ekonomik) si dhe përmirësimi i administrimit të TVSH-së nga sistemi i fiskalizimit dhe konsolidimi i faturimit elektronik.*
- *Planifikimi i zërit 'Tatimi mbi fitimin' ka marrë në konsideratë përmirësimin e administrimit nga sistemi i fiskalizimit, si dhe forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut.*
- *Planifikimi i zërit 'Të ardhurat nga akciza' bazohet në rritjen ekonomik dhe rritjen e nivelit të akcizave për shkak të zbatimit të kalendarit të rritjes së niveleve të akcizës për duhanet.*
- *Planifikimi i zërit 'Tatimi mbi të ardhurat personale' bazohet në efektet e reformës së pagave në sektorin shtetëror, rritjen e numrit të punëmarrësve dhe pagës mesatare në sektorin privat, si dhe nga rritja ekonomike dhe përmirësimi i mirëadministrimit.*
- *Planifikimi i zërit 'Taksa nacionale dhe të tjera' përfshin efektet që pritet të vijnë nga rritja ekonomike në tërësi, taksat e reja të licensimit të lojrave të fatit, rritja e konsumit të karburanteve që gjenerojnë taksat e qarkullimit dhe karbonit etj.*
- *Planifikimi i zërave 'Sigurime Shoqërore' dhe 'Sigurime shëndetësore' bazohet në efektet e rritjes ekonomike të projektuar me efekt në punësim dhe kontribute, rritjes së pagave dhe kontributeve si rezultat i zbatimit të reformës së pagave në administratë si dhe forcimit të kontrollit të punës së padëkluar, nivelit të pagës të deklaruar dhe devijimit të saj nga paga reale që përfitohet.*

Shqipëria ka miratuar Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (MTRS) dhe Planin e Veprimit 2024-2027 e cila paraqet një sërë reformash të detajuara në fushën e politikave tatimore si dhe në mirëadministrimin tatimor dhe doganor, me synim rritjen e të ardhurave tatimore me një total prej 64.85 miliardë lekësh përgjatë periudhës 2024-2026. Kjo rritje parashikohet të vijë nga: i. Politikat fiskale: +9.28 miliardë lekë (0.33% e PBB-së); ii. Mirëadministrimi tatimor: +51 miliardë lekë (1.96% e PBB-së); iii. Mirëadministrimi doganor: +4.5 miliardë lekë (0.17% e PBB-së).

Si rezultat, raporti i të ardhurave tatimore ndaj PBB pritet të rritet nga 25.9% në vitin 2023, në 27.7% deri në vitin 2027, që përfaqëson një rritje prej 1.8 pikë përqindje.

2. Risqet Fiskale të Lidhura me Zhvillimet Makroekonomike

2.1. Zhvillimet makroekonomike në vend

Ekonomia e vendit ka treguar një qëndrueshmëri dhe elasticitet të konsiderueshëm përballë sfidave të njëpasnjëshme që kanë goditur vendin gjatë viteve të fundit. Kjo qëndrueshmëri është vënë në provë nga tri kriza madhore që ndodhën në mënyrë të njëpasnjëshme, si: tërmeti, pandemia globale dhe ndërprerjet në furnizimin e mallrave bazë si pasojë e luftës në Ukrainë. Pavarësisht këtyre sfidave, politikat e kujdesshme makroekonomike kanë mbështetur një rikthim të fortë ekonomik, dhe si rezultat fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare, si dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit kanë mbetur solide. Përballë një mjedisi ekonomik sfidues, të karakterizuar nga çmime relativisht të larta, pasiguri dhe kosto të larta financimi, ekonomia ka ruajtur një normë të qëndrueshme rritjeje, duke tejkaluar pritshmëritë fillestare. Performanca ekonomike gjatë kësaj periudhe ka qenë pozitive dhe relativisht e lartë, duke shfaqur një trajektore premtuese dhe pritjet të vazhdojë ecurinë pozitive edhe në periudhën afatmesme.

Gjatë vitit 2024, ekonomia vazhdoi rritjen duke treguar një stabilizim të aktivitetit ekonomik. Sipas vlerësimeve të fundit, PBB-ja në terma realë për vitin 2024 ka shënuar rritje prej rreth 4.0 përqind krahasuar me vitin 2023, duke qëndruar shumë pranë projeksioneve të llogaritura më parë në programin ekonomik dhe fiskal për vitin 2024 në nivelin prej 3.9 përqind të PBB-së. Kjo rritje u gjenerua kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat po ashtu edhe investimet si dhe veçanërisht nga performanca mjaft pozitive e sektorit të turizmit. Ndërkohë, kërkesa e huaj neto vlerësohet të ketë pasur efekt lehtësisht negativ (-0.1 përqind) krahasuar me vitin 2023, ndikuar nga rritja më e shpejtë e importeve të mallrave dhe shërbimeve dhe rënia e eksporteve të mallrave.

Zhvillimet në tregun e punës kanë qenë pozitive dhe në rikuperim të vijueshëm gjatë vitit 2024. Nga pikëpamja e ofertës, rritja e punësimit mund t'i atribuohet kryesisht rritjes së qëndrueshme të shkallës së pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe shkallës së punësimit, duke arritur përkatësisht 75.7 përqind në vitin 2024 (krahasuar me 75.4 përqind në vitin 2023) dhe 68.6 përqind (krahasuar me 67.7 përqind në vitin 2023), për grupmoshën 15-64 vjeç. Evidencat tregojnë se ka një interes të përgjithshëm në rritje për pjesëmarrje në tregun e punës, të nxitur nga trendi rritës i pagave, duke intensifikuar kështu tendencat pozitive në ofertën e punës. Në të njëjtën kohë, shkalla e papunësisë shënoi shifrën më të ulët të regjistruar ndonjëherë, duke vazhduar trendin rënës të viteve të fundit, në 8.5 përqind në vitin 2024, nga 9.5 përqind në fund të vitit 2023 (për moshën 15 vjeç e lart).

Inflacioni i çmimeve të konsumit vazhdoi prirjen rënëse të shpejtë gjatë vitit 2024. Rënia u nxit si nga vlerësimi i vazhdueshëm i lekut, veçanërisht kundrejt euros, monedhës kryesore të shkëmbimeve tregtare, ashtu edhe prej goditjeve pozitive të ofertës së jashtme, të reflektuara në rënien e inflacionit të çmimeve të ushqimeve dhe më tej, si dhe rënia e çmimeve të lëndëve të para dhe politika monetare proaktive. Sa u përket të dhënave më të fundit të disponueshme, në muajin dhjetor 2024 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 2.1 për qind, ndërsa një vit më parë ky ndryshim ishte 4.0 për qind. Inflacioni mesatar për periudhën janar-dhjetor të vitit 2024 është 2.2 për qind. Gjithashtu, është me rëndësi dhe në favor të zhvillimeve dhe perspektivës së ekonomisë fakti që inflacioni në vendin tonë ka qenë ndjeshëm më i ulët sesa në vendit e rajonit (në normën 2.2 përqind mesatare vjetore për vitin 2024), apo sesa mesatarja e vendeve të Bashkimit Europian. Rënia e inflacionit për të arritur objektivin 3 përqind, do të mbështetet nga stabilizimi i çmimeve në tregjet ndërkombëtare, nga stabiliteti i kursit të këmbimit, si edhe nga efektet e kursit normalizues të politikës monetare.

Parashikimet afatmesme

Gjatë periudhës afatmesme, rritja pritjet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Konsumi privat parashikohet të jetë sërish nxitësi kryesor i rritjes së PBB-së, stimuluar kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimi në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave, të cilat më tej pritjet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, veçanërisht pas rikthimit në nivelet normale të inflacionit gjatë vitit 2024. Ndërkohë, kërkesa e huaj neto (eksport-import) pritjet të ketë një efekt pozitiv të moderuar. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet

turistike, priten, gjithashtu, të kenë performancë pozitive në periudhën afatmesme dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve. Ndërsa rritja graduale e investimeve pritet të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përsheptimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe përmirësimi sërish i kushteve financiare dhe lehtësimi i standardeve të huadhënies gradualisht përgjatë afatit të mesëm priten të jenë faktorë të rëndësishëm incentivues të investimeve private.

Konsolidimi fiskal vijon të jetë objektivi themelor i politikës fiskale, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Me synimin për të ruajtur të pacenuar kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve, politika fiskale do të targetojë një trajektore rënëse të përvitshme të borxhit publik, ndërsa balanca primare do të jetë së paku neutrale ose në nivel pozitiv në vijimësi, duke përbërë objektivin kryesor operacional që do të ankorojë politikën fiskale në afatin e mesëm dhe të gjatë, në përputhje edhe me rregullat fiskale respektive në LOB. Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, synohet që të ruhet një raport i shëndetshëm i shpenzimeve buxhetore korente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (investimet publike) për periudhën 2025-2027 do targetohen të jenë mesatarisht rreth 6.1 përqind e PBB-së në çdo vit buxhetor.

Deficiti buxhetor për vitin 2024 shënoi nivelin 0.7 përqind të PBB-së, nga 1.3 përqind që rezultoi për vitin 2023. Balanca primare rezultoi 1.4 përqind të PBB-së për vitin 2024 dhe pritet të qëndrojë rreth nivelit mesatar prej 0.5 përqind përgjatë periudhës afatmesme 2025-2027. Ky target është tashmë ligjërish i detyrueshëm, i parashikuar në LOB, ku përcaktohet që duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim, balanca primare nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar).

2.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës

➤ *Risku: “Goditja e çmimeve të mallrave” si pasojë e konflikteve rajonale*

Karakteristikat: Një kombinim i ndërprerjeve të vazhdueshme të furnizimit (për shkak të konflikteve dhe kufizimeve të eksportit) si dhe goditjet negative të kërkesës, shkaktojnë paqëndrueshmëri të vazhdueshme të çmimeve të mallrave, duke sjellë rritje të inflacionit si dhe ngadalësim të aktivitetit ekonomik.

Impakti: (i lartë) Rritja e çmimeve të ushqimeve dhe energjisë elektrike do të godiste pjesë të shoqërisë më në nevojë si dhe familjet me të ardhura më të ulëta, duke sjellë rënie të fuqisë blerëse. Në këtë mënyrë, rritja ekonomike do të ngadalësohej dhe deficiti buxhetor do të rritej.

Masat e marra (mitigimi i riskut):

Përgjatë vitit 2024, indeksi i çmimeve të konsumit (inflacioni) në vendin tonë rezultoi 2.2 përqind, ndjeshëm më i ulët se vendet e rajonit si dhe të BE-së, e cila ndihmoi në ruajtjen e ekuilibrit të përgjithshëm makroekonomik në vend. Harmonizimi i politikës fiskale me atë monetare ndihmuan për të zbutur ndikimin e rritjes së inflacionit dhe rikthimin e tij drejt objektivit, nëpërmjet masave të mëposhtme:

- *Rritja e kujdesshme e normës bazë të interesit që ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë gjatë periudhës 2022-2023, në përgjigje të rritjes së shpejtë të çmimeve në tregjet botërore dhe në Shqipëri, u pasua nga një lehtësim i kushteve monetare në gjysmën e dytë të vitit 2024. Në tërësi, politika monetare ka rezultuar e suksesshme në kontrollin e inflacionit, pa dëmtuar trendin pozitiv të rritjes ekonomike dhe shëndetin e bilanceve financiare të ekonomisë.*
- *Politika fiskale ka siguruar masa të përkohshme duke synuara mbështetjen e të ardhurave për grupet më të cënueshme të shoqërisë.*
- *Procesi gradual i normalizimit të politikës monetare, përgjatë vitit 2024, e ka ulur normën bazë të interesit nga niveli 3.25 përqind në nivelin 2.75 përqind, e cila vijon të mbetet në këtë nivel. Kjo vendimmarrje i shërben ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, çka mbetet dhe parakushti kryesor për të mbështetur kthimin e inflacionit në objektivi gjatë vitit 2025.*

➤ *Risku: Lulahshmëria e kursit të këmbimit*

Karakteristikat: Rritja e kursit të këmbimit në vitin 2024 mund të pasohet nga një rënie e papritur, por megjithatë mbiçmimi i monedhës vendase kundrejt euros, ndihmon duke frenuar transmetimin e inflacionit të importuar, në ekonominë e brendshme.

Impakti: *(i lartë)* Vlerësimi i shpejtë paraqet sfida konkurruese për firmat e orientuara nga eksporti, ndërkohë që një zhvlerësim i papritur do të ndikonte negativisht në sektorin financiar dhe individët duke pasur parasysh peshën e madhe të kredive në valutë.

Masat e marra (mitigimi i riskut):

- *Shtrengimi i rregullores makroprudenciale për të reduktuar riskun e një goditjeje sistematike në sektorin financiar.*
- *Hartimi i masa të përkohshme për të lehtësuar problemet e likuiditetit për firmat eksportuese.*
- *Ecuria e aktivitetit ekonomik është ngushtësisht e lidhur me treguesit makroekonomik dhe Ministria e Financave (MF) ka qenë e kujdesshme që të ruajë balancat makroekonomike dhe të shkojë drejt konsolidimit fiskal, me qëllim përballimin e çdo situatë në të ardhmen që mund të ndikojë ekonominë.*

➤ *Risku: “Ngadalësim i papritur global ose recesion në Europë”*

Karakteristikat: Pasojat nga thellimi i fragmentimit gjeoekonomik, konfliktet më të gjera, politikat e orientuara nga brenda dhe bashkëpunimi ndërkombëtar i dobësuar mund të rezultojnë në një konfigurim më pak efikas të tregtisë dhe IHD-ve, ndërprerje të furnizimit, rritje të kostove të transportit dhe inputeve, paqëndrueshmëri financiare, një thyerje të sistemit dhe rritje më të ulët të parave ndërkombëtare, që shkakton një recesion të BE.

Impakti: *(i mesëm)* Një recesion në destinacionet kryesore të eksporteve të Shqipërisë, mund të sjellë rënie të kërkesës së jashtme dhe remitanca, duke çuar për pasojë në një rritje më të ngadaltë në Shqipëri. Për shkak të lidhjeve jo të drejtpërdrejta me Rusinë dhe Ukrainën, tensionet gjeopolitike do të ndikojnë në mënyrë indirekte ekonominë shqiptare, nëpërmjet çmimeve më të larta të mallrave, rritjes më të ulët të partnerëve tregtarë, kushteve më të shtrenguara financiare si dhe besimit më të dobët.

Masat e marra:

Ruajtja e konsolidimit fiskal brenda një plani konsolidues afatmesëm të bazuar në rritjen e të ardhurave si dhe masat e reja të ndërmarra në politikën e taksave. Nga ana e shpenzimeve, buxheti parashikon mbështetje të vazhdueshme për të zbutur ndikimin e çmimeve ende të larta të energjisë tek familjet dhe bizneset. Mbështetja fiskale duke ruajtur konsolidimin fiskal bazohet në:

- *Politika specifike të orientuara drejt uljes së deficitit buxhetor dhe borxhit publik;*
- *Monitorimin dhe menaxhimin e risqeve të sektorit fiskal dhe financiar;*
- *Përmirësimin e mjedisit të biznesit për të mbështetur rritjen dhe investimet nëpërmjet politikave fiskale.*

Risqet për periudhën afatshkurtër/afatmesme

Projeksioni afatmesëm i PBB-së për periudhën 2025-2027, parashikon një rritje vjetore të PBB-së nominale (mesatarisht) me rreth 5.1 përqind. Në të njëjtën kohë, norma reale e rritjes së PBB-së parashikohet në 3.9-4 përqind dhe deflatori i PBB është rreth 1.2 përqind. Duke marrë parasysh konkluzionet e mësipërme për tendencën e kaluar drejt vlerësimit të PBB-së, ekziston mundësia që rritja nominale e PBB-së të jetë më e lartë ose më e ulët se ajo e parashikuar por në një marzh të vogël shumë pranë nivelit faktik në periudhën afatmesme. Ky përfundim është i vlefshëm vetëm në mungesë të goditjeve të mëdha të jashtme në ekonomi. Nga njëra anë, një projektion më konservator çon në një vlerësim më të kujdesshëm të të ardhurave në periudhën afatmesme, pa ndonjë ndikim të madh në buxhet nëse përballlet me goditje të jashtme por nga ana tjetër, nënvlerësimi i treguesve buxhetorë dëmton përvetësimin efikas të burimeve për qëllime të zhvillimit ekonomik dhe social.

2.3. Të dhëna analitike

Parashikimet makroekonomike afatmesme bazohen në metoda modeluese dhe analitike të programimit financiar. Për të vlerësuar risqet makroekonomike, Ministria e Financave merr në konsideratë edhe skenarë alternativë pesimistë dhe optimistë, të detajuar në Shtojcën A, e cila përfshin një përshkrim të metodologjisë së përdorur për parashikime, analizën e ndjeshmërisë dhe treguesit e plotë makroekonomikë. Një pjesë e treguesve ekonomikë, bazuar në parashikimet sipas skenarëve është si më poshtë:

Tabela 3. Parashikimet alternative për secilin skenar

	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
					Fakt	Para.	Para.	Para.
Rritja reale e PBB (%)								
Bazë	-3.3	9.0	4.8	3.9	4.0	3.9	4.0	3.9
Pesimist						2.4	2.5	2.4
Optimist						4.4	4.5	4.4
Rritja nominale e PBB (%)								
Bazë	-3.3	12.7	15.2	10.2	6.8	5.1	5.2	5.1
Pesimist						3.2	3.4	3.3
Optimist						5.6	5.7	5.6
PBB nominale (miliardë lekë)								
Bazë	1,656	1,867	2,150	2,370	2,530	2,621	2,757	2,898
Pesimist						2,575	2,662	2,750
Optimist						2,633	2,783	2,940
Norma efektive e interesit të Borxhit Publik (%)								
Bazë	3.2	3.0	3.0	3.6	4.0	4.7	4.6	4.5
Pesimist						4.7	4.6	4.5
Optimist						4.7	4.6	4.5
Kursi i Këmbimit Nominal, mesatar (Lek/Euro)								
Bazë	123.8	122.5	119.0	108.8	100.7	100.0	100.0	100.0
Pesimist						100.0	100.0	100.0
Optimist						100.0	100.0	100.0
Totali i të Ardhurave (% PBB)								
Bazë	25.7	27.4	26.6	27.2	28.1	28.9	29.0	29.3
Pesimist						28.4	28.5	28.8
Optimist						28.9	28.9	29.3
Totali i Shpenzimeve (% PBB)								
Bazë	32.4	31.9	30.3	28.5	28.8	31.5	30.8	30.8
Pesimist						30.6	30.4	30.8
Optimist						31.4	30.7	30.7
Balanca Fiskale (% PBB)								
Bazë	-6.7	-4.6	-3.6	-1.3	-0.7	-2.6	-1.9	-1.6
Pesimist						-2.2	-2.0	-2.0
Optimist						-2.4	-1.7	-1.4
Balanca Primare (% PBB)								
Bazë	-4.6	-2.7	-1.8	0.7	1.4	0.0	0.7	0.9
Pesimist						0.5	0.5	0.5
Optimist						0.2	0.8	1.0
Borxhi Publik Bruto (%PBB)								
Bazë	73.9	74.1	64.1	57.5	55.2*	54.8	54.0	53.2
Pesimist						55.0	54.6	54.4
Optimist						54.1	52.8	51.6

*Niveli i borxhit bruto për vitin 2024 është në përputhje me parashikimet në “Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2026-2028”. Niveli aktual i borxhit për vitin 2024 qëndron në 54.0% të PBB-së.

Burimi: Ministria e Financave (2025)

3. Risqet e Lidhura me Shpenzimet e Përgjithshme dhe Detyrimet e Prapambetura


3.1. Planifikimi i Shpenzimeve Buxhetore

3.1.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës

Planifikimi i shpenzimeve buxhetore bëhet mbështetur në metodologjinë e buxhetimit mbi bazë programi dhe performance duke siguruar që brenda tavaneve të shpenzimeve me frekuencë 3 vjeçare të financohen fillimisht shpenzimet e lidhura me të gjitha politikat ekzistuese dhe angazhimet e ndërmarra në vitet e mëparshme, politikat sociale, të pagave, të investimeve si dhe, në rast se rezulton hapësirë fiskale e mjaftueshme të financohen propozimet e politikave të reja mbështetur në prioritetet strategjike dhe politike të vendit. Planifikimi i shpenzimeve buxhetore ndikohet nga projeksionet e treguesve makroekonomikë, projeksioni i të ardhurave, niveli i deficitit dhe vendimet e politikave të lidhura me shpenzime sensitive sikurse janë shpenzimet e personelit, shpenzimet për pensione apo politika të ndryshme sociale.

Ndryshimet e shpeshta dhe të rëndësishme në këtë drejtim kontribuojnë në paqëndrueshmërinë në vlerësimin e shpenzimeve buxhetore dhe për pasojë paqëndrueshmëri në financimin e politikave publike. Analiza e projeksioneve të shpenzimeve agregate (në vlerë nominale) krahasuar me buxhetin e miratuar zhvilluar gjatë tetë viteve të fundit nxjerr në pah një diferencë të qëndrueshme ndërmjet vlerësimeve të buxhetit të bëra në PBA me ato të buxhetit vjetor të miratuar. Diferenca rezultojnë kryesisht negative që do të thotë që projeksionet e shpenzimeve të bëra gjatë hartimit të PBA janë më konservative krahasuar me atë të buxhetit të miratuar, i cili në 90% të rasteve rezulton më i lartë se projeksionet e tavaneve. E lartë paraqitet diferenca veçanërisht në vitet 2021-2023 e tavaneve të miratuara me ato të buxhetit fillestar me një hendek që luhet nga -2.5% deri në -10.1% (për vitin t) por në vitin 2024 vihet re një përmirësim i parashikimeve duke rezultuar në një hendek prej -5.4% e cila vijon të përmirësohet dhe në vitin 2025 duke rezultuar në -3.5%.

Grafiku 3. Devijanca e shpenzimeve sipas PBA-së krahasuar me buxhetin fillestar vjetor



Burimi: Ministria e Financave (2025)

Në përgjithësi, vlerësimi i shpenzimeve është një rezultat që rrjedh nga vlerësimi i burimeve buxhetore (të ardhurat dhe burimet e financimit të deficitit buxhetor). Diferencat në parashikime për vitin 2024 shpjegohen pjesërisht nga politika e rritjes së pagave e ndërmarrë nga Qeveria përgjatë vitit 2023. Kjo politikë u parashikua të shtrinte efektet e saj financiare në dy vite buxhetore e konkretisht 2023-2024, duke materializuar koston e plotë të reformës prej 39.1 miliardë lekë nga viti 2025 e në vijim. Reforma e ndërmarrë në paga preku parashikimet buxhetore për vitin 2024 me synim akomodimin e efekteve financiare të saj në buxhet. Ndërsa, diferencat në vitin 2025 lidhen me akomodimin e parashikimeve të lidhura me Planin e Rritjes së Ballkanit Perëndimor dhe Agjendën Kombëtare të Reformave të cilat u materializuan pasi ishin bërë parashikimet afatmesme të PBA.

3.1.2. Risqet e mundshme

Risqet që mund të impaktojnë parashikimet buxhetore duke rezultuar në devijanca të larta midis tyre dhe buxhetit fillestar të miratuar janë:

- *Risku fiskal – Ndryshimet në politikën e taksave (Parashikimi i të ardhurave tatimore ndikohet nga lidhja midis taksave dhe bazës tatimore të vendosur). Ndryshimi i nivelit të të ardhurave të planifikuara për t'u mbledhur impakton në mënyrë të drejtpërdrejtë tavanin e shpenzimeve të përgjithshme publike.*
- *Risku politik – Risku i politikave të ndërmarra nga Këshilli i Ministrave (Kërkesa për shpenzime të paplanifikuara që mund të ndryshojë tavanet e shpenzimeve).*
- *Risku në planifikim – Parashikim i dobët i tavanëve të shpenzimeve si rezultat i mosmarrjes në konsideratë të rekomandimeve dhe gjetjeve të monitorimeve të kryera gjatë vitit parardhës.*

3.1.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara

Masat e marra për zbutjen e risqeve të evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës:

- *Janë parashikuar në Strategjinë e re të Menaxhimit të Financave Publike rishikime të legjislativoni dytësor buxhetor gjatë periudhës afatmesme 2025-2027 i cili synon të adresojë çështje të lidhura me rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale në përgatitjen e kërkesave buxhetore.*
- *Do të finalizohet në fund të 2025 një udhëzim i veçantë për pasqyrimin si pjesë e dokumentave buxhetor të një pasqyre të devijimeve ndërmjet tavanëve të PBA dhe atyre të miratuara nga Parlamenti.*
- *Ka filluar puna për hartimin e metodologjisë së rishikimit të shpenzimeve për sektor specifik (spending review). Synimi është përmirësimi i mëtejshëm i planifikimit dhe menaxhimit të shpenzimeve publike.*
- *Ndjekja dhe zbatimi me korrektësi i Vendimit të ri për Menaxhimin e Investimeve Publike nr.887, datë 27.12.2022 i cili ndër të tjera synon të forcojë procesin e planifikimit dhe miratimi të projekteve të reja të investimeve publike si pjesë e ciklit të përgatitjes së PBA.*

Masat për të ardhmen:

- *Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës dhe Institucionet Qendrore do të angazhohen në evidentimin e shkaqeve që çojnë në planifikimin e dobët të shpenzimeve, duke i përcjellë si pjesë e analizave dhe rekomandimeve buxhetore me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit.*
- *Përfshirja dhe angazhimi i plotë i strukturave politikëbërëse në procesin e planifikimit buxhetor afatmesëm.*

3.1.4. Të dhëna analitike

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna për PBA-në e miratuar në fazën II për periudhën 2020-2027, në milionë lekë, si dhe buxheti respektiv fillestar, për të bërë të mundur krahasimin e devijancës së shpenzimeve.

Tabela 4. Shpenzimet totale sipas PBA-së për periudhën 2020-2027 dhe buxheti fillestar

Shpenzimet Totale per periudhën 2019-2027 në milionë lekë	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
PBA 2021-2023 (parashikuar në 2020)	578,008	566,546	596,899				
PBA 2022-2024 (parashikuar në 2021)		568,951	600,484	636,970			
PBA 2023-2025 (parashikuar në 2022)			627,636	660,606	697,567		
PBA 2024-2026 (parashikuar në 2023)				697,585	730,883	759,266	
PBA 2025-2027 (parashikuar në 2024)					795,833	826,177	853,341
Buxheti fillestar i miratuar	592,801	637,694	698,117	737,378	825,088		

Burimi: Ministria e Financave (2025)

3.2. Shpenzimet Buxhetore për Investimet Publike

3.2.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës

Investimet publike për vitin 2024 u planifikuan në masën 5.4 përqind të PBB-së ose 132.2 miliardë lekë (duke përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 9 miliardë lekë). Në planifikimin e investimeve për vitin 2024 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu si dhe në vitin 2023, dhe në vitin 2024 përparësi ka pasur financimi i projekteve në vazhdim. Për planifikimin e investimeve u ndoqën kriteret e mëposhtme:

- *Prioritetet e Programit të Qeverisë për periudhën 2021 – 2025;*
- *Prioritetet e integritetit evropian;*
- *Projektet në vazhdim dhe*
- *Mbështetja me kosto lokale dhe TVSH për projektet me financim të huaj.*

Fondet buxhetore të alokuara për investime kanë prekur fusha të rëndësishme të ekonomisë. Prioritetet e buxhetit 2024 për shpenzimet kapitale ishin kryesisht në fushën e infrastrukturës, e ujësjellës-kanalizimeve, transportit rrugor, shëndetësisë, mbrojtjes etj. Realizimi shpenzimeve për investime në total ka qenë në nivele të larta, veçanërisht për ato me financim të brendshëm, si dhe ecuria e realizimit të shpenzimeve kapitale nuk është shoqëruar me problematika thelbësore të cilat të ndikojnë qëndrueshmërinë financiare të buxhetit.


3.2.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës

Planifikimi i shpenzimeve publike për projektet e investimeve për vitin 2024, është realizuar bazuar në metodologjinë e miratuar me VKM-në nr. 887, datë 27.12.2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i ndryshuar. Financimi i investimeve publike është kryer në përputhje me metodologjinë e përgatitjes së buxhetit, sipas përcaktimeve në udhëzimet standarde të përgatitjes së buxhetit, që diferencon mes shpenzimeve për investime në politikat ekzistuese dhe shpenzimeve për investime për politika të reja. Fillimisht janë financuar:

- *shpenzimet e investimeve kapitale që nuk kanë përfunduar dhe që priten të finalizohen;*
- *shpenzimet e investimeve kapitale që ende nuk kanë filluar, por për të cilat janë ndërmarrë angazhimet ligjore dhe që janë miratuar në procesin e mëparshëm të PBA-së;*
- *shpenzimet e investimeve kapitale që janë financuar në vitin fiskal aktual.*

Planifikimi i investimeve publike është mbështetur në të dhënat mbi treguesit makroekonomik si të ardhurat, deficitin, vendimeve të lidhura me politikat e pagave etj. Planet buxhetore për shpenzimet kapitale janë rishikuar disa herë nëpërmjet akteve normative gjatë vitit 2024. Gjatë viteve të fundit këto ndryshime mes planeve në projektbuxhet, buxhet fillestar dhe planeve në buxhetin përfundimtar kanë sjellë risqe për buxhetin e shtetit duke krijuar edhe detyrime të prapambetura apo zgjatjen në vite të përfundimit të projekteve. Në grafikun mëposhtë gjenden devijancat në planifikimin e shpenzimeve kapitale në PBA e fazës I, buxhetin fillestar dhe buxhetin përfundimtar.

Grafiku 4. Devijanca e shpenzimeve kapitale sipas PBA-së krahasuar me buxhetin fillestar



Burimi: Ministria e Financave (2025)

Gjatë vitit 2024, janë identifikuar disa problematika në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit për projektet e investimeve, të cilat kanë sjellë rritjen e kostove të projekteve, kërkesën për fonde shtesë të paparashikuara në PBA dhe rritjen e viteve për përfundimin e projekteve, si:

- Vështirësi në implementimin e plotë të procedurave të reja të investimeve publike si rezultat i ndryshimeve në procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike (PIM);
- Mungesa e analizave të thelluara nga instucionet përfituese, mbi propozimet e projekteve;
- Rishpërndarjet ndërmjet zërave të investimeve publike nga ana e ML/IB, të cilat mund të krijojnë kushte për krijimin e detyrimeve të prapambetura;
- Përditësimi jo në kohë i Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare përfshirë ato në formën PPP.

3.2.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara

Bazuar në risqet e identifikuar, Ministria e Financave me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar ndërmori disa masa për forcimin e procedurave të identifikimit, propozimit, miratimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve publike. Për këtë qëllim, nëpërmjet VKM nr. 887/2022, u miratuan disa masa për zbutjen e risqeve të identifikuar:

- Projektet e reja të investimeve publike mbi vlerën kufi të vendosur me udhëzim³ nga Ministri përgjegjës për financat, klasifikohen si projekte investimi me rëndësi strategjike dhe i nënshtrohen një procesi të plotë vlerësimi për përfshirjen e tyre në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare. Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare përmban projektet e investimeve publike, që kanë rëndësi strategjike, për sa i përket zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, pavarësisht nga burimi i tyre i financimit. Kjo listë shërben si instrument për mbështetjen e politikave dhe prioritetëve të qeverisë shqiptare, në linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), si edhe strategjitë sektoriale e ndërsektoriale.
- Propozimet për shpenzime kapitale për emergjenca të cilat tejkalojnë vlerën 200 milionë lekë para se të planifikohen në PBA, përcillen për miratim me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Në zbatim të VKM nr. 887/2022, propozimet dhe studimet e fizibilitetit për projektet e reja të investimeve të cilat janë mbi vlerën kufi të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave dhe përmbushin kriteret për t'u klasifikuar si projekte me rëndësi strategjike do të paraqiten njëkohësisht në Ministrinë përgjegjëse për financat dhe në institucionin përgjegjës për programimin strategjik në çdo kohë. Ministria përgjegjëse për financat përcjell qëndrimin e saj pranë institucionit përgjegjës për programimin strategjik i cili vlerëson dhe konsulton çdo propozim në KPS, rast pas rasti.
- Një ndër pikat më të rëndësishme të VKM, ka të bëjë me angazhimet buxhetore shumëvjeçare, ku është përcaktuar se gjatë zbatimit të tyre në buxhetin e njësisë së qeverisjes qendrore nuk lejohet, që në buxhetin e njësisë përkatëse të njësisë së qeverisjes qendrore të shpërndahen më pak se 20% e vlerës së plotë të projektit përkatës gjatë vitit të parë, më pak se 30% e vlerës së plotë të projektit përkatës gjatë vitit të dytë dhe më pak se 30% e vlerës së plotë të projektit gjatë vitit të tretë, përveç rasteve, ku përcaktohet ndryshe në dokumentin e studimit të fizibilitetit dhe projektet e reja të miratuara në PBA 2024-2026.
- VKM 887/2022 përfshin ndërhyrje në të gjithë formularët e propozimit të projekteve në kuadër të forcimit të procedurave të propozimit, konceptimit, analizave të thelluara dhe informacionit që duhet të përcjellin propozuesit e tyre. Gjithashtu, në formularë janë marrë në konsideratë të gjitha kërkesat e institucioneve ndërkombëtare si: alternativat e mundshme të investimit, përfshirja e treguesve mjedisor e klimatik në vlerësime, përfshirja e treguesve gjinor në projekte, risqet e projekteve, lidhjet me strategjitë etj.
- Gjatë vitit 2024 në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe ASPA, janë zhvilluar seanca trajnimi me Ministrinë e Linjës dhe Institucionet Buxhetore me synim mirëmenaxhimin e financave publike dhe zbatimin me përpikmëri të VKM nr. 887, datë 27.12.2022, të ndryshuar.

³ Udhëzimi nr.5 datë 08.4.2024 "Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit përcaktohet mënyra dhe procedura e vlerësimit të projektit të investimit publik", Lidhja 1.

Lidhur me monitorimin, në zbatim të VKM së re nr.887 datë 27.12.2022 të ndryshuar, krahasuar me raportimet e mëparshme, janë shtuar dhe raportimet mbi treguesit e performancës në nivel projekti, mbi realizimin e procedurave të prokurimit, mbi rastet e krijimit të detyrimeve të prapambetura shoqëruar me argumentet përkatës, problematikat e krijuara në realizimin e projekteve, si dhe mbi mosrealizimin e projekteve shoqëruar me argumentet përkatëse. Ministria e Financave ka zbatuar procedurat e reja të investimeve publike gjatë vitit 2024. Projektet e investimeve të propozuara për buxhetin e vitit 2025 kanë ndjekur gjithashtu procedurat e reja në identifikim, propozim dhe miratim për t'u buxhetuar. Gjatë vitit 2024 është vijuar njëkohësisht edhe me miratimin e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare e cila u finalizua me miratimin e VKM-së nr. 553, datë 12.08.2024 për një ndryshim në vendimin Nr.161, datë 20.03.2024 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2025-2027”.

3.2.4. Të dhëna analitike

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna mbi tavanet për shpenzime kapitale të miratuara në PBA-në e fazës II dhe të buxhetit fillestar, për vitet 2021-2027.

Tabela 5. Shpenzimet kapitale për periudhën 2021-2027 dhe buxheti fillestar

Shpenzimet kapitale për periudhën 2020-2028 (milionë lekë)	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
PBA 2021-2023 (parashikuar në 2020)	112,192	83,353	88,747				
PBA 2022-2024 (parashikuar në 2021)		86,153	91,447	99,363			
PBA 2023-2025 (parashikuar në 2022)			101,577	108,743	118,437		
PBA 2024-2026 (parashikuar në 2023)				116,443	124,537	130,010	
PBA 2025-2027 (parashikuar në 2024)					122,980	127,822	134,952
PBA 2026-2028 (parashikuar në 2025)						154,678	148,112
Buxheti fillestar i miratuar	121,032	119,445	123,908	129,381	162,374		

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Për vitin 2024, devijanca prej rreth 13 miliardë lekë në investime kapitale mes PBA-së 2024-2026 dhe buxhetit fillestar lidhet me rritjen e PBB-së, duke rezultuar në rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit, duke u përkthyer kështu në rritje për financimin e investimeve publike. Konkretisht, shpenzimet kapitale pësojnë rritje në zërat: financimi i brendshëm u rrit me rreth 12 miliardë lekë, financimi i huaj u ul me 6 miliardë lekë dhe fondet e rindërtimit u miratuan në vlerën 7 miliardë lekë.

3.3. Menaxhimi i Shpenzimeve Buxhetore

3.3.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës

Menaxhimi i zbatimit të buxhetit ka për qëllim ndjekjen e zbatimit të planit të buxhetit, të objektivave dhe produkteve të miratuara në planin e buxhetit vjetor si viti i parë i programit buxhetor afatmesëm (PBA). Ndjekja e zbatimit të buxhetit realizohet nëpërmjet procesit të monitorimit të performancës, i cili është një proces vlerësimi që realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve të performancës së synuar me treguesit faktikë të realizuar. Monitorimi ka për qëllim:

- Të ndjekë arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuar, të përcaktuar në deklaratën e politikës së programit për vitin e parë të programit buxhetor afatmesëm, nëpërmjet krahasimit të treguesve të synuar të performancës me treguesit faktikë të tyre.
- Të evidentojë nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, dhe nëse jo të propozojë/rekomandojë ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve. Në rast rialokimi të burimeve, të evidentojë impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.
- Të sigurojë informacion i cili mund të përdoret për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.

3.3.2. Risqet e lidhura me performancën e zbatimit të buxhetit

Risqet në devijimin e realizimit të treguesve buxhetorë nga ato të miratuar në Ligjin e Buxhetit Fillestar Vjetor për Ministrinë dhe Institucionet Qendrore, lidhen me:

- *Ndryshimet e planit për shkak të shpërndarjes së Fondit Rezervë dhe Kontingjencës etj, si edhe nga rishpërndarjet e planit.*
- *Ndryshimet e treguesve buxhetorë të miratuar si pasojë e ndryshimeve të Ligjit të Buxhetit nëpërmjet Akteve Normative në kuadër të kriterëve të “nevojës” dhe “urgjencës”.*
- *Mos identifikimin në kohë të problemeve potenciale gjatë zbatimit të buxhetit.*
- *Parashikimin e dobët të tavanëve të shpenzimeve gjatë procesit të planifikimit, si rezultat i mos marrjes në konsideratë të rekomandimeve dhe gjetjeve të monitorimeve të ndodhura gjatë vitit paraardhës.*

Plani fillestar i buxhetit për shpenzimet korente për vitin 2024 si edhe shpenzimet faktike për ministrinë e institucionet ka ndryshuar si rezultat i shpërndarjes së Fondit Rezervë dhe Kontingjencës, fond i cili është parashikuar në Ligjin e Buxhetit për t'u shpërndarë me Vendime të Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara. Në Ligjin Fillestar, Fondi Rezervë u parashikua në masën 2.5 miliardë lekë, i cili me AN nr.3/2024 u rrit në 3.5 miliardë lekë dhe me AN nr.5/2024 u ul në 3.25 miliardë lekë. Fondi për rritjen e pagave në Ligjin Fillestar nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, u miratua në shumën prej 11 miliardë lekë.

Ligji i buxheti fillestar 2024 është ndryshuar nëpërmjet tre Akteve Normative dhe konkretisht:

- *Akti Normativ nr.1 datë 21.02.2024 – Nevoja dhe urgjenca e këtij Akti Normativ lidhet me reflektimin në buxhetin vjetor të riorganizimit të ministrive të reja, sipas fushave të përgjegjësisë funksionale respektive. Kjo, krahas disa rishikimeve në zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, të cilat kanë synuar përmirësimin e parametrave të ekzekutimit të buxhetit të vitit 2024.*
- *Akti Normativ nr.3 datë 28.08.2024 – Pas gjysmës së parë të vitit, me qëllim reflektimin e rishikimeve në zërat e të ardhurave, u miratua Akti i dytë Normativ i cili rriti totalin e shpenzimeve korente me 3.44 miliardë lekë. Ndryshimet nëpërmjet këtij akti në kahun e shpenzimeve korente konsistuan kryesisht në shtesa fondesh për sistemet e sigurisë kibernetike, kompensimeve ushqimore për efektivët e policisë, mbështetje për skemën e re të fermerëve etj.*
- *Akti Normativ nr.5 datë 19.12.2024 – Rishikimi i fundit i buxhetit u realizua me qëllim mbështetjen e disa shtresave sociale më vulnerabël, ku përshihet kategoria sociale e Ndihmës Ekonomike dhe Aftësive të Kufizuara si dhe shtresa e pensionistëve. Shtesë fondesh u parashikua dhe për të mbuluar financime shtesë në fushën mbrojtjes, kulturës, sportit etj.*

Informacion më i detajuar lidhur me rishikimet e buxhetit për vitin 2024, gjendet në relacionet bashkëlidhur Akteve Normative përkatëse, publikuar në faqen zyrtare të MF.⁴

3.3.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara

Mbi masat e marra lidhur me risqet e sipërpërmendura të cilat ndikojnë në krijimin e devijancave të treguesve të realizuar buxhetorë në krahasim me treguesit e miratuar në Ligjin e Buxhetit Fillestar Vjetor, për vitin 2024 evidentohet se:

- *Ndryshimet e planit të shpenzimeve korente nga Ligji i Buxhetit fillestar që vijnë për shkak të përdorimit të Fondit Rezervë si dhe Fondit të Kontingjencës për rritjen e pagave, janë parashikuar që në ligjin fillestar të buxhetit, ndërsa format dhe mënyrat e shpërndarjes së këtyre fondeve kanë ndjekur përcaktimet e VKM-ve përkatëse.*
- *Analiza e performancës buxhetore si dhe situata fiskale në rritje, e bëri të domosdoshëm rishikimin e Ligjit të Buxhetit në drejtim të rritjes së planit për shpenzimet korente. Nëpërmjet kësaj rritjeje u bë i mundur akordimi i fondeve shtesë për likuidimin e detyrimeve që kanë ML/Institucionet Shtetërore ndaj punonjësve si dhe për detyrimet ndaj të tretëve për shërbimet e kryera.*

⁴ Akti Normativ nr. 1, datë 21.02.2024: <https://financa.gov.al/akti-normativ-nr-1-date-21-02-2024/>

Akti Normativ nr. 3, datë 28.08.2024: <https://financa.gov.al/akti-normativ-nr-3-date-28-08-2024/>

Akti Normativ nr. 5, datë 19.12.2024: <https://financa.gov.al/akti-normativ-nr-5-date-19-12-2024/>

- Lidhur me ndryshimet nga fondi për mbështetjen e pensionistëve, ky fond është parashikuar që në Ligjin e Buxhetit Fillestar në masën 7.78 miliardë lekë, por me Aktin Normativ nr.5, i cili pati në fokus kryesisht mbështetjen e shtresave sociale më vulnerabël, ky fond u rrit në 11.6 miliardë lekë dhe gjithashtu u dha mbështetje financiare në formën e shpërblimeve të menjëhershme në vlerën rreth 2.2 miliardë lekë.

Për sa më sipër, duhet nënvizuar që devijancat në realizimin e shpenzimeve korente duhen vlerësuar dhe në kuadrin e ndryshimeve në treguesit e tjerë të Buxhetit të Shtetit, siç janë ecuria në grumbullimin e zërit Të Ardhura Buxhetore, ecuria e realizimit të zërit Shpenzime për Investime si dhe ndryshimet në zërin e Deficitit Buxhetor.


Për zbutjen e mëtejshme të risqeve në të ardhmen, duhet të vijojë:

- Ndjekja dhe menaxhimi i zbatimit të buxhetit për të identifikuar në kohë problemet potenciale, me qëllim marrjen e masave për evitimin dhe përfshirjen në kohë të efekteve financiare përkatëse që në procesin e planifikimit të buxhetit.
- Përmirësimi dhe thellimi i analizës së performancës së të gjithë treguesve buxhetorë duke përfshirë edhe treguesit kyç të performancës dhe produktet nga ana e ML/Institucioneve Buxhetore me qëllim evidentimin dhe paraqitjen në kohë të problematikave që ndeshen gjatë zbatimit të buxhetit dhe paraqitjen e propozimeve përkatëse për shmangien e këtyre problematikave dhe zvogëlimin e risqeve që ndikojnë në realizimin e treguesve buxhetorë.

3.3.4. Të dhëna analitike

Më poshtë paraqiten të dhënat mbi ndryshimet e planit të shpenzimeve korente të buxhetit për Ministrinë dhe Institucionet Qendrore (Totali sipas Tab.1 të Ligjit të Buxhetit), gjatë viteve 2020-2024, realizimin faktik si edhe devijancat e realizimit të buxhetit mbi planin e miratuar në Ligjin Fillestar të Buxhetit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024, të ndryshuar”.

Grafiku 5. Plani dhe fakti i shpenzimeve korente për vitet 2020-2024 (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave (2025)

Nga të dhënat e mësipërme, realizimi faktik për shpenzimet korente për Ministrinë dhe Institucionet Qendrore është realizuar në masën 314.62 miliardë lekë nga 286.65 miliardë lekë i planifikuar në Ligjin Fillestar të Buxhetit për vitin 2024 ose në masën 109.7 përqind të këtij plani.


Për të gjitha ndryshimet e planit të buxhetit, informacioni i detajuar sipas Ministrive dhe Institucioneve të Pavarura jepet në Raportin “Për Zbatimin e Buxhetit Faktik për vitin 2024”.

3.4. Detyrimet e Prapambetura

Bazuar në VKM nr.50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, Ministria e Financave ka ndërmarrë disa hapa konkretë në drejtim të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura. Vlen për t’u theksuar se tashmë monitorimi i detyrimeve të prapambetura është një proces i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes monitorimit periodik intensiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera të institucioneve buxhetore. Duke nisur nga muaji Dhjetor 2020, ky monitorim dhe raportim i cili më parë kryhej mbi bazë tremujore nëpërmjet raportimit shkresor të institucioneve, tashmë gjenerohet automatikisht nga SIFQ sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”. Ky format i raportimit të detyrimeve të prapambetura, përveçse rrit saktësinë dhe siguron të dhënat në kohë, është gjithashtu një format gjithëpërfshirës që unifikon raportimin për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Grafiku më poshtë ilustron ecurinë e detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme gjatë 2019-2024:

Grafiku 6. Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme



Burimi: Ministria e Financave (2025)

Konkretisht, deri në fund të muajit Dhjetor 2024 u regjistrua një stok kumulativ prej 7.33 miliardë lekë⁵ i detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat:

- Totali detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 2.66 miliardë lekë
- Totali detyrimeve të qeverisë vendore rreth 3.26 miliardë lekë.

Krahasuar me stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuara për të njëjtën periudhë të vitit 2023, rezulton se:

- Niveli i përgjithshëm i detyrimeve të prapambetura është rreth 524 milionë lekë më i ulët, ose ka një rënie me 6.7 përqind.
- Konkretisht, detyrimet e prapambetura nga qeverisja qendrore janë ulur me rreth 355 milionë lekë dhe detyrimet e prapambetura nga qeverisja vendore janë ulur me rreth 1.58 miliardë lekë.
- Detyrimet për rimbursimin e TVSH-së janë rritur me rreth 1.41 miliardë lekë krahasuar me vitin 2023 kur nuk rezultonin detyrime për këtë zë.

3.4.1. Menaxhimi i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura

Prioriteti kryesor i Ministrisë së Financave në periudhën afatmesme mbetet reduktimi i stokut të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimi i akumulimit të tyre. Në vitet e fundit ky objektivi është arritur dëshmuar nga trendi rënës i stokut, edhe pse faktorë të tillë si tërmeti, pandemia, kriza globale energjetike, lufta në Ukrainë dhe luhatjet e çmimeve të lëndëve të para, kanë ndikuar në likuiditetet e institucioneve qendrore dhe atyre vendore.

⁵ Pa përfshirë detyrimet e prapambetura të Ujësjellës-Kanalizime dhe Universiteteve, si institucione ekstra-buxhetore.

Ndër masat kryesore të ndërmarra në kuadër të menaxhimit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, është miratimi i Urdhërit nr.177 datë 21.07.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e detyrimeve të prapambetura”, i cili ka ngritur grupin e punës nën kryesimin e Nëpunësit të Parë Autorizues dhe me koordinimin e Strukturës përgjegjëse për harmonizimin në MF, duke ngarkuar detyrat që vijnë:

- Monitorimin e shkakut të krijimit dhe ecurinë e detyrimeve të prapambetura;
- Hartimin në fund të çdo tremujori të një raporti përmbledhës për Ministrin e Financave mbi rezultatet e monitorimit të ecurisë së detyrimeve të prapambetura;
- Propozimin e ndërmarrjes së veprimeve për përmirësim dhe ndryshime të nevojshme të sistemeve lidhur me zvogëlimin dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Raportet përmbledhëse tremujore të detajuara sipas kategorive të zërave të detyrimeve si dhe sipas institucioneve, publikohen dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.⁶

Nga ana tjetër, vendosja e objektivave specifike dhe të matshëm nga partnerët ndërkombëtarë në kuadër të strategjive apo programeve të përbashkëta, si Vlerësimi PEFA dhe ERP, kanë ndihmuar në mbajtjen nën kontroll dhe reduktimin e stokut të detyrimeve të prapambetura në vitet e fundit. Këto objektivat kanë parashikuar nivelin e pranueshëm për treguesin e nivelit të stokut dhe konkretisht janë përcaktuar:

Vlerësimi PEFA – (A score)

- Stoku i detyrimeve të prapambetura nuk kalon 2 përqind të totalit të shpenzimeve, në të paktën dy nga tre vitet e fundit fiskalë. Ky target, është arritur për vitin 2022, 2023 dhe 2024.

ERP

- Targeti i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme si përqindje e totalit të shpenzimeve faktike për vitin 2024 nuk duhet të kalojë vlerën 2 përqind në nivel vjetor. Ky target, është arritur për vitin 2022, 2023 dhe 2024.

Lidhur me detyrimet e prapambetura të NJVQV, Drejtoria e Financave Vendore në MF, në zbatim të udhëzimit të nr.26 datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, harton çdo vit raportin për statusin e gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore bazuar në të dhënat zyrtare të detyrimeve të prapambetura të konsoliduara dhe të regjistruara në sistemin e thesarit. Më tepër detaje lidhur me detyrimet e prapambetura të NJVQV, paraqiten në kapitullin e risqeve të Financave Vendore.

Më tej, Ministria e Financave u ka sugjeruar të gjitha njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në “Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së auditimit për vitet 2024–2026” të përfshihen angazhime të auditimit për analizimin dhe vlerësimin e gjendjes së detyrimeve të prapambetura të institucioneve buxhetore. Kjo, për sa kohë detyrimet e prapambetura përcaktohen si fushë me risk të lartë dhe që duhen të trajtohen me prioritet nga auditimi i brendshëm i institucioneve buxhetore.

Këto dhe masa të tjera të ndërmarra nga Ministria e Financave kanë ndihmuar në mbajtjen nën kontroll të stokut të detyrimeve të prapambetura dhe në arritjen e të gjithë objektivave të vendosur në fillim të vitit 2024.

⁶ Raportet përmbledhëse 3 mujore të detyrimeve të prapambetura gjenden në linkun: <https://financa.gov.al/detyrimet-e-prapambetura/>

4. Risqet Fiskale të Lidhura me Borxhin Publik dhe Mjetet Monetare Disponibël

4.1. Borxhi Publik

4.1.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës

Borxhi publik gjatë vitit 2024 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat makro-fiskale, buxhetin e planifikuar për vitin 2024 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB). Huamarrja u realizua në linjë me Buxhetin dhe me Planin e Huamarrjes së vitit 2024. Nëpërmjet huamarrjes u mundësua refinancimi i borxhit ekzistues, si edhe financimi i deficitit buxhetor. Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 404.2 miliardë lekë, nga të cilat 93.6% (ose 378.4 miliardë lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 6.4% (ose 25.8 miliardë lekë) nëpërmjet burimeve të huaja. Ministria e Financave emetoi tituj shtetërorë në vlerën 378.4 miliardë lekë në tregun e brendshëm, nga të cilët 196.7 miliardë lekë Bono Thesari dhe 181.7 miliardë lekë Obligacione. Huamarrja neto në tregun e brendshëm për vitin 2024 rezultoi në vlerën 49.9 miliardë lekë. Huamarrja e jashtme bruto u realizua në nivelin 25.8 miliardë lekë. Gjatë vitit 2024, strukturat e Ministrisë së Financave përgjegjëse për menaxhimin e borxhit kanë vijuar përpjekjet në drejtim të reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm. Gjatë kësaj periudhe, menaxhimi i risqeve të portofolit të borxhit ka mundur të evoluojë në drejtim të objektivave strategjikë afatmesëm duke shfaqur përmirësim të ndjeshëm të të gjithë treguesve të riskut në krahasim me fundin e vitit 2023. Përmirësimi i mëtejshëm i strukturës së borxhit, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të refinancimit dhe riskut të normave të interesit do vijojë të mbetet fokusi kryesor në menaxhimin e borxhit, në mënyrë që tregues të këtyre risqeve të tregojnë përmirësim të mëtejshëm në periudhat në vijim.

4.1.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës

Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Shtetëror në MF, përgatit dhe publikon Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB), e cila synon të përmirësojë më tej strukturën e borxhit (kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm), në drejtim të reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve, si dhe mbajtjes së kostove në nivelet më të ulëta të mundshme. Në kuadër të menaxhimit të risqeve të portofolit të borxhit, janë përcaktuar disa objektiva kryesore për periudhën afatmesme, realizimi i të cilave ka për qëllim reduktimin ose mbajtjen nën kontroll të risqeve në periudhën afatmesme.

Risqet të cilat janë evidentuar në portofolin e borxhit shtetëror janë si më poshtë:

➤ *Risqet e tregut*

• *Risku i Refinancimit të Borxhit të Brendshëm Shtetëror*

Një ndër objektivat kryesore të SAMB është reduktimi i riskut të refinancimit kryesisht në portofolin e borxhit të brendshëm, pasi borxhi i jashtëm paraqet më pak risk duke qenë se është i përbërë nga instrumente me afat të gjatë maturimi dhe me profile amortizimi të shtrira gjatë në kohë. Gjatë vitit 2024, në përputhje me SAMB, Ministria e Financave ka rritur peshën e emetimeve të instrumenteve afatmesme dhe afatgjata në tregun e brendshëm dhe si rezultat, treguesit e riskut të refinancimit kanë shfaqur përmirësim të ndjeshëm krahasuar me fundin e vitit 2023. Konkretisht, jetëgjatësia e borxhit të brendshëm (ditët mesatare në maturim) është rritur me 88 ditë, nga 835 ditë në fund të vitit 2023 në 923 ditë në fund të vitit 2024. Gjithashtu, pesha e borxhit që maturohet brenda një viti ka shënuar përmirësim krahasuar fundin e vitit 2023, ku konkretisht, ky tregues është ulur nga 44.7% në dhjetor 2023 në 39.0% në dhjetor 2024. Sa i përket profilit të maturimeve në portofolin e borxhit, borxhi i brendshëm përbëhet nga instrumente me afat maturimi nga 3 muaj deri në maksimumi 15 vite⁷. Ndërkohë, borxhi i jashtëm ka një profil maturimi që zgjat deri në vitin 2053, ku një pjesë e kredive italiane lejojnë një shtrirje të tillë afatgjatë, e ndjekur nga një sërë kredish nga BEI, IBRD dhe IFAD.

⁷ Deri në Dhjetor 2024, instrumenti më afatgjatë në tregun e brendshëm ka qenë Obligacioni 15 vjeçar. Në vitin 2025 është prezantuar për herë të parë Obligacioni 20 vjeçar.

- *Risku i Normave të Interesit të Borxhit të Brendshëm Shtetëror*

Risku i normave të interesit, gjithashtu ka shfaqur përmirësim gjatë vitit 2024, kjo në rrethanat e përdorimit të shtuar të titujve afatmesëm dhe afatgjatë si edhe emetimit vetëm të titujve më norma interesi fikse në tregun e brendshëm. Konkretisht, pesha e borxhit që rivlerëson normën e interesit brenda vitit është ulur ndjeshëm nga 45.4% në fund të vitit 2023 në 39.3% në fund të vitit 2024. Gjithashtu, është rritur koha mesatare në rifiksim nga 2.33 vite në dhjetor 2023 në 2.58 vite në muajin dhjetor 2024.

- *Risku i Kursit të Këmbimit*

Risku i kursit të këmbimit është mbajtur nën kontroll duke qëndruar nën tavanin e përcaktuar në strategji. Konkretisht, totali i stokut të borxhit në valutë ndaj stokut të borxhit total rezultoi 41.9% në fund të vitit 2024, duke u ulur me 3.8 p.p krahasuar me fundin e vitit 2023, si dhe është ulur me 7.9 p.p, krahasuar me fundin e vitit 2021, një përmirësim i ndjeshëm. Gjatë vitit 2024 ky tregues është ndikuar pjesërisht nga nënçmimi i pjesës më të madhe të valutave të huaja, kryesisht Euros dhe USD, kundrejt Lekut dhe si rezultat i huamarrjes së re që është realizuar pothuaj tërësisht në tregun e brendshëm. Treguesit kryesor të këtyre risqeve për vitet 2020–2024, si dhe objektivat afatmesëm të tyre, janë paraqitur tek Tabela 6.

➤ *Risqe të përgjithshme*

- *Risku i tejkalimit të planifikimit të shpenzimeve për interesa të borxhit shtetëror*

Për vitet 2020-2024 raporti i shpenzimeve për interesa ndaj PBB-së ka qenë mesatarisht në nivelin prej 2 përqind, duke variuar nga 34.4 miliardë lekë në 54.5 miliardë lekë. Ndërkohë, devijimi i shpenzimeve faktike për interesa kundrejt parashikimeve të shpenzimeve për interesa, vlerësohet të jetë i ulët dhe në çdo vit shpenzimet reale kanë qenë brenda parashikimeve në buxhet. Përveç kësaj, me qëllim zvogëlimin në maksimum të riskut fiskal nga rritja e shpenzimeve për interesa përtej fondit të planifikuar në buxhet, në parashikimet e shpenzimeve të interesave janë përfshirë kontingjenca për të përballuar ndonjë rritje të konsiderueshme të normave të interesit apo dhe efekte të mundshme të kursit të këmbimit, të cilat gjatë viteve të fundit nuk janë materializuar.

- *Risku i thirrjes për pagesë të garancive shtetërore*

Risku potencial që vjen nga borxhi i garantuar konsiston në pagesat e mundshme nga buxheti i shtetit të detyrimeve që nuk mund të paguhen nga subjektet huamarrëse. Në fund të vitit 2024, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 33.6 miliard lekë ose 342.2 milion Euro (1.3% e PBB), duke shënuar një rënie me 7.8 miliard lekë krahasuar me fundin e vitit 2023. Garancitë e dhëna në favor të kreditorëve të huaj zënë rreth 57.8% të stokut total të borxhit të garantuar ose 19.4 miliardë lekë, ndërsa garancitë në tregun e brendshëm përfaqësojnë 42.2% të stokut të borxhit të garantuar ose 14.2 miliardë lekë⁸. Nga totali i stokut të garancive, mbi 75 përqind e totalit të garancive shtetërore i përkasin sektorit të energjisë, duke reflektuar politikat e qeverisë në drejtim të mbështetjes së sektorit të energjisë.

⁸ Të dhëna më të detajuara për garancitë mund të gjenden tek Regjistri i Borxhit i publikuar në faqen e MF: <https://financa.gov.al/regjstri-i-borxhit/>

4.1.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara

Për të zbutur risqet e evidentuara të portofolit të borxhit shtetëror janë marë disa masa, të cilat synojnë të vazhdojnë të zbatohen dhe në vitin në vijim:

- *Parashikimi i kontingjencave në parashikimin e shpenzimeve për interesa të vitit buxhetor pasardhës.*

Gjatë viteve të fundit, ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit ka ardhur duke u zbutur, kryesisht për shkak të rikompozimit të portofolit të borxhit të brendshëm në drejtim të titujve afatgjatë me norma interesi fikse. Gjithashtu, duke filluar nga viti 2017, në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në LOB, në buxhetin e shtetit janë programuar kontingjenca të veçanta për të absorbuar efektet e mundshme të normave të interesit. Konkretisht, në buxhetin e vitit 2025 janë parashikuar 5.78 miliardë lekë kontingjenca.

- *Përmirësimi i treguesve të riskut në përputhje me objektivat e përcaktuar në SAMB.*

Lidhur me reduktimin e risqeve të portofolit të borxhit, strategjia aktuale targeton disa tregues më agresiv për periudhën afatmesme duke u fokusuar specifikisht në: (i) Emetimin e titujve shtetërorë me norma interesi fikse për të reduktuar riskun e normave të interesit; (ii) Rritjen e peshës së titujve afatgjatë me qëllim reduktimin e riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit; (iii) Uljen e tavanit për raportin e borxhit në valutë ndaj totalit të borxhit për periudhën afatmesme nga 55 përqind në 50 përqind të totalit. Gjithashtu, në kuadër të plotësimit të nevojave të qeverisjes qendrore për huamarrje, struktura përgjegjëse për hartimin e SAMB-së, në mënyrë të vazhdueshme vlerëson kushtet e tregjeve financiare për të përcaktuar burimet potenciale të financimit të cilat njëkohësisht ruajnë risqet në nivele të pranueshme.

- *Përfshirja dhe zbatimi i rregullit fiskal në LOB: “Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të PBB-së”. Ky rregull nuk përfshin ndryshimet e mundshme në vlerën e emetuar të stokut të borxhit që vijnë si rezultat i ndryshimeve në kursin e këmbimit..*
- *Lidhur me riskun nga garancitë shtetërore, në çdo planifikim buxhetor parashikohet fondi që mund të nevojitet në rast të pagesave të garancive të thirrura. Ky parashikim bazohet nga historiku i kredive dhe përfshihet brenda zërit të ripagesave të borxhit të jashtëm si edhe zërit të interesave.*
- *Gjithashtu, mbi riskun e thirrjes së garancive, SAMB ka përcaktuar zbatimin e kriterëve të mëposhtme për lëshimin e këtij instrumenti, konkretisht garancitë do të emetohen: (i) në drejtim të ndërmarrjeve shtetërore, të cilat kanë ndërmarrë një iniciativë reformuese me impakt në përmirësimin e situatës financiare të tyre; (ii) për financimin e projekteve të investimit; (iii) për mbështetjen e masave që ndërmerren në rastet e ndonjë krize të sistemit financiar; (iv) për qëllime ristrukturimi të portofolit të garancive shtetërore. Gjithashtu, procesi i nënshkrimit dhe miratimit të garancive, si dhe hapat që ndiqen në rast mosshlyerje nga ana e huamarrësve rregullohen nëpërmjet klauzolave të veçanta, pjesë të Ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*

4.1.4. Të dhëna analitike

Tabela 6. Treguesit e riskut

Indikatorët e Riskut	2020	2021	2022	2023	2024	Objektiv afatmesëm 2026
Risku i normave të interesit						
Borxhi që rifiksohet brenda 1 viti	46.7%	48.0%	49.0%	45.4%	39.3%	Max 43%
Koha Mesatare në Rifiksim	2.14	2.19	2.17	2.33	2.58	Min 2.5
Risku i rifinancimit						
Borxhi që maturohet brenda 1 viti	44.8%	46.6%	47.9%	44.7%	39.0%	Max 40%
Koha Mesatare në Maturim	2.18	2.20	2.17	2.32	2.56	Min 2.5
Risku i Kursit të Këmbimit						
Pesha e Borxhit në Valutë të Huaj/Totalit	47.4%	49.8%	46.8%	45.6%	41.9%	Max 50.0%

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Tabela 7. Pagesat dhe Kthimet e Garancive të Huaja

Garancitë e Huaja (në milionë lekë)	2020	2021	2022	2023	2024
Paguar MF	2,712.30	2,202.88	4,108.74	2,905.30	2,643.38
Paguar institucioni përfitues	1,274.78	2,966.99	1,290.10	3,488.05	3,649.91
Kthyer Institucioni përfitues	81.56	154.30	629.05	1,289.99	612.11
Paguar neto MF per periudhen	2,630.74	2,048.58	3,479.69	1,615.31	2,031.27
Stoku i detyrimeve te papaguara	16,241.35	17,809.81	20,059.65	19,531.97	20,294.50


Burimi: Ministria e Financave (2025)

Tabela 8. Pagesat dhe Kthimet e Garancive të Brendshme

Garancitë e Brendshme (në milionë lekë)	2020	2021	2022	2023
Paguar MF principal	0.00	0.00	0.00	6.54
Paguar institucioni principal	960.04	5,894.44	5,071.60	3,291.33
Paguar interes institucioni	0.00	21.41	220.13	635.13

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Grafiku 7. Garancitë sipas sektorëve



Burimi: Ministria e Financave (2025)

4.2. Mjetet Monetare Disponibël

4.2.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës

Gjatë vitit 2024 likuiditeti i qeverisë ka rezultuar i mjaftueshëm për të kryer pagesat e faturave të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhe pagesat e shërbimit të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm. Pagesat janë kryer në kohë dhe sipas metodës FIFO. Procesi i parashikimit dhe menaxhimit të likuiditetit është përmirësuar. Parashikimi i flukseve monetare të TSA hartohet në baza ditore/javore/mujore. Parashikimet përditësohen çdo ditë në bazë të evidencës së Bankës së Shqipërisë për transaksionet hyrëse dhe dalëse nga TSA-ja. Norma mujore e saktësisë së parashikimit për vitin 2024 rezulton në 90% nga 91% që ishte targetuar dhe 88% që ishte në vitin 2023. Vlerat e parashikuara (KMBL) të fluksit të parasë në TSA si mesatare mujore ishin 90.80 miliardë lekë, ndërsa vlerat aktuale ishin 100.85 miliardë lekë.

Të ardhurat mujore të qeverisë në vitin 2024 rezultuan të përafërta me parashikimet. Shpenzimet kanë ndjekur ecuri të ngjashme me vitet e mëparshme. Në periudhën janar-nëntor shpenzimet faktike janë më të ulta se parashikimet në masë të konsiderueshme, ndërkohë që në muajin dhjetor kryhen një pjesë shumë e madhe e shpenzimeve të planifikuara për vitin buxhetor. Në janar 2025 u paguan 57 miliardë lekë fatura të vitit të mëparshëm, shuma më e lartë e paguar ndonjëherë në muajin janar të viteve të mëparshëm.

Instrumentet kanë qenë të ndryshme për të siguruar menaxhimin aktiv të parasë për të përmbushur detyrimet e qeverisë, si:

- *SWAP (2 kontrata me 120 milionë EUR secila, të nënshkruara në 2023 dhe të maturuara në vitin 2024),*
- *Outright (60 milionë EUR konvertuar në monedhën ALL),*
- *Outright (10 miliardë lekë konvertuar në monedhën Euro)*
- *Depozita të gjendjes së tepërt të përkohshme në TSA.*

Në Udhëzimin plotësues Nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025” (hartuar në vitin 2024) u përfshi për herë të parë përcaktimi i nivelit të “buffer-it” të gjendjes së TSA-së në të gjitha monedhat (ALL, EUR, USD dhe SDR), sipas paragrafeve 79-80 të Udhëzimit, cituar më poshtë:

79. Niveli “buffer” i gjendjes monetare të Llogarisë Unike të Thesarit përcaktohet nga kombinimi i dy komponentëve:

- Niveli “buffer” transaksional, minimumi i të cilit përcaktohet në 1% të PBB-së së vitit të mëparshëm;
- Niveli “buffer” i sigurisë, minimumi i të cilit përcaktohet në shumën e shërbimit të borxhit të jashtëm dhe të brendshëm për tre muajt e ardhshëm;
- Niveli i përgjithshëm i “buffer” përcaktohet të jetë midis 1% - 2% PBB-së së vitit të mëparshëm fiskal.

80. Për sa përcaktuar më sipër niveli i “buffer” mund të jetë fleksibël gjatë zbatimit në përshtatje me kushtet aktuale. Nivelet e përcaktuara shërbejnë si orientim, por nuk janë të detyrueshme dhe mund të përshtaten sipas nevojës dhe situatave të ndryshme të paparashikuara

Gjatë vitit 2024 janë përdorur dy instrumente të rinj si vijon:

- *Depozita në euro, pa kufizim në limit si rezultat i rishikimit të marrëveshjes së përbashkët me Bankën e Shqipërisë.*
- *Konvertimi i valutës ALL nga gjendja e TSA-së në monedhat e huaja USD dhe SDR, u përdor për herë të parë si rezultat i rishikimit të marrëveshjes me Bankën e Shqipërisë mbi instrumentet e ofruara për menaxhimin e likuiditetit të Ministrisë së Financave (datë 20 janar 2015, e ndryshuar), përkatësisht (i) Protokollin nr. 3293 i Ministrisë së Financave, datë 11.03.2024) dhe (ii) Protokollin nr. 12574 i Ministrisë së Financave, datë 27.06.2022 (investimi në dispozicion të MF është depozita pranë BSH në vlerën maksimale prej 20 miliardë lekë dhe term 2-mujor).*

4.2.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës

- Avancimet e planeve mujore të thesarit nga dhjetori në periudhat e mëparshme të vitit për mosparashikim të saktë nga njësitë shpenzuese të qeverisjes qendrore dhe vendore;
- Flukse dalëse të konsiderueshme të paparashikuara në lekë ose valutë;
- Mosrealizimi i ankandëve të huamarrjes;
- Mosrealizimi i mbështetjeve buxhetore;
- Fondet paradhënie për kontratat të rëndësishme strategjike.

4.2.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara

- Kryerja e avancimeve të planeve mujore të thesarit vetëm midis kategorive të shpenzimeve të një njësie shpenzuese ose brenda njësitë të varësisë të një institucioni buxhetor, pa impakt në limitet mujore të miratuara;
- Treguesi i performancës nr. 10 "Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës", i cili përcakton vlerën e avancimeve të kryera gjatë vitit nga njësitë shpenzuese kundrejt totalit të planit vjetor të arkës është raportuar për rreth 10% të njësitë shpenzuese.
- Detyrimi i institucioneve buxhetore "pilot" (MAS, MBZHR dhe Bashkia Tiranë) në paraqitjen e parashikimeve të planit të arkës të përditësuar me frekuencë mujore.
- Marrja parasysh në parashikimet e likuiditetit të mosrealizimeve të mundshme të ankandëve të huamarrjes dhe mbështetjeve buxhetore (përgatitja e një skenari pesimist);
- Përmirësimi i informacionit për shqyrtim nga KMBL, i cili ka për qëllim hartimin e informacionit mbi menaxhimin e borxhit dhe likuiditetit të qeverisë për vendimmarrje eficiente.

Propozime për masa të reja:

- Hartimi i mekanizmave të tjera nxitëse për institucionet buxhetore përmes matjes së performancës së tyre.
- Hartimi dhe monitorimi i treguesve kryesorë të performancës (KPI) për parashikimin e likuiditetit dhe prezantimi i tyre në KMBL.
- Shtrirja e detyrimit për paraqitjen e parashikimeve të planit të arkës pranë ministrisë përgjegjëse për financat me frekuencë mujore në institucionet buxhetore kryesore qendrore dhe vendore.
- Funksionimi i mekanizmit të njoftimi paraprak nga institucionet buxhetore në MF për kryerjen e pagesave të mëdha të paparashikuara nëpërmjet "shared folder" për t'u informuar në kohë reale sapo lind nevoja.

4.2.4. Të dhëna analitike

Tabela 9. Devianca Janar-Dhjetor 2024 e gjendjes së TSA

Gjendja e TSA	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Parashikim KMBL	63.00	60.39	77.28	85.11	89.75	105.90	110.08	109.71	112.28	116.36	131.54	28.15
Fakt	56.18	59.17	80.83	86.70	100.19	110.01	111.93	113.31	123.23	119.26	134.34	115.04
% Fakt/KMBL	89%	98%	105%	102%	112%	104%	102%	103%	110%	102%	102%	409%

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Tabela 10. Treguesi i performancës sipas strategjisë së PFM 2023-2030

Treguesi i performancës	Formula	Baza	Fakt 2023	Objektivi 2024	Fakt 2024	Target 2025
Norma mujore e saktësisë së parashikimit	Vlerat e vlerësuara të fluksit të parasë/Vlerat aktuale të fluksit të parasë	88%	88%	91%	90%	93%

Burimi: Ministria e Financave (2025)

5. Risqe Fiskale të Lidhura me Financat Vendore

5.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës

Gjatë vitit 2024 është evidentuar një performancë pozitive e financave të pushtetit vendor. Kontributi i njësive vendore në ekonomi arriti në vlerën rreth 1.7% të PBB, ndërkohë që shpenzimet faktike të tyre arritën në rreth 3.1% të PBB. Krahasuar me parashikimet, totali i të ardhurave të njësive vendore u realizua në masën 103% kundrejt planit vjetor 2024 dhe nga ana tjetër shpenzimet u realizuan deri në masën 90% të planit. Gjithashtu, edhe gjatë vitit 2024 vazhduan të ndërmerren hapa në drejtim të konsolidimit financiar në nivel vendor. Kryesisht nga ana e Ministrisë së Financave fokusi ka qënë në vazhdimin e zbatimit të metodologjisë së re për hartimin e programimit buxhetor afatmesëm në nivel produkti, ku gjatë 2024 filloi implementimi edhe në 3 bashki të tjera pilot. Ndërkohë ka vazhduar në mënyrë periodike menaxhimi i vështirësive financiare që finalizohet me raportin vjetor zyrtar mbi gjendjen financiare të 73 njësive. Së fundmi, si çdo vit edhe përgjatë 2024 janë monitoruar në mënyrë të vazhdueshme treguesit fiskalë të zbatimit të buxhetit vjetor. Për më tepër, një vështrim më i detajuar i ecures së treguesve sasiorë dhe i tërësisë së proceseve që kanë ndikuar në këtë ecure prezantohet në raportin vjetor të financave publike vendore⁹.

5.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës


Risqet kryesore me të cilat përballen njësitë vendore janë akumulimi i detyrimeve të prapambetura, niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe realizimi faktik i të ardhurave dhe buxhetit vendor.

➤ Detyrimet e prapambetura

Detyrimet e prapambetura, janë një ndër risqet më potenciale për pushtetin vendor. Rritja e nivelit të detyrimeve të prapambetura mund të shoqërohet me probleme likuiditeti për njësitë vendore. Në këtë kuadër, qeveria po i kushton vëmendje nxitjes së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes vendore.

Ministria e Financave, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, harton çdo vit një plan veprimi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit dhjetor 2024, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha bashkitë në Ministrinë e Financave është rreth 3.26 miliardë lekë. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me rreth 1.58 miliardë lekë krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2023.

Grafiku 8. Detyrimet e prapambetura në nivel vendor



Burimi: Ministria e Financave (2025)

Çdo vit Ministria e Financave përgatit një raport për vlerësimin e gjendjes financiare të njësive vendore, ku përcaktohen ato njësi që kanë probleme/vështirësi financiare. Në vitin 2024, Ministria e Financave ka hartuar raportin për statusin e vështirësive financiare të NJVQV-e për vitin 2023⁶, ku ka rezultuar se 8 njësi vendore kanë

⁹ Raportet e financave vendore gjenden në faqen: <https://financa.gov.al/buxheti-i-pushtetit-vendor/>

qenë me probleme financiare dhe 7 njësi vendore me vështirësi financiare. Ministria e Financave do të vijojë me publikimin e raportit në vitin 2025, për vlerësimin e gjendjes financiare të NJVQV-ve për vitin 2024.

➤ *Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme*

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme u akordohet njësisë të qeverisjes vendore nga buxheti i shtetit në formë granti, pa destinacion, pa interes dhe pa të drejtë kthimi. Ky grant përdoret me vendim të këshillave të qeverisjes vendore për mbulimin e shpenzimeve për përmbushjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve bazë për komunitetin.


Në bazë të ligjit nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” transfera e pakushtëzuar duhet të jetë:

- jo më pak se 1 për qind e produktit të brendshëm bruto, të parashikuar në raportin për vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike të miratuar nga Këshilli i Ministrave;
- jo më e vogël se shuma totale e ndarë në vitin e mëparshëm buxhetor.

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme duke qenë një garanci e mbështetur në parimet e sipërcituara ligjore, si një risk potencial për pushtetin vendor, ka të bëjë më së shumti me ndryshimin e numrit të popullsisë në njësinë vendore, pasi numri i popullsisë rezidente është një nga elementët kryesorë të shpërndarjes së saj. Megjithatë formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar që përcaktohet në nenin 24, të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, përmban edhe elementë të tjerë si dendësia e popullsisë, numri faktik i fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki, si dhe elementët e ekualizimit që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, por edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal, të cilat në mënyrë të detajuar janë të përcaktuara në Aneksin 1 të ligjit vjetor të buxhetit, për vitin 2024 në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”.

Të dhënat e mëposhtme tregojnë mbi realizimin e këtyre kushteve në shpërndarjen e transfertës së përgjithshme të pakushtëzuar:

Grafiku 9. Transferta e pakushtëzuar në periudhën t-3 deri në t+2 dhe ritmi i ndryshimit të saj



Burimi: Ministria e Financave (2025)

Duke qenë se transfera e pakushtëzuar e përgjithshme lidhet drejtëpërdrejt me nivelin e Produktit të Brendshëm Bruto, rritja e saj nga viti 2023 në vitin 2024 me 7.5% ka të bëjë pikërisht me rritjen e vazhdueshme të PBB-së, si edhe shtesat që u bënë me akt normativ gjatë vitit 2024. Në vitin 2025 rritja ndaj vitit 2024 rezulton me rreth 1.7% dhe parashikimi i deritanishëm për dy vitet e tjerë në vazhdim është që kjo transfertë të rritet me 5.2% dhe 5.1% në vlera nominale.

➤ *Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor*

Në tabelë paraqiten të dhënat për të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor sipas parashikimit makroekonomik gjatë periudhës 2022 - 2027.

Tabela 11. Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor në periudhën t-3 deri në t+2

Milionë lekë	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Të ardhura nga Pushteti Vendor	27,638	31,686	40,331	40,774	42,931	46,573
Pesha ndaj PBB-së	1.29%	1.37%	1.66%	1.56%	1.56%	1.61%
Ritmi i ndryshimit të të ardhurave vendore	3.6%	14.6%	27.3%	1.1%	5.3%	8.5%
Të ardhura nga Pushteti Vendor plan	27,632	27,742	39,314	40,774	42,931	46,573
Devijimi (fakt-plan)	6	3,944	1,017	0	0	0
Buxheti lokal	58,694	68,841	74,407	89,911	93,077	97,733
Pesha ndaj PBB-së	2.74%	2.98%	3.06%	3.43%	3.38%	3.37%
Ritmi i rritjes	11.6%	17.3%	8.1%	20.8%	3.5%	5.0%
Buxheti lokal plan	61,460	66,473	82,750	89,911	93,077	97,733
Devijimi (fakt-plan)	-2,766	2,368	-8,343	0	0	0

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Gjatë viteve 2022 - 2024, të ardhurat e pushtetit vendor kanë shënuar tejkalim të ndjeshëm të parashikimeve makroekonomike, kryesisht për shkak të rritjes së mbledhjes së taksës mbi ndikimin në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksës së pasurisë së paluajtshme dhe tarifat e pastrimit. Në vitin 2023, të ardhurat tejkaluan planin me 3.9 miliard lekë ose 4.05 miliard më të larta se në 2022.

Në vitin 2024, të ardhurat e pushtetit vendor sërish tejkaluan pritshmëritë. Fillimisht parashikimi makroekonomik i miratuar me ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, ishte 29.1 miliardë lekë, por gjatë vitit u rishikua në 39.3 miliardë lekë me Aktet Normative, për shkak të ritmit të lartë të realizimit. Deri në fund të vitit, të ardhurat tejkaluan edhe këtë nivel, me rreth 1 miliardë lekë më shumë se plani dhe 27.3% më shumë se realizimi vitit 2023, duke reflektuar një rritje shumë më të lartë se rritja e PBB-së prej 5.3%. Të ardhurat vendore në vitin 2024 përfaqësuan 1.7% të PBB-së, një nivel më i lartë se mesatarja historike prej 1.3-1.5% e PBB-së, si dhe më e lartë krahasuar me peshën prej nën 1% që kishin para reformës territoriale të vitit 2016.

Rritja u regjistrua në të gjitha kategoritë kryesore të të ardhurave: i. “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” pati rritjen më të madhe, me 5.5 miliardë lekë ose 42% më shumë; ii. “Taksa mbi pasurinë e paluajtshme” u rrit me 24%; iii. “Tarifat e pastrimit dhe higjienës” u rritën me 1.1 miliardë lekë, ose 24%; iv. “Taksa e fjetjes në hotel” pati një rritje prej 53% nga viti i kaluar.

Sa i përket shpenzimeve, në vitin 2024 buxheti faktik vendor ishte 8.1% më i lartë se në 2023, por më i ulët se plani i rishikuar, për shkak të rritjes së ndjeshme të të ardhurave. Devijimi fakt-plan pasqyron përdorimin e dispozitave ligjore që lejojnë trashëgiminë e fondeve të papërdorura, duke treguar fleksibilitet në menaxhimin buxhetor vendor.

5.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara

Masat e marra për zbutjen e riskut:

- Lidhur me riskun e detyrimeve të prapambetura një nga masat e marra edhe gjatë vitit 2024 ishte politika për reduktimin e tyre tek njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet shtesës së transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme prej 1.43 miliard lekë për shlyerjen e detyrimeve, sipas Aktit Normativ nr.5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar”.
- Po në këtë kuadër, rishikimi i ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” lidhur me përdorimin e shpenzimeve faktike në formulën e përlllogaritjes së vështirësive financiare të njësitë të

vetëqeverisjes vendore, si dhe përdorimi i fondeve të trashëguara të paangazhuara për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe nënhuave të njësive të vetëqeverisjes vendore, ka dhënë rezultatet e veta për uljen e detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor.

- Lidhur me riskun e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme, si një risk potencial për pushtetin vendor, që mund të vijë nga ulja e numrit të popullsisë në njësinë vendore, duke qenë që numri i popullsisë rezidente është një nga elementët kryesorë të shpërndarjes së saj, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, përmban edhe elementë të tjerë, si dhe elementët e ekualizimit që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, por edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal, (të cilat në mënyrë të detajuar janë të përcaktuar në Aneksin 1 të ligjit vjetor të buxhetit), të cilat mundësojnë që transfertat e pakushtëzuar të jetë jo më e vogël se shuma totale e ndarë në vitin e mëparshëm buxhetor, jo vetëm në tërësinë e saj por edhe për çdo njësi vendore gjithashtu.

Masat për zbutjen e riskut në të ardhmen:

- Monitorim periodik i procesit buxhetor për 61 bashkitë dhe 12 qarqet. Përmirësimi i raporteve të përgatitjes së buxhetit vjetor, monitorimit dhe programit buxhetor afatmesëm duke u fokusuar tek përdorimi me efektivitet dhe efikasitet i fondeve publike.
- Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, në ligjin nr.68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” të ndryshuar dhe ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, në kuadër të autonomisë së tyre të veprimit në fushën e mbledhjes së taksave, të marrin masa për të mbështetur rritjen e të ardhurave të veta dhe diversifikimin e burimeve të të ardhurave vendore, duke: *rritur cilësinë e shërbimeve për të cilat vendosen taksa e tarifa; *duke rritur hapësirën e mbuluar me shërbim në territorin e bashkisë; *duke rritur efektivitetin e mbledhjes së taksave nëpërmjet fuqizimit të drejtorisë / sektorit të mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave apo trajnimit dhe kualifikimit të punonjësve të kësaj drejtorie / sektori; etj.
- Përmirësimi i raporteve të Monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe Programit Buxhetor Afatmesëm duke u fokusuar tek shlyerja e detyrimeve të prapambetura dhe parandalimi i krijimit të tyre.
- Në kuadër të transparencës, përgatitja e tabelës fiskale për pushtetin vendor, ku do të jenë të detajuara fondet nga të ardhurat vendore dhe transfertat ndërqeveritare plan/fakt.
- Publikimi i raportit “Mbi statusin e gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore 2024”, ku do të identifikohen njësitë me probleme, vështirësi financiare, vështirësi serioze financiare dhe paaftësi paguese.
- Lidhur me detyrimet e prapambetura, MF në vijim të publikimit të raportit “Mbi statusin e gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore” do të kërkojë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me probleme/vështirësi financiare që:
 - Të evidentojnë shkaqet që çojnë në akumulimin e detyrimeve financiare të prapambetura për bashkinë.
 - Të përcaktojnë reagimin/vendimet e menaxhimit të lartë (Kryetari, Këshilli Bashkiak), gjatë periudhës së raportimit, për parandalimin apo trajtimin e riskut të krijimit/shtimit të detyrimeve të prapambetura, me qëllim mos rëndimin e situatës financiare të bashkisë.
 - Të evidentojnë vështirësitë që ka hasur bashkia për shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura.
 - Të hartojnë planin e masave për menaxhimin e riskut në të ardhmen, emërtuar në udhëzim si plani i shlyerjes së detyrimeve financiare të prapambetura. Në planin e masave përfshihet shlyerja e detyrimeve në vlerë çdo vit si edhe masat përkatëse që çojnë në vlerën e përlllogatur për shlyerje.

6. Risqet Fiskale të Lidhura me Koncesionet/PPP me mbështetje buxhetore

6.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës

Ministria e Financave nëpërmjet Drejtorisë së Koncesioneve harton çdo vit Raportin Vjetor të Përmbledhur që është pjesë e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit. Raporti për vitin 2024 publikohet çdo vit si aneks i raportit vjetor të zbatimit të buxhetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe kuadrin ligjor për koncesionet/PPP. Ai përmban një pamje të përgjithshme të portofolit aktual të Koncesioneve/PPP, performancën e kontratave koncesionare, informacion në lidhje me ecurinë e investimit dhe zbatimit, ecurinë e pagesave buxhetore të parashikuara dhe të realizuara, si dhe risqet që rrjedhin nga këto kontrata koncesioni/PPP. Me qëllim rritjen e transparencës mbi zbatimin e koncesioneve/PPP, forcimin e disiplinës financiare, monitorimin e risqeve fiskale dhe buxhetore që burojnë nga kontratat e koncesionit/PPP, është miratuar Ligji Nr. 50 datë 18.07.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar” dhe Udhëzimi nr.35 datë 12.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të standardeve mbi raportimin dhe monitorimin e ecurisë financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat nga Autoritetet Kontraktuese”.


Gjatë vitit 2024, MF ka vijuar monitorimin e performancës së kontratave koncesionare/PPP-ve me mbështetje buxhetore, duke monitoruar ecurinë e pagesave faktike buxhetore dhe treguesit e performancës të planifikuar/realizuar, për secilën kontratë koncesionare/PPP. Monitorimi dhe raportimi mbi kontratat koncesionare/PPP është i institucionalizuar përmes përfshirjes në Udhëzimin Plotësues nr.1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo Autoritet Kontraktor dhe të formateve standarde respektive, me qëllim thellimin e analizës dhe rritjen e transparencës. Ky monitorim kryhet në bazë mujore, me qëllim identifikimin dhe monitorimin hap pas hapi të risqeve potenciale që mund të materializohen nga implementimi i tyre.

Në nivel total rezulton se:

- Për vitin 2024 rezultojnë 11 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore.
- Janë realizuar pagesa faktike për 10 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore.
- Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2024, sipas planit vjetor me ndryshime, me destinacion mbështetjen nga buxheti për kontratat koncesionare/PPP, rezultojnë rreth 13.64 miliardë lekë.
- Pagesat faktike për vitin 2024, në total rezultuan në rreth 13.29 miliardë lekë ose 97.4 përqind e planit vjetor 2024, me ndryshime.

Numri i kontratave PPP me mbështetje buxhetore, përgjatë 6 viteve të fundit të ndarë sipas sektorëve ekonomik jepet në grafikun e mëposhtëm. Në vitin 2023 ka hyrë në fuqi kontrata me mbështetje buxhetore “Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë”, e cila i përket sektorit të transportit me një kohëzgjatje prej 10 vitesh. Referuar modelit financiar të kësaj kontrate, për tre vitet e para nuk parashikohen të kryhen pagesa nga buxheti i shtetit.

Grafiku 10. Ndarja e kontratave me mbështetje buxhetore sipas sektorëve



Burimi: Ministria e Financave (2025)

Lista e të gjitha kontratave aktive koncesionare/PPP si dhe e kontratave që parashikohen për vitin në vijim është e publikuar në paketën e projektbuxhetit të çdo viti si shtojcë në dokumentin e relacionit shoqërues. Tabela e mëposhtme paraqet pagesat buxhetore për kontratat koncesionare/PPP aktive me mbështetje buxhetore.

Tabela 12. Koncesionet/PPP aktive me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit


Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Programi	Lloji i shpenzimit	2022	2023	2024	2025	2026	në mijë Lekë
							Fakt	Fakt	Fakt	Plan	PBA	2027
Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë		Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2022	06220	Investime	376,385	0	0	0	0	0
	1	Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit	2018	2031	04520	Investime	2,940,000	2,844,000	3,504,000	3,360,000	3,360,000	3,360,000
	2	Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot-Morinë	2017	2047	04520	Investime	740,978	666,563	608,601	660,000	720,000	720,000
	3	Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës Porti i Jahteve - Bypass Orkum - Dukat (Ura e Shën Elzës)	2021	2034	04520	Investime	224,698	726,787	786,380	860,000	956,000	956,000
	4	Projektimi, Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë	2023	2032	04540	Investime	0	0	0	0	0	0
Ministria e Financave	1	Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë	2013	2030	01150	Korrente	1,925,903	1,540,310	1,411,985	1,573,698	1,620,909	1,669,537
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë (Check-up)	2015	2025	07220	Korrente	876,083	876,083	876,083	876,090	876,090	876,090
	2	Koncesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steri nëpërdorueshëm në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2016	2026	07330	Korrente	1,699,975	1,749,982	1,755,835	1,900,000	500,000	0
	3	Ofrimi i shërbimit të hemodializës	2016	2026	07330	Korrente	802,583	849,129	894,392	960,000	0	0
	4	Ofrimi i shërbimeve laboratorike mjekësore	2020	2030	07330	Korrente	1,612,914	1,718,879	1,802,818	1,900,000	1,950,000	2,000,000
Bashkia Tiranë / Ministria e Arsimit dhe Sportit	1	Për Përmirësimin e Infrastruktursë Arsimore në Bashkinë e Tiranës "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbrojtjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tiranë 1 dhe për 4 objektet arsimore në zonën Tiranë 4"	2018	2026	09230	Investime	395,074	698,074	722,121	707,571	685,286	655,426
Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë / Bashkia Tiranë	1	Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimit ekzistues Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike	2017	2047	06220	Korrente	1,046,397	989,797	931,363	1,180,000	1,270,200	1,270,200
	11	TOTALI					12,640,991	12,659,602	13,293,576	13,977,359	11,938,485	11,507,253
Totali i të Ardhurave Tatimore							541,342,220	598,661,930	658,847,210	709,854,478	748,349,269	789,954,889
Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)							2.66%	2.34%	2.22%	2.12%	1.68%	1.54%

Burimi: Ministria e Financave (2025)

6.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës

Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontratat koncesionare/PPP, si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.

Grafiku 11. Shpenzimet buxhetore për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore



Burimi: Ministria e Financave, Autoritetet Kontraktore (2025)

Konkretisht, për vitin 2024, vërehet se:

- Kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, përllogaritet në rreth 29.93 miliardë lekë.
- Pagesat vjetore neto të realizuara (faktike) nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, për vitin 2024 rezultuan në masën rreth 13.29 miliardë lekë dhe kjo vlerë përbën vetëm 2.22 përqind të totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2023.

Ndërkohë, për vitin 2025:

- Kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5 përqind i të ardhurave tatimore faktike të vitit 2024, është rreth 32.9 miliardë lekë.
- Referuar planit të pagesave buxhetore për vitin 2025, raportuar nga Autoritetet Kontraktore përkatëse, pagesat vjetore neto që parashikohen të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat koncesionare/PPP, rezultojnë rreth 13.98 miliardë lekë. Kjo vlerë përbën vetëm rreth 2.12 përqind të totalit të të ardhurave tatimore faktike për vitin 2024.

6.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara

Lidhur me respektimin e rregullit fiskal, për vitin 2024, si dhe në të gjitha vitet e mëparshme, është respektuar neni 4/2 i ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ku përcaktohet se “...shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP)”. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t’u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Një nga risqet që Ministria e Financave ka hasur përgjatë viteve të fundit ka qenë mungesa e raportimeve në kohë dhe mangësitë e informacionit që përmbajnë raportimet në bazë të anekseve të Udhëzimit nr. 35 datë 12.12.2019. Ministria e Financave ka propozuar që në ndryshimet e ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik të përfshihet një klauzolë me penalitete për Autoritetet Kontraktuese/personat përgjegjës për mosraportim tek Ministria e Financave në zbatim të legjislacionit të zbatueshëm. Gjithashtu, Ministria e Financave ka vijuar me kërkimin e zbatimit të detyrimit ligjor nga ana e Autoriteteve Kontraktuese me anë të shkresave të përsëritura.

7. Risqet Fiskale të Lidhura me Ndërmarrjet Publike me Kapital Shtetëror


7.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës

Në mbështetje të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndërmarrjet shtetërore u shndërruan në shoqëri tregtare, ku e drejta e pronësisë së tyre nuk është vetëm e Ministrisë së Financave, por në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore respektive kjo e drejtë i kaloi edhe institucioneve të tjera qendrore dhe vendore sipas fushës së tyre të përgjegjësisë. Pas kësaj reforme, disa nga kompanitë strategjike në sektorin e energjisë dhe përpunimit të naftës kaluan në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila gjithashtu zotëron shumicën e aksioneve të shoqërive të Ujësjellës Kanalizimeve. Ndërkohë, kompani të tjera kanë kaluar në pronësi të Pushtetit Vendor apo institucioneve të tjera qendrore, ose janë privatizuar.

Referuar publikimit më të fundit të INSTAT (Shtator 2024) mbi sektorin publik në Shqipëri, numri total i institucioneve jashtëbuxhetore është 179, të cilat kategorizohen si më poshtë:

- ✓ 57 Extra-buxhetore qeveria qendrore
- ✓ 82 Extra-buxhetore qeveria lokale
- ✓ 37 Ndërmarrje publike jo-financiare
- ✓ 2 Ndërmarrje publike financiare
- ✓ 1 Banka e Shqipërisë

Grafiku 12. Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve



Burimi: INSTAT (2025)

Bazuar në statusin e tyre, ndërmarrjet e formës “Shoqëri Aksionare – sh.a” rregullohen nga Ligji nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ndërsa ndërmarrjet e formës “Ndërmarrje Publike” rregullohen nga Ligji nr.758, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet tregtare shtetërore”. Gjithashtu, janë dhe disa ndërmarrje të cilat rregullohen me ligj të veçantë, siç është Radio Televizioni Shqiptar (RTSH), i cili mban statusin e personit juridik publik dhe funksionon në bazë të Ligjit nr.97, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në RSH”. Po ashtu dhe Autoriteti Portual Durrës (APD) është gjithashtu person juridik publik i cili funksionon në bazë të Ligjit nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”. Ndryshim të statusit pritet të ketë dhe shoqëria Albcontrol sh.a., e cila me miratimin e Ligjit nr. 40, datë 02.05.2024 “Për ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror “Albcontrol””, parashikohet të ndryshojë nga shoqëri aksionare në person juridik publik nën mbikqyrjen e Ministrisë përgjegjëse për çështjet e transportit ajror. Deri në fund të 2024, procesi i transformimit të statusit nuk ka përfunduar ende. Në proces rristurimi është dhe shoqëria Hekurudha Shqiptare sh.a., e cila nëpërmjet Ligjit nr. 90, datë 01.07.2021 “Për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare sh.a.”, i ndryshuar, është vendosur të ndahet në dy shoqëri pritëse, përkatësisht përgjegjëse për infrastrukturën hekurudhore dhe për transportin e udhëtarëve dhe mallrave. Ky ligj u ndryshua në Dhjetor të vitit 2024, duke i kaluar të drejtën e pronësisë së kësaj ndërmarrjeje Ministrisë përgjegjëse për transportin hekurudhor. Kjo e drejtë më përpara ushtrohej nga Ministria përgjegjëse për ekonominë.

Lidhur me portofolet kryesore të shoqërive, Ministria e Financave për vitin 2024 ka në pronësi tre ndërmarrje shtetërore: Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a, Agro kredit sh.a dhe Nxitja e Biznesit Social sh.a.

Përsa i përket Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëritë në të cilat ato zotërojnë shumicën e aksioneve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 13. NSH-të në pronësi të MEKI dhe MIE për vitin 2024

Pronësia e Ndërmarrjeve Shtetërore sipas Formës Ligjore		MEKI		MIE	
		100% pronësi	mbi 50% pronësi	100% pronësi	mbi 50% pronësi
Shoqëri Aksionare Sh.A.		5	7	5	14
Strategjike	OST sh.a	x			
	Posta Shqiptare sh.a	x			
	Albcontrol sh.a	x			
	Korporata e Investimeve Shqiptare sh.a (AIC)	x			
	Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a	x			
	"Albpetrol" sh.a			x	
	Hekurudha Shqiptare sh.a			x	
	Albgaz sh.a			x	
	"OSHEE" sh.a			x	
	"KESH" sh.a			x	
Jostrategjike	Porti Detar Shëngjin sh.a		x		
	Porti Detar Vlorë sh.a		x		
	Porti Detar Sarandë sh.a		x		
	Regjistri Detar Shqiptar sh.a		x		
	Albafilm sh.a		x		
	Trajtimi i Studentëve Korçë sh.a		x		
	Qendra e Regjistrimit të Aksioneve sh.a		x		
	14 Drejtoritë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizimeve sh.a.				x
Ndërmarrje Publike		1	0	1	0
Strategjike	Ndërmarrja industriale Nr.1 Tiranë	x			
Jostrategjike	Ndërmarrja e Prodhim Celiqeve, Elbasan			x	

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Në zbatim të LOB-it, specifikisht nenit 4/2 ku përcaktohet se "...Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujore, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme përfituese të fondeve buxhetore dhe/ose garancive shtetërore, dorëzohen në Ministrinë e Financave...", dhe të Udhëzimit Plotësues nr. 1/2024 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024", Ministria e Financave monitoron periodikisht mbi baza tremujore, performancën financiare të NSH-ve kryesore, krahas edhe dy entiteteve të tjera RTSH dhe APD, me qëllim evidentimin e impaktit potencial që këto ndërmarrje mund të kenë mbi buxhetin e shtetit. Procesi i monitorimit ka për qëllim analizimin e performancës financiare dhe jo financiare të ndërmarrjeve kryesore publike. Në këtë kuadër, ndërmarrjet kryesore nën monitorim paraqiten të listuara në tabelën e mëposhtme:

Tabela 14. NSH-të e monitoruara për vitin 2024

Nr.	Pronësia e NSH-ve nën monitorim	MEKI	MIE	Të tjera
1	OSHEE Group sh.a		•	
2	KESH sh.a		•	
3	OST sh.a	•		
4	UKT sh.a		•	
5	UKD sh.a		•	
6	Hekurudha Shqiptare sh.a		•	
7	Posta Shqiptare sh.a	•		
8	AlbGaz sh.a		•	
9	Albcontrol sh.a	•		
10	Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)			•
11	Albpetrol sh.a		•	
12	Autoriteti Portual Durrës (APD)			•
TOTAL		3	6	2

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Në vijim, paraqiten treguesit kryesor ekonomik dhe financiar të NSH-ve të monitoruara nga MF¹⁰.

Tabela 15. Treguesit ekonomik dhe financiar lidhur me NSH-të kryesore dhe dy entiteteve të tjera (jo me status sh.a) të monitoruara për vitin 2024, në milionë lekë.

Emri i Subjektit	Të ardhurat	Shpenzimet	Humbje /Fitim	Total Aktive	Total Detyrime	Kapital	Marzhi i Fitimit	Raporti Korent	(Debt Ratio) Tot Detyrime /Tot Aktive
OSHEE Group sh.a	74,717	67,434	7,283	111,673	135,105	(23,431)	0.10	0.59	1.21
KESH sh.a	26,746	27,124	(379)	174,026	81,167	92,859	-0.01	1.39	0.47
OST sh.a	10,880	9,082	1,798	83,022	40,028	42,995	0.17	0.60	0.48
UKT sh.a	4,834	3,853	982	29,344	15,633	13,712	0.20	0.78	0.53
HSH sh.a	890	950	(60)	85,482	9,808	75,674	-0.07	0.27	0.11
AlbGaz sh.a	42	145	(103)	1,432	684	748	-2.48	9.92	0.48
Albcontrol sh.a	3,587	3,567	19	20,218	13,125	7,093	0.01	2.92	0.65
RTSH	2,270	2,816	(546)	3,394	2,072	1,322	-0.24	0.43	0.61
Albpetrol sh.a	6,010	6,503	(494)	51,066	16,196	34,870	-0.08	1.32	0.32
APD	3,016	2,924	92	12,470	1,803	10,667	0.03	1.01	0.14
Posta Shqiptare sh.a.	3,229	3,252	(23.5)	-	-	-	-	-	-
Total	136,220	127,651	8,569	572,128	315,620	256,508	-	-	-
%mbi PBB-në nominale për vitin 2024	5.46%	5.12%	0.34%	22.94%	12.65%	10.28%	-	-	-

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Referuar të dhënave në tabelën më sipër, për vitin 2024, konstatohet se ndërmarrjet shtetërore si OST dhe UKT rezultojnë me një marzh fitimi relativisht të lartë prej rreth 20 përqind. Me një fitim pozitiv paraqiten edhe shoqëritë OSHEE Group, Albcontrol dhe APD. Ndërkohë, KESH, AlbGaz, HSH, RTSH dhe Albpetrol rezultojnë me një performancë jo të mirë financiare, argumentuar si më poshtë:

- *KESH sh.a. evidenton se humbja e shënuar në vitin 2024 është ndikuar kryesisht nga mungesa e prurjeve hidrike, e cila ndikoi ndjeshëm në uljen e prodhimit të energjisë, duke reduktuar kështu të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike, ndërkohë që detyrimi për furnizim me energji për konsumatorët universal sipas DSHP mbeti i pandryshuar.*
- *Sipas informacionit të përcjellë nga AlbGaz sh.a, pavarësisht realizimit të plotë të planit të të ardhurave, gjendja aktuale financiare e shoqërisë regjistron humbje, për shkak të volumit të lartë të shpenzimeve operative.*
- *Performanca jo e mirë e Hekurudhës Shqiptare, ka ardhur kryesisht si rezultat i investimeve që po realizohen në modernizimin e linjës hekurudhore Durrës-Tiranë (linjë fitimprurëse për HSH), e cila është përkohësisht jashtë funksionit.*
- *Ndikim në performancën financiare të RTSH-së, ka pasur mosrealizimi i të ardhurave kryesisht si pasojë e moszbatimit të disa ndryshimeve të planifikuara në tarifën e shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv dhe uljes së komisionit të agjentit tatimor, si dhe nga pengesat në realizimin e investimeve kapitale të lidhura me rikonstrukcionin e Ateliesë së Re. Po ashtu, të ardhurat nga reklamat dhe burime të tjera alternative nuk u arritën sipas pritshmërive.*
- *Rezultati financiar negativ (humbje) nga Albpetrol Sh.A në vitin 2024 lidhet kryesisht me mosrealizimin e të ardhurave nga shitja e naftës, i ndikuar jo nga sasia, por nga çmimi më i ulët i shitjes krahasuar me programin, si dhe me mungesën e prodhimit dhe pagesës së detyrimeve nga kontraktori për gazin në vendburimin Delvinë.*

¹⁰ Për vitin 2024, nuk ka pasur raportim nga Ujësjetllës Kanalizime Rajonale Durrës (UKRD). Mos raportimi i të dhënave financiare në kohë nga ana e subjektit argumentohet me vonesat në miratimin e pasqyrave të tyre financiare.

Nga ana tjetër, vërehet se KESH, AlbGaz, Albcontrol dhe Albpetrol, shfaqen me aftësi të mira paguese në drejtim të shlyerjes së detyrimeve afatshkurtra, duke rezultuar me një nivel të lartë likuiditeti.

Ndërmarrjet me raport të ulët borxhi (detyrime totale mbi aktivet) janë Hekurudha Shqiptare, APD dhe Albpetrol, duke treguar një pozicion financiar të qëndrueshëm. Ndërsa, ndërmarrjet me raport të lartë borxhi janë Albcontrol dhe veçanërisht OSHEE Group, duke treguar paaftësi financiare për shlyerjen e detyrimeve.

Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur në mënyrë të përmblëdhur detyrimet në formë nënhuaje apo garancie që ndërmarrjet shtetërore kanë ndaj MF për periudhën 2016-2024.

Tabela 16. Detyrimet nënhua dhe garanci të ndërmarrjeve shtetërore ndaj MF

Viti (mln lekë)	Sektori Energjetik*			Sektori i Ujit**			NSH-të tjera***			Total		
	Nënhua	Garanci	Total	Nënhua	Garanci	Total	Nënhua	Garanci	Total	Nënhua	Garanci	Total
2016	5,219	4,482	9,701	4,908	1,222	6,130	5	270	275	10,133	5,974	16,107
2017	8,279	7,051	15,330	5,656	1,345	7,001	55	295	350	13,990	8,690	22,680
2018	12,689	9,169	21,858	5,982	1,381	7,363	43	466	510	18,714	11,017	29,731
2019	16,981	11,049	28,030	6,409	1,494	7,903	6	806	812	23,396	13,349	36,746
2020	22,772	13,187	35,960	7,177	1,651	8,828	8	1,191	1,199	29,957	16,030	45,987
2021	27,129	14,291	41,420	7,982	1,742	9,724	9	1,530	1,538	35,119	17,563	52,682
2022	28,779	16,259	45,038	8,600	1,771	10,371	9	1,785	1,794	37,388	19,815	57,203
2023	31,063	15,626	46,689	8,542	1,722	10,264	9	1,938	1,948	39,615	19,286	58,901
2024	35,034	16,213	51,247	8,862	1,733	10,595	314	2,121	2,435	44,211	20,067	64,278

* Sektori Energjetik përfshin ndërmarrjet shtetërore: OSHEE Group sh.a, KESH sh.a dhe OST sh.a..

** Sektori i Ujit përfshin të gjitha ndërmarrjet Ujësjellës Kanalizime sh.a..

*** NSH-të tjera përfshin ndërmarrjet shtetërore: ARMO sh.a, Hekurudha Shqiptare, Servcom sh.a, Albpetrol sh.a dhe RTSH.

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Në tabelën e mëposhtme, paraqiten fondet buxhetore në formë subvencioni (Plan/Fakt), ndër vite, i cili planifikohet kryesisht për ato ndërmarrje shtetërore të cilat nuk arrijnë të mbulojnë koston/shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes. Procedurat mbi alokimin e këtyre fondeve përcaktohen në udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”.

Tabela 17. Subvencionet për ndërmarrjet shtetërore nga viti 2016-2024

Viti (mln lekë)	Subvencionimi buxhetor për:					
	NSH-të e U-K		Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare		Hekurudhën Shqiptare	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
2016	430	429	90	90	390	390
2017	1,000	975	114	111	400	400
2018	1,000	951	275	273	400	400
2019	400	400	275	275	400	400
2020	720	712	294	294	400	400
2021	380	354	270	270	400	400
2022	360	360	328	328	501	501
2023	310	310	308	308	490	490
2024	350	350	312	311	500	500

Burimi: Ministria e Financave (2025)

7.1.1. Sektori Energjetik

Gjatë vitit 2024, sektori energjetik ka shënuar një rënie të performancës financiare, si rezultat i: (i) kushteve të pafavorshme meteorologjike në vend gjatë tremujorit të fundit të vitit, dhe si rrjedhojë, (ii) e rënies së prurjeve në kaskadën e Drinit, që ka ulur nivelin e prodhimit të energjisë vendase nga KESH sh.a. përgjatë 2024. Konkretisht, niveli i basenit të Fierzës deri në muajin Dhjetor 2024 ishte në kuotën 267.3 metra. Ky nivel shënoi kuotën më të ulët për 10 vitet e fundit për të njëjtën periudhë, gjithashtu është më i ulët krahasuar dhe me kuotën mesatare të 30 viteve të fundit prej 277.5 metra.

Krahasuar me vitin 2023 vërehet se:

- *Niveli i përgjithshëm i prodhimit neto vendas, ka pësuar rënie me rreth 11.6 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Konkretisht, gjatë 12M 2024 prodhimi neto vendas shënon vlerën 7.84 TWh, kundrejt 8.80 TWh realizuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë.*
- *KESH sh.a realizoi një nivel prodhimi neto publik prej rreth 4.37 TWh, kundrejt 5.13 TWh realizuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke rezultuar me një rënie rreth 14.8 përqind.*
- *Sa i përket humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, për vitin 2024 ato rezultuan në nivelin 17.9 përqind, duke shënuar një rënie kundrejt një viti më parë, ku humbjet ishin 18.9 përqind.*
- *Niveli i arkëtimeve të OSHEE Group sh.a. për vitin 2024 arriti në nivelin 100.5 përqind, duke rezultuar me një rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku niveli i arkëtimeve rezultonte në vlerën 99.4 përqind, gjë që dëshmon stabilitetin e shoqërisë në këtë drejtim.*

Në terma të riskut fiskal, impakti i sektorit si kosto financiare apo të ardhura të munguara në financat publike për vitin 2024, vlerësohet rreth 6.05 miliardë LEK nga rreth 5.29 miliardë lekë në vitin 2023, duke treguar një rritje të ndikimit të sektorit në financat publike. Kjo situatë u ndikua nga kushtet jo shumë të favorshme atmosferike që ulën ndjeshëm nivelin e prodhimit vendas të energjisë nga KESH sh.a dhe performancën financiare të kësaj shoqërie. Projektet e investimeve me financim të huaj për sektorin e energjisë për vitin 2024 u miratuan në nivelin 2 miliardë LEK sipas buxhetit fillestar të miratuar me Ligjin nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, dhe nuk patën rishikime gjatë vitit buxhetor.

Ekspozimi ndaj sektorit të energjisë elektrike dhe madhësia aktuale e detyrimeve kontingjente në lidhje me këtë sektor, paraqitet në tabelat e mëposhtme:

Tabela 18. Mbështetja buxhetore e sektorit të energjisë (plan/fakt) për periudhën 2022-2024

	2022		2023		2024	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Financim nga buxheti i shtetit (në milionë lekë)	30,100	28,474	14,000	873	2,000	308
Hua e dhënë për Sektorin e Energjisë	8,000	7,907	-	-	-	-
Mbështetjen buxhetore për sektorin energjetik	20,000	20,000	12,000	-	-	-
Financimi i huaj për sektorin e energjisë	2,100	567	2,000	873	2,000	308

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Tabela 19. Të dhëna mbi impaktin e sektorit të energjisë në financat publike¹¹

	2020	2021	2022	2023	2024
Ndikimi në financat publike (në milionë lekë):	5,240	5,504	33,017	5,286	6,045
1. Garancitë dhe nënhatë e paguara nga MF	5,240	5,407	32,973	5,285	6,045
Garanci të paguara nga MF	2,069	1,504*	2,989	1,149	1,631
Projekte me financim të huaj të nënhuazuara	3,172	3,903	2,077	4,136	4,414
Hua e dhënë për energjinë	-	-	7,907**	-	-
2. Mbështetje buxhetore për sektorin energjetik			20,000**	0***	-
3. Detyrimet Tatimore (Vjetore)	0.1	97.3	43.4	0.1	0.5

Burimi: Ministria e Financave (2025)

¹¹ *Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë (OSHEE Group sh.a.) nëpërmjet instrumentit të garancisë sovranë në shumën 10,000 milionë lekë për vitin 2021 me anë të aktit normativ nr.31, datë 27.10.2021.

**“Hua e dhënë për energjinë” planifikuar në shumën 8,000 milionë lekë për vitin 2022 (realizimi aktual është 7,907 milionë lekë) dhe “Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë” planifikuar në shumën 20,000 milionë lekë për vitin 2022 (realizimi aktual është 20,000 milionë lekë).

***“Mbështetja buxhetore për sektorin e energjisë” planifikuar në shumën 12,000 milionë lekë për vitin 2023, nëpërmjet Aktit Normativ nr.5 datë 18.10.2023, u rishpërnda për zërat e tjerë të shpenzimeve publike, bazuar në situatën e qëndrueshme të sektorit për vitin aktual.

7.1.2. Detyrimet e ndërsjella të Ndërmarrjeve të Sektorit Energjetik/MF/DPT dhe ML/IB

Në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkëfirmosën Urdhërin e Përbashkët nr.379/2021 datë 30.09.2021 “Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, nëpërmjet së cilit, ndërmarrjet e sektorit energjetik raportojnë në mënyrë periodike mujore, mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërsjella ndërmjet sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Përgjatë vitit 2024, në përputhje me udhëzimin e sipërcituar, MF ka monitoruar periodikisht mbi bazë mujore detyrimet e ndërsjella të raportuara nga ndërmarrjet e sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Nga ana e ndërmarrjeve të sektorit energjetik raportohet se, një pjesë e detyrimeve të ndërsjella janë shlyer sipas planit të masave për reduktimin e tyre.

Pavarësisht një rënie të lehtë të përgjithshme në performancën financiare të sektorit energjetik gjatë vitit 2024, u arrit një reduktim i stokut total të detyrimeve të ndërsjella në krahasim me vitin 2023. Një faktor që ka ndikuar në situatën aktuale, janë edhe vonesat e ndërmarrjeve U-K në shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella.

Sidoqoftë, ndërmarrjet e sektorit energjetik konfirmojnë se angazhimi i tyre mbetet maksimal në drejtim të përmbushjes me sukses të marrëveshjeve për likuidimin tërësor të stokut të detyrimeve të ndërsjella.

Tabela 20. Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarrjeve të sektorit energjetik, ML/IB, MF dhe DPT

Deri në Dhjetor 2024 (në mld lekë)	KESH	OST	OSHEE	MF	DPT	Total
KESH ndaj:		0*		40.15		40.15
OST ndaj:	10.81*		0.30	8.32		19.43
OSHEE ndaj:	46.9**	8.4**		2.78	4.28	62.37
Ndërmarrjet UK ndaj:			32.60	10.60		43.20
ML/IB			6.10			6.10
Total	57.71	8.40	39.00	61.85	4.28	171.24

* Vlera e detyrimeve të ndërsjella varion nga 0-0.10 mld lekë për KESH ndaj OST dhe nga 10.81-14.67 mld lekë për OST ndaj KESH, për arsye të mosrakordimit mes kompanive.

**Vlera e detyrimeve të ndërsjella varion nga 46.9-53.05 mld lekë për OSHEE ndaj KESH dhe nga 8.4-17.11 mld lekë për OSHEE ndaj OST, për arsye të mosrakordimit mes kompanive.

Burimi: MF, KESH, OST, OSHEE Group, AKUK (2025)

7.1.3. Risqet e sektorit energjetik

- **Risku i Tregut të Energjisë:** Nga një risk josistematik me karakter afatshkurtër, risku i tregut të energjisë është kthyer në një risk sistematik për shkak të paqëndrueshmërisë së zgjatur gjeopolitike dhe fragmentarizimit të furnizimeve me karburante. Pavarësisht një stabilizimi të përkohshëm gjatë vitit 2023, rritja e tensioneve në Lindjen e Mesme dhe vazhdimi i konfliktit Rusi-Ukrainë rritën ndjeshëm pasiguritë në tregjet ndërkombëtare, duke sjellë luhatshmëri të çmimeve dhe rritje të ekspozimit ndaj kostove të importit, krahasuar me planifikimin fillestar.
- **Risku Hidrik:** Thelluar nga efektet e klimës dhe varësia pothuajse totale e KESH nga prodhimi hidro, po shndërrohet nga një risk josistematik në një risk sistematik dhe strukturor për gjenerimin e energjisë. Gjatë vitit 2024, edhe pse viti pararendës ka shënuar një përmirësim të ndjeshëm të situatës hidrike, mungesa e prurjeve gjatë muajve në vijim ka rritur ndjeshëm ekspozimin ndaj këtij risku, duke ndikuar negativisht në prodhimin energjetik dhe duke detyruar rishikime të planit financiar brenda vitit.
- **Risku i Portofolit të Prodhimit:** Ky risk lidhet me ekspozimin ndaj ndaj mungesës së diversifikimit të burimeve të prodhimit të energjisë dhe varësinë pothuajse totale të KESH dhe të gjithë sektorit energjetik nga burimet hidrike, duke krijuar një mosbalancë sezonale mes prodhimit dhe konsumit që shpesh e kthen vendin në importues neto energjie.

- **Risku i Likuiditetit:** Të tre ndërmarrjet raportojnë një situatë aktualisht të përmirësuar të likuiditetit, por risku vijon të jetë i pranishëm në një perspektivë afatmesme, veçanërisht nëse ndodhin skenarë negativë lidhur me çmimet e energjisë ose me prodhimin e brendshëm. Për OSHEE Group sh.a., risku i likuiditetit kushtëzohet nga detyrimet e trashëguara nga periudha me performancë të dobët (2009–2014), ndërkohë që mbetet i ndjeshëm edhe ndaj vonesave në arkëtimet nga klientët fundorë dhe ecurisë së humbjeve në rrjet. KESH sh.a. sinjalizon gjithashtu rrezik potencial në mbulimin e detyrimeve për investime strategjike në rast të rënies së të ardhurave. OST sh.a. identifikon si faktor shtesë edhe ekspozimin ndaj kursit të këmbimit për huatë në monedhë të huaj dhe vonesat në disbursimet për investimet me financim të jashtëm.

7.1.4. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara

Gjendur në kushtet e ekspozimit të risqeve të sipër përmendura, nën kujdesin e posaçëm të qeverisë, ndërmarrjet e sektorit energjetik, nëpërmjet plan-veprimeve, ndërmorën masa konkrete në menaxhimin e këtyre risqeve, si mëposhtë:

- **Risku i Tregut të Energjisë:** Për të reduktuar rrezikun e materializimit të riskut të tregut të energjisë dhe për të minimizuar varësinë nga importet gjatë vitit 2024, është realizuar kontraktimi për qiramarrjen e aseteve gjeneruese termike me kapacitet 110 MW. Ky kapacitet shtesë përbën një garanci të rëndësishme për optimizimin e prodhimit të brendshëm, veçanërisht gjatë periudhave me mungesë reshjesh. Një tjetër masë e rëndësishme ka qenë sigurimi i energjisë nga impianti fotovoltaiik Karavasta Solar me fuqi 140 MW, tashmë në funksion, i cili garanton furnizim me çmim të rregulluar ankandi ndjeshëm më të ulët krahasuar me çmimet aktuale të bursave rajonale të energjisë, si p.sh. indeksi HUPX.
- **Risku Hidrik:** Menaxhimi i eficient i operimit të Kaskadës gjatë vitit, për maksimizimin e prodhimit hidro dhe njëkohësisht mirëadministrimi i rezervës hidrike, përbën masën kryesore për zbutjen e riskut hidrik. Po ashtu, është duke u punuar për diversifikimin e burimeve të prodhimit, duke aktivizuar alternativa si gjeneruesit termikë dhe impiantet fotovoltaike, për të siguruar furnizimin gjatë periudhave me mungesë prurjesh natyrore.
- **Risku i Portofolit të Prodhimit:** Puna për diversifikimin e burimeve të energjisë do të vazhdojë me përparimin e projekteve fotovoltaike, si ndërtimi i impiantit PV Diga e Zadejës-Vau i Dejës me fuqi 8.25 MW dhe impianti PV lundrues në liqenin e Vaut të Dejës me fuqi 13.8 MW. Këto projekte, së bashku me impiantin PV të Belshit, do të rrisin ndjeshëm kapacitetet gjeneruese të formës fotovoltaike.
- **Risku i Likuiditetit:** Tregtimi i energjisë për konsumatorët 6kV/10kV dhe 20kV përmes bursës së energjisë ALPEX ka ndikuar në sigurimin në kohë të likuiditeteve, duke e kthyer këtë mekanizëm në një mjet të rëndësishëm për reduktimin e riskut të likuiditetit. Kjo ndikon pozitivisht në sigurimin e likuiditeteve për shoqëritë e sektorit, duke kontribuar në ekspozim më të ulët ndaj këtij risku. Po ashtu, kalimi në treg të lirë i konsumatorëve të tensionit 10kV dhe thellimi i reformës së sektorit të energjisë janë hapa afatgjatë që synojnë të stabilizojnë arkëtimet dhe të ulin ekspozimin e KESH ndaj vonesave në pagesa, përmes rritjes së transparencës dhe efikasitetit të tregut.

7.2. Ndërmarrjet e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve

Në kuadër të përmirësimit të monitorimit të ndërmarrjeve shtetërore, Ministria e Financave ka monitoruar disa tregues kryesor financiar të ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizimeve. Treguesit kryesorë të performancës për vitin 2024, për ndërmarrjet e U-K të analizuara, tregojnë për një vijimësi të gjendjes ekzistuese financiare dhe vështirësi në pagimin e detyrimeve dhe mbledhjen e të ardhurave, duke sinjalizuar probleme potenciale të likuiditetit në periudhën afashkurtër. Pasojat nga pandemia COVID19 dhe faktorë të tillë si efektet e krizës globale energjetike, lufta në Ukrainë, luhatjet e çmimeve të energjisë, karburanteve dhe inputeve, kanë patur impakt të konsiderueshëm në vështirësitë financiare të ndërmarrjeve U-K.

Për vitin 2024, buxheti i shtetit ka alokuar një vlerë totale subvencioni 350 milionë lekë në strukturën buxhetore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili detajohet nga AKUK/MIE bazuar në kriteret e përcaktuara në Udhëzimin “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve...”, miratuar nga Ministri përgjegjës për Infrastrukturën dhe Energjinë. Ky subvencion shkon kryesisht për ndërmarrjet të cilat nuk arrijnë të mbulojnë koston/shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes.

Sa i takon stokut të detyrimeve të akumuluar nga ndërmarrjet U-K sh.a ndaj sektorit të energjisë, vlen për t'u theksuar se në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, janë intensifikuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët kryesor. Plani i masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me Urdhërin e Përbashkët MIE/MF nr.304/2020 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, përfshin në procesin e shlyerjes së detyrimeve të ndërsjella edhe sektorin e ujit.

Me qëllim zbatimin me sukses të këtij plani, MIE dhe MF bashkëfirmosën Urdhërin e dytë të Përbashkët nr.379/2021 “Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, i cili ngarkon (krahas ndërmarrjeve të sektorit energjetik) edhe AKUK për raportim mujor mbi ecurinë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të ndërsjella.

Kështu, deri në Dhjetor 2024, OSHEE Group sh.a. raporton se detyrimet e akumuluar të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën rreth 32.9 miliardë lekë. Nga këto, rreth 16.6 miliardë lekë janë detyrime të faturuara ndaj kompanisë dhe rreth 16 miliardë lekë janë detyrime për kamatëvonesa. Nga totali i detyrimeve principal (pa kamatëvonesa), vetëm ndërmarrja e U-K Durrës sh.a ka 5.62 miliardë lekë detyrime të akumuluar në vite. Në tabelën e mëposhtme listohen pesë ndërmarrjet U-K që kanë pjesën më të madhe të detyrimeve (pa kamatëvonesa) ndaj OSHEE Group sh.a, deri në Dhjetor 2024.

Tabela 21. Shoqëritë Ujësijellës-Kanalizime me stokun më të lartë të detyrimeve të prapambetura (principal) ndaj OSHEE Group sh.a, për 12M 2024

	<i>(miliardë/lekë)</i>
5 U-K kryesore me detyrime ndaj OSHEE Group	9.93
Njësia Durrës U-K sh.a	5.62
Njësia Vlorë U-K sh.a	1.86
Njësia Patos U-K sh.a	0.87
Njësia Fier U-K sh.a	0.83
Njësia Kavajë U-K sh.a	0.77

Burimi: AKUK (2025)

Procesi i reformimit dhe riorganizimit të sektorit të ujit vazhdon, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030. Përmes kësaj reforme, në zbatim të VKM nr.302 datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, synohet ridimensionimi i 58 ndërmarrjeve U-K aktuale nëpërmjet rigrupimit të tyre në 15 shoqëri SKP-UK (Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta) rajonale. Kjo, me qëllim rritjen e mirëmenaxhimit dhe performancës së tyre financiare, që pashmangshmërisht do të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme në dobi të mbarëvajtjes së proceseve të punës dhe sidomos shlyerjes së detyrimeve të akumuluar, duke siguruar kështu mos krijimin e tyre në të ardhmen.

Deri në Dhjetor 2024, janë arritur marrëveshjet e transferimit të aktivitetit të shërbimeve ndërmjet 52 ndërmarrjeve U-K dhe si rrjedhojë janë krijuar 14 shoqëri SKP-UK nga 15 të parashikuara sipas reformës. Mbetet pa u firmosur ende marrëveshja e bashkëpunimit për krijimin e shoqërisë rajonale SKP-UK Tirana.

7.3. Të tjera

Informacioni i detajuar mbi ndërmarrjet shtetërore nën monitorimin e MF, përfshirë risqet e identifikuara dhe masat e marra për zbutjen e tyre, është paraqitur në Shtojcën B të këtij Raporti.

Gjatë vitit 2024, procesi i monitorimit është avancuar më tej në krahasim me vitin 2023, përmes përdorimit të mjetit analitik “*SOE Health Check Tool (SOE HCT)*”, i cili ka mundësuar një vlerësim më të strukturuar dhe të krahasueshëm të performancës financiare të ndërmarrjeve publike. Rezultatet e analizave për vitin 2024, të gjeneruara nga ky mjet, janë paraqitur në Shtojcën C.

8. Risqet Fiskale të Lidhura me Detyrimet Kontingjente

8.1. Vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)

Këto vendime kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Ministria e Financave ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ, përmes likuidimit të VKM-ve respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonese për çdo ditë vonese. Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MF ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe procedurale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar skedulimin e detyrimit financiar, sipas mundësive të buxhetit të shtetit me këste, në negociim me përfituesit.

Gjatë vitit 2024, u paguan rreth 288,749 euro (rreth 29.46 milionë lekë) për vendime të GJEDNJ-së, nga të cilat rreth 19.02 milionë lekë janë përballuar nga fondi rezervë i buxheti i shtetit i miratuar për vitin 2024 dhe rreth 10.44 milionë lekë nga fondet e Ministrisë së Financave.

Deri në fund të vitit 2024, detyrimet për vendimet e GJEDNJ-së paraqiten si vijon:

Tabela 22. Detyrimet nga vendimet e GJEDNJ-së (në euro) deri në fund të vitit 2024

Data e Vendimit	Vendimet e GJEDNJ	Detyrimi sipas vendimit të GJEDNJ/VKM	Detyrimi kontingjent	Totali i detyrimit
14.09.2015	Delijorgji kundër Shqipërisë	15,600 €		15,600 €
17.03.2016	Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë (Kërkesa: Dhimërtika dhe Nika k. Shqipërisë)	4,417,750 €		4,417,750 €
11.01.2018	Sharxhi kundër Shqipërisë	13,447,300 €		13,447,300 €
05.03.2024	Iliria s.r.l kundër Shqipërisë	10,800 €		10,800 €
11.06.2024	Zela kundër Shqipërisë	60,000 €		60,000 €
16.07.2024	Meli dhe Swinkels Family Brewers kundër Shqipërisë	17,200 €		17,200 €
05.09.2024	Ndreka kundër Shqipërisë	3,600 €		3,600 €
24.10.2024	Sovjani kundër Shqipërisë		3,600 €	3,600 €
10.12.2024	Ramaj kundër Shqipërisë		14,000 €	14,000 €
17.12.2024	Gaba kundër Shqipërisë		7,100 €	7,100 €
	Totali	17,972,250 €	24,700 €	17,996,950 €

Shënim: Detyrimi sipas vendimit të GJEDNJ/VKM është detyrimi përkatës nga një vendim i formës së prerë të GJEDNJ/VKM-së respektive, i cili rezulton ende i papaguar deri në fund të vitit 2024.

Shënim: Detyrim kontingjent është detyrimi i pritshëm/potencial nga një vendim në shqyrtim ose në pritje për të marrë formë të prerë nga GJEDNJ, i raportuar nga Avokatura e Shtetit deri në fund të vitit 2024.

Burimi: Ministria e Financave, Avokatura e Shtetit (2025)

8.2. Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy ose shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar. Duke pasur parasysh efektet e qenësishme financiare që rëndom shoqërojnë këto vendime, ato vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit. Ministria e Financave, në vazhdimësi ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të përfituesve. Kjo, me qëllim final lehtësimin, reduktimin dhe shmangien e barrës financiare mbi buxhetin e shtetit.

Në vitin 2024, vlera totale e kostove ligjore, të përfaqësimit, mbrojtjes, shpenzimeve gjyqësore apo kostove të tjera lidhura me vendime të Arbitrazhit Ndërkombëtar, të paguara nga buxheti i shtetit rezultoi në masën rreth 4.88 milionë euro. Në vijim paraqiten të dhënat përmbledhëse të detyrimeve për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar, deri në fund të vitit 2024.

Tabela 23. Detyrimet për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në euro)

Ministria e Linjës	Përshkrimi i Vendimeve të Arbitrazhit	Likuidimi 2024	Detyrim i mbetur nga vendimet e Arbitrazhit / kosto ligjore (A)	Detyrime Kontingjente (B)	Totali i Detyrimit (C=A+B)
MIE /ARRSH	ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HHB). <i>JV Copri-Aktor vs ARRS</i> .	0	42,472,629	0	42,472,629
	Kosto ligjore dhe shpenzime gjyqësore ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HHB)	0	225,000	0	225,000
MIE/AK UK	ICC Case 24140/MHM	0	13,492,241	0	13,492,241
	Kosto administrative, të përfaqësimit dhe kosto ligjore për çështjen ICC Case no. 24140/MHM/HHB <i>Construzioni DONDI S.P.A.</i>	0	28,500	0	28,500
MIE	ICC Case No. 20564/EMT/GR <i>Hydro srl</i>	0	142,976	0	142,976
	Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit dhe mbrojtjes së RSH për rrëzimin e kërkesës për rishikimin e vendimit datë 04.06.2019 ICC Case no. 22919/GR.	0	0	111,150	111,150
APD	Kosto administrative dhe ligjore për çështjen ICSID Case no. ARB/20/37 (<i>Durrës Kurum Shipping dhe të tjerë kundër Shqipërisë</i>)	851,000	0	0	0
MIE/APD	Kosto ligjore për çështjen ICSID Case EMS Shipping & Trading GmbH. vs Republikës së Shqipërisë	1,050,000	0	0	0
	Kosto administrative ICSID Case EMS Shipping & Trading GmbH. vs Republikës së Shqipërisë	330,000	0	0	0
MIE/ AKBN/ Albpetrol Sh.a	ICC Case no. 22676/GR GBC Oil Company LTD vs MIE, AKBN dhe Albpetrol	0	12,241,533	0	12,241,533
	Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit të MIE/AKBN në çështjen ICC Case 21349/EMT/GR (<i>BPAL vs MIE/AKBN dhe Albpetrol</i>)	904,528	41,110	0	41,100
Albpetrol Sh.a	Kosto përfaqësimi në çështjen ICC Case Phoenix Petroleum Sha kundër Albpetrol Sh.a	156,868	0	0	0
MF	Kosto paraprake dhe kosto ligjore për çështjen SCC Arbitration 2021/155 <i>IVICOM Holding GmbH</i>	1,013,489	0	0	0
	Përfaqësimi i Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit MIMOZA Ndroqi kundër RSH	0	250,000	395,000	645,000
	Kosto ligjore për këshillim ligjor dhe shërbime konsulence për mosmarrëveshjet dhe arbitrazhet ndërkombëtare	150,000	0	0	0
	Arbitrazhi ICSID nr. ARB/15/28 " <i>Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë</i> "	0	0	108,000,000	108,000,000
	Kosto ligjore lidhur me vendimin e Arbitrazhit ICSID nr. ARB/15/28 " <i>Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë</i> "	224,500	548,295	1,999,780	2,548,075
MBZHR	Kosto administrative dhe ligjore për çështjen PCA Case 2018-49 <i>Valeria Srl vs RSH</i>	200,000	0	0	0
Total		4,880,384	69,442,284	110,505,930	179,948,204

Sqarojmë se, për kontratat të cilat zgjidhen përpara përfundimit të shërbimit të kontraktuar, subjekti likuidohet vetëm për shërbimet e realizuara në funksion të kontratës. Rrjedhimisht nuk ezaurohet e gjithë vlera e përcaktuar në kontratë.

Shënim: Informacioni i mësipërm bazohet në të dhënat më të fundit (Prill 2024) të raportuara në MF nga Avokatura e Shtetit dhe nga ML/TB, ndaj vlerësimet tona janë të sakta për aq sa informacion disponojmë. Tagrin për validimin e tyre e ka vetëm Avokatura e Shtetit.

Shënim: Në tabelën e mësipërme përfshihen detyrime nga vendime përfundimtare të gjykatës së Arbitrazhit dhe detyrime që rrjedhin nga kontratat e lidha mes shtetit shqiptar dhe studiove ligjore/ekspertëve të pavarur etj. (kryesisht për procedura të përfaqësimit dhe mbrojtjes, kundërshtimit/rishikimit/anullimit të një vendimi arbitrazhi apo kosto të tjera administrative/aplikimi/përkthimi etj).

Shënim: Detyrimi i mbetur nga vendime të Arbitrazhit Ndërkombëtar/kosto ligjore është detyrimi i papaguar nga një vendim përfundimtar i gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar ose detyrimi i mbetur (i papaguar) nga kontratat e lidhura mes shtetit shqiptar dhe studiove ligjore/ekspertëve të pavarur, për pjesën e detyrimit që është faturuar nga Avokatura e Shtetit dhe rezulton e papaguar ose detyrimi i cili, bazuar në kontratë, duhet të likuidohet sipas fazave të përcaktuara në kontratë, në nenin përkatës për 'tarifat dhe mënyrën e pagesës'.


Shënim: Detyrim kontingjent është detyrimi i pritshëm/potencial i cili ka gjasa të materializohet në periudhat e ardhshme, konkretisht për vendime të gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar të cilat janë subjekt i procedurave juridike të kundërshtimit/rishikimit/pezullimit/anullimit ose detyrime të pritshme nga kontratat e lidhura mes shtetit shqiptar dhe studiove ligjore/ekspertëve të pavarur, për fazat procedurale të përcaktuara në kontratë të cilat vazhdojnë në rastet kur Tribunali gjen juridiksion dhe vazhdon me fazat e tjera të përcaktuara në kontratë, faza të cilat implikojnë kosto financiare.

Burimi: Ministria e Financave, Avokatura e Shtetit, Ministrinë e Linjës/Institucionet Buxhetore (2025)

8.3. Vendimet gjyqësore administrative, të formës së prerë (Qendrore + Vendore)

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e nivelit të detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore deri në dhjetor 2024, mbi bazë gjashtë mujore.

Grafiku 13. Ecuria e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore (Qendrore + Vendore)



Burimi: Ministria e Financave (2025)

Detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore kanë kryesisht në sfond largimet e padrejta nga puna të ish-punonjësve, të cilat në çdo rast implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Këto detyrime monitorohen dhe raportohen nga Ministria e Financave, në kuadër të monitorimit të përgjithshëm të detyrimeve të prapambetura.

Ministria e Financave, për t'i paraprirë akumulimit të tyre në kohë, përveç një monitorimi periodik, vazhdimisht i ka bërë apel aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit me këste të pagesës për përfituesit apo instrumentave të tjerë të lehtësimit dhe/ose zhvendosjes në kohë të barrës së tyre buxhetore.

9. Risqet Fiskale të Lidhura me Fatkeqësitë Natyrore

9.1. Një vështrim i përgjithshëm narrativ i vitit buxhetor paraardhës

Në vitin 2024, Shqipëria përjetoi një sërë situatash emergjente të fenomeneve të ndryshme natyrore, duke nxjerrë në pah ndjeshmërinë e vendit ndaj ngjarjeve të lidhura me klimën dhe nevojën e mëtijshme për përgatitje dhe rezistencë të shtuar ndaj fatkeqësive. Konkretisht vendi u përball me një nga sezonet më shkatërruese të zjarreve në më shumë se një dekadë. Sipas Sistemit Evropian të Informacionit për Zjarret në Pyje (EFFIS), 168 zjarre shkatërruan afërsisht 46,534 hektarë tokë, duke tejkaluar rekordin e mëparshëm të vendosur në vitin 2012. Qarqet më të prekura rezultuan Gjirokastra, Vlora, Fieri, Shkodra ku humbja e gjerë e bimësisë ka rritur rrezikun e erozionit të tokës dhe përmblytjeve pasuese gjatë muajve të dimrit veçanërisht në ultësirat perëndimore. Megjithatë faktet e raportuara nga NJVV dhe të regjistruara zyrtarisht i referohen zjarrvënies së qëllimshme dhe të papërgjegjshme nga dora e njeriut, dhe jo nga nxehtësia për shkak të temperaturave të larta.

Sa i përket ngjarjeve sizmike, janë regjistruar 28 lëkundje tërmeti me magnitudë rreth 3.0 - 4.5 të shkallës rihter, të cilat janë ndjerë lehtë përreth epiqendrave, por pa shkaktuar probleme në infrastrukturë dhe komunitet. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2024 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka patur në fokus fuqizimin e mëtijshëm të qeverisjes së menaxhimit të riskut të fatkeqësive përmes plotësimit të kuadrit nënligjor në zbatim të Ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, mbledhjen dhe analizën e të dhënave në nivel qendror dhe lokal të veprimtarisë institucionale për llogari të VKM 168/2023, zbatimin e VKM 94/2023 mbi Planin e Veprimit 2023 – 2027 të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut (SKZRF) 2023 - 2030, hartimin e dokumenteve kryesore strategjike në nivel vendor, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të saj në funksion të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, si vend anëtar i Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile (UCPM) dhe vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Përpjekjet për të forcuar mbrojtjen civile janë përqendruar në përmirësimet e infrastrukturës në kuadër të masave parandaluese, lehtësuese dhe rehabilituese, forcimin e kapaciteteve operacionale, rritjen e njohurive dhe trajnimin profesional të personelit të mbrojtjes civile në nivel vendor dhe qendror, sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës. Financiarisht, qeveria e rriti fondin e emergjencës në 5.4 miliardë lekë për vitin 2024, duke ndarë burime për projekte parandalimi të fatkeqësive, mirëmbajtjen e digave dhe përpjekjet e rimëkëmbjes pas fatkeqësive. Më shumë se 15 programe/projekte po realizohen në zbatim të prioriteve strategjike kombëtare me masa dhe aktivitete konkrete që kryqëzohen ndërmjet ministrive të linjës, agjencive qendrore dhe të tjera strukturave përgjegjëse.

Megjithatë, Raporti i Bankës Botërore për Klimën dhe Zhvillimin e Vendit theksoi nevojën që Shqipëria të investojë 6 miliardë dollarë gjatë dekadës së ardhshme për t'u mbrojtur nga fatkeqësitë e shkaktuara nga klima, duke theksuar përfitimet e mundshme ekonomike të masave proaktive të përshtatjes.

Sfidat me të cilat vendi përballë nënvizojnë rëndësinë e investimeve të vazhdueshme në kuadër të Strategjisë ZRF dhe përshtatjes ndaj klimës, plotësimin e kuadrit ligjor dhe instalimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm me shumë risqe (multi-risk approach) për të mbrojtur komunitetet dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm.

9.2. Risqet e evidentuara gjatë vitit buxhetor paraardhës

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile” si dhe VKM nr. 345, datë 26.5.2022, “Për Përcaktimin e Mënyrës së Mbledhjes dhe Administrimit të të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë”, në Tetor 2024, AKMC mundësoi krijimin e Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë e cila në bashkëpunim me AKSHI-n, u fut në grupin e Sistemeve Elektronike Shtetërore me hapësirë dixhitale të krijuar në serverat e AKSHI-t. Procedurat e sistemit të Bazës së të Dhënave organizohen, funksionojnë dhe përcaktohen në bazë të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm të Bazës së të Dhënave Shtetërore për Humbjet nga Fatkeqësitë. Manuali i Përdorimit i datës 28.5.2025 përmbledh të gjitha rolet e përdoruesve të sistemit me qëllim që të përfshihen të gjitha funksionalitetet që ky sistem ofron.

Për shkak të masave të shtuara të sigurisë, si databazë shtetërore, sistemi i të Dhënave të Humbjeve mund të aksesohet vetëm nga përdoruesit e regjistruar përmes sistemit të sigurisë me 2 faktorë.

Mbajtja e të dhënave është një shërbim i qenësishëm dhe gjithëpërfshirës, ku nëpërmjet analizës u jep mundësinë përdoruesve të arrijnë një kuptim të menjëhershëm të ndikimit të fatkeqësive në një vend ose rajon, mundësinë e hulumtimit krahasues dhe është bazë mbështetëse për vendimmarrjen.

Baza e të dhënave do të shërbejë për përgatitjen e raportimeve të ndryshme përfshirë dhe ato studimore ose historike, për përfshirjen në projekte të ndryshme rindërtimi ose kompensimi të dëmeve nga fatkeqësitë, të investimeve nga buxheti i shtetit, për të përmbushur detyrimet ligjore për rishikimin e dokumenteve strategjike të mbrojtjes civile, marrjen e masave dhe raportimin në plotësimin e objektivave të Kuadrit Sendai dhe në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në UCPM.

Pas krijimit të sistemit, janë kryer trajnime fillimisht me stafin e vetë AKMC-së dhe në vijim me personat e caktuar nga bashkitë dhe 12 prefekturat, sipas modulit të trajnimit nr. 10 “Përdorimi i Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë”. Aktualisht, po vijon përgatitja e listës së përdoruesve nga Ministrinë dhe institucione të tjera qendrore për t’u trajnuar. Marrja e të dhënave deri në këtë moment është realizuar në mënyrë shkresore ose me e-mail. Këtë vit do të aplikohet sistemi elektronik i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë.

Për intervalin kohor 2024 janë të regjistruara të dhënat e mëposhtme lidhur me ngjarjet kryesore të fatkeqësive natyrore dhe dëmet e shoqëruara prej tyre. Nga të dhënat duket qartë që numri më i lartë i fatkeqësive është për shkak të zjarrit si në banesa dhe në zonat pyjore.

Tabela 24. Tabela e fatkeqësive natyrore në Shqipëri gjatë vitit 2024

Ngjarja	Nr. i ngjarjeve	Humbje jete	Të plagosur	Shtëpi të shkatërruara	Shtëpi të Dëmtuara	Dëmtime në bujqësi Ha.	Dëmtime në Blegtori Nr.
ZJARR	1624	10	22	81	313	6867.15	154
STUHI	11	0	2	2	464	0	72
AKSIDENT	10	16	15	0	0	0	0
TË TJERA	31	24	81	1	1	0	0
Total	1676	50	120	84	778	6867.15	226

Burimi: DesInventar Sendai (2025)

Tabela 25. Një përmbledhje e humbjeve për periudhën krahasimore 2023-2024

Viti	Nr i ngjarjeve	Humbje jete	Të plagosur	Shtëpi të shkatërruara	Shtëpi të Dëmtuara	Dëmtime në bujqësi Ha.	Dëmtime në Blegtori Nr.
2024	1676	50	120	84	778	6867.15	226
2023	974	19	77	30	152	2187	77
Diferenca	702	31	43	54	626	4680.15	149

Burimi: DesInventar Sendai (2025)

Në menaxhimin e emergjencave të ndodhura gjatë vitit 2024 janë angazhuar dërguar kërkesa dhe oferta për asistencë ndërkombëtare. Drejtuar Emergency Response Coordination Center (ERCC), janë përgjigjur me mjete të angazhuara për shuarjen e zjarreve 2 helikopterë dhe 4 Canadair të qeverisë Greke, 2 Canadair të Qeverisë Italiane, si dhe 2 avionë të Qeverisë Rumune, si dhe një ekspert i ERCC, në bashkitë Dropull, Vlorë, Lezhë, Skrapar, Bulqizë, Pustec, Shkodër, Kukës dhe Mirditë.

Nga Shqipëria janë aktivizuar në ndihmë të Greqisë 159 Forca të Armatosura me 27 mjete për shuarjen e zjarreve, gjithashtu i jemi përgjigjur thirrjes për ndihmë humanitare të Bosnje Hercegovinës gjatë përmbajtjeve në Tetor 2024. Nga ana tjetër, në përgjigje të kërkesave për mbështetje nga pushteti vendor:

- Janë ndërtuar/riparuar 9 ura tip “ Bailey”, ku janë angazhuar gjithsej 758 forca dhe 255 mjete.
- Janë angazhuar në operacione për shkatërrimin e masiveve shkëmbore 325 forca dhe 88 mjete.
- Janë angazhuar 1619 forca dhe 358 mjete në 72 operacione për asgjësim municionesh.
- Është mbështetur Bashkia Vlorë me 300 pako ushqimore gjatë përmbajtjeve të Tetorit 2024.

9.3. Zbutja (mitigimi) i risqeve të evidentuara

Në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe ligjit vjetor të buxhetit, janë miratuar burimet financiare apo instrumentet financiare, të cilët shërbejnë për të mbështetur politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore, si më poshtë:

- *Fondi i Emergjencave Civile, planifikuar në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes/Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, i cili shërben për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe marrjen e masave parandaluese;*
- *Buxheti për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, i Ministrive dhe Institucioneve Buxhetore, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore, ku planifikimi buxhetor duhet të jetë nga 2 përqind deri në 4 përqind e totalit të buxhetit vjetor;*
- *Buxheti i Bashkive, parashikimi minimal prej 4 përqind i totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, akordimi i të cilit bëhet sipas përcaktimeve në Ligjin vjetor të Buxhetit;*
- *Fondi i Solidaritetit, ku AKMC-ja, nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, krijon një fond për mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të ligjit nr.45/2019;*
- *Fondi Rezervë i cili përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme;*
- *Fondi i Kontigjencës, i cili përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara.*

Në zbatim të Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Aneksi nr. 6, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, në programin “Emergjencat Civile” është miratuar Fondi prej 1 000 milionë lekësh në zërin “Shpenzime kapitale” për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, i cili synon të mbështesë politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore. Ky fond u alokua në 30 bashki sipas projekteve të përzgjedhura me VKM Nr.53 datë 01.02.2023. Fondi i akorduar njëjësive të vetëqeverisjes vendore prej 1 000 milionë lekësh, është realizuar në masën 88% ose 877 milionë lekë.

Fondi prej 500 milionë lekësh në zërin “Shpenzime kapitale” në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes u akordua 14 projekteve të bashkive fituese me vendim të Këshillit të Ministrave për DIGAT, sipas kritereve në aneksin 7, të këtij ligji. Për vitin 2024 nga vlera totale akorduar njëjësive të vetëqeverisjes vendore realizimi paraqitet në masën 55% ose 276 milionë lekë.

Në programin “Emergjencat Civile” (Artikulli 604) “Të tjera transfertë Korente të Brendshme”, për vitin 2024 Fondi për emergjencat civile në masën 800 milionë lekë akordohet në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpërndahet në formën e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me një formulë, e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Këto fonde në zbatim të VKM-së nr 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të Fondit të Kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile”, e ndryshuar me VKM-së nr. 290, datë 17.5.2023, përdoren nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas nevojave të tyre për kompensimin e qytetarëve të prekur nga Fatkeqësitë Natyrore ose për marrjen e masave parandaluese me blerje mallrash dhe shërbimesh ose blerje mjete specifike për mbrojtjen civile. Realizimi i këtij fondi për vitin 2024 është 74% ose 595 milionë lekë.

Gjithashtu me anë të Aktit Normativ Nr. 3, datë 28.08.2024, është çelur fondi prej 150 milionë lekë për kompensimet financiare të 1006 familjeve të prekura nga fatkeqësi natyrore të ndryshme në bashkitë Selenicë, Poliçan, Bulqizë, Kolonjë, Pogradec, Klos, Dibër, Librazhd, Mat, Kamëz, Peqin, Kurbin, Vorë, Tropojë, Kukës, Elbasan, Mallakastër, Krujë dhe Gramsh. Realizimi i këtij fondi (artikulli 604), paraqitet në vlerën 595,063,249 lekë ose 76%.

Fondi prej 200 milionë lekësh në zërin “Shpenzime kapitale” në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes përdoret për eliminimin e pasojave në rastet e fatkeqësive natyrore, kur shpenzimi ka natyrën e investimit. Ky fond shpërndahet gjatë vitit buxhetor në bazë të kërkesës së njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas rasteve të ndodhjes së fatkeqësisë.

Gjatë vitit 2024, Shqipëria ka vijuar me zbatimin e dokumentave strategjike në fushën e ZR, duke thelluar analizat e të dhënave sipas VKM nr.168 datë 24.03.2023 “Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror”, VKM nr.807 datë 28.12.2023 “Plani Kombëtar i Emergjencave Civile” dhe monitorimin e nivelit të zbatueshmërisë së këtyre akteve ligjore dhe nënligjore.

Në zbatim të nenti 47 të Ligjit 45/2019 dhe direktivës 2018/1972 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit me masa për të siguruar akses efektiv në shërbimet e emergjencës përmes komunikimeve emergjente në numrin e vetëm evropian të emergjencës '112', është finalizuar drafti i projektvendimin “Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112 (NUE), si guri i themelit për krijimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm të vendit.

Në kuadër të mbështetjes ndërkombëtare, vijon bashkëpunimi me UNDP, përmes projektit “Forcimi i aftësive ripërtëritëse në Shqipëri” (RESEAL II), i cili pas pilotimit të Qarkut Fier dhe 6 bashkive të tij, do të vijojë me Qarkun Shkodër dhe 5 bashkitë e saj për hartimin e kuadrit rregullator në fushën e menaxhimit të riskut në nivel lokal, sikurse me ofrimin e kapaciteteve operationale ndaj strukturave respektive.

Në kuadër të programit AlbAdapt “Për një zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri” është lidhur marrëveshja 6 vjeçare e grantit 4 milionë euro financuar nga GCF, lidhur ndërmjet AKMC dhe GIZ me 27.12.2024, përbën një tjetër garanci që po hidhen hapat e duhura për ngritjen e “Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm” ndaj shumë rreziqeve, me mbulim kombëtar për të krijuar, për herë të parë, një sistem të përshtatshëm, drejt veprimeve të hershme të bazuara në parashikime, duke u mundësuar sektorëve ekonomikë dhe komuniteteve lokale – të ndërmarrin veprime në avancë, në parapritje dhe në përgjigje të ngjarjeve. Ky program është mbështetur gjithashtu nga bashkëfinancimi i qeverisë shqiptare me vlerë prej 2.5 milionë euro.

9.4. Rekomandime për përmirësime të mëtejshme

- *Të dhënat e qëndrueshme lidhur me ngjarjet e fatkeqësive, dëmet, humbjet dhe shpenzimet financiare janë thelbësore për të vlerësuar riskun fiskal nga fatkeqësitë natyrore si dhe për të vendosur masat më të përshtatshme të mitigimit të këtij risku. Bashkëpunimet me ekspertë të modelimit të riskut janë gjithashtu të dobishme për të vlerësuar ekspozimin ndaj riskut në të ardhmen, duke konsideruar që risku i fatkeqësive natyrore për shkak të efekteve nga ndryshimet klimatike është në rritje. AKMC-ja dhe Ministria e Financave aktualisht po punojnë për zhvillime në këtë fushë.*
- *Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të ndërtuar dhe forcuar kapacitetet institucionale. Krijimi i sektorëve të dedikuar për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe zhvillimi i trajnimeve për stafet përgjegjëse për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe raportimin e riskut fiskal, është thelbësor në njësitë e qeverisjes qendrore dhe lokale.*
- *Zhvillimi i formateve të qarta të raportimit, duke përdorur formate të standardizuara për raportimin e ekzekutimit të buxhetit për fatkeqësitë natyrore, siguron qëndrueshmëri dhe krahasueshmëri nga njësitë raportuese.*
- *Përmirësimi i mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave është shumë i rëndësishëm, së bashku me përdorimin e teknologjisë. Krijimi i bazave të të dhënave të integruara nga niveli qendror në atë lokal dhe investimi në teknologji është i domosdoshëm për të pasur të dhëna në kohë reale dhe tregues të tjerë relevantë. Nevojitet rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë mbi riskun e fatkeqësive natyrore si dhe parapërgatitje financiare që mundëson reduktimin, menaxhimin dhe mitigimin e riskut nëpërmjet instrumenteve financiare, psh. policat e sigurimit.*

9.5. Sfidat

- *Paqartësia në role, miratimin e procedurave të veprimit, si dhe në vënien në funksion të të gjitha kapaciteteve njerëzore, financiare dhe teknike nga ministrinë e linjës dhe strukturat e sistemit operacional të mbrojtjes civile;*
- *Planifikimi i pamjaftueshëm i buxhetit për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në masën 2-4%, sikurse realizimi rezulton mesatarisht në masën 1.75%.*
- *Zbatimi në nivel shumë të ulët të VKM-së nr. 431, datë 15.07.2021 të ngritjes së sektorëve të dedikuar për mbrojtjen civile; Institucionet qendrore nuk kanë të përfshirë në strukturën e tyre burime njerëzore të dedikuara për mbrojtjen civile sipas fushës së përgjegjësisë. Disa institucione raportojnë për përfshirjen e pozicioneve për mbrojtjen civile, në sektorë për funksione të përbashkëta.*
- *Moszbatimi i "Parimit të subsidiaritetit" në koordinimin në nivel qarku për përdorimin e kapaciteteve që disponojnë strukturat e vetëqeverisjes vendore sipas nenit 7, të Ligjit 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" dhe mungesë sensibilizimi të popullatës;*
- *Pamjaftueshmëria e mjeteve dhe burimeve njerëzore e teknike nga MZSH-të e bashkive, strukturat e pyjeve dhe të AKZM;*
- *Nevoja për ushtrime, trajnime, veçanërisht për personelin operacional, i cili merr pjesë në shuarjen e zjarreve në pyje dhe operacionet e dhënies së ndihmës në rast përmytjesh;*
- *Sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit, infrastrukturës, djegiet e pakontrolluara, masat dhe pasojat që sjell si veprim;*

MINISTRI I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

Shtojca A

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike dhe analiza e ndjeshmërisë

Parashikimi i treguesve makroekonomik afatmesëm dhe i tërësisë së elementëve përbërës të kuadrit makroekonomik është bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik, mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukture qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomik brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve si INSTAT, BSH, MF, FMN, BB, Eurostat, etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme për të ndodhur, dhe maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Objektivat themelore të miksit të politikave fiskale e monetare përgjatë tre viteve në vijim, nëpërmjet të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimi sa më shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies të Bashkimit European, janë:

- Synimi i një trajektore rënëse të borxhit publik duke targetuar si objektiv operativ vjetor rikthimin e buxhetit në një balancë primare të balancuar ose me suficit prej vitit buxhetor 2024 dhe në vijim. Ky objektiv është ligjërish i detyrueshëm në LOB.
- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht mbi nivelin 5 përqind të PBB-së mesatarisht çdo vit.
- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektiv themelor i politikës monetare, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3.0 përqind, në një periudhë afatmesme dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli. Harmonizmin e politikës fiskale me këtë objektiv themelor dhe të politikës monetare me qëllim për të mbështetur rritjen afatgjatë ekonomike të vendit.
- Zbutja e deficitit të llogarisë korente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore, dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysHEME të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këto objektiva fundamentale përbëjnë konturet bazë të programit ekonomik e fiskal, brenda të cilave përcaktohen projeksionet dhe programohen të gjitha variablat e tjera makroekonomike e fiskale.

Analiza e ndjeshmërisë

Analiza e ndjeshmërisë paraqet ndikimet e pritshme në kuadrin fiskal, si dhe rregullimet e mundshme të politikave fiskale dhe ato buxhetore, sipas secilit skenar. Kjo është në përputhje me të dy skenarët alternativë makroekonomik të paraqitur në tabelën më poshtë.

Në rastin e skenarit makroekonomik “pesimist”, i cili supozon një rritje ekonomike dukshëm më të ulët për çdo vit krahasuar me skenarin “bazë”, do të ishte e arsyeshme dhe e përshtatshme për të supozuar efikasitet më të ulët të mbledhjes së taksave për një numër të komponentëve kryesor të taksave. Ndërsa, efektiviteti më i lartë i mbledhjes së taksave mund të pritet nëse do të ndodhë skenari makroekonomik “optimist”. Prandaj, për të llogaritur ndryshimet e mundshme në performancën e mbledhjes së të ardhurave nën secilin skenar alternativ, si dhe për të llogaritur “një efekt të përgjithshëm neto” të stabilizuesve automatikë, në rastin e skenarit pesimist afektohet “raporti i të ardhurave totale ndaj PBB-së” me një të tretën e goditjeve përkatëse (në pikë përqindje) të prezantuara në “rritjen reale” për çdo vit dhe në mënyrë asimetrike afektohet ky variabël me një të dhjetën në rastin e skenarit “optimist”.

Pajtueshmëria me rregullat fiskale në LOB dhe rrjedhimisht, politika fiskale e përgjithshme konsoliduese ruhet në çdo skenar makroekonomik. Sidoqoftë, objektiv i sasior i deficitit fiskal vjetor ndryshon në secilin skenar, duke reflektuar

kryesisht një përgjigje kundërciklike ndaj dinamikave të ndryshme të supozuara të ciklit ekonomik, sa herë që është e mundur në përputhje me rregullat fiskale. Më konkretisht, parashikohet një zbutje e objektivit të deficitit fiskal në rastin e skenarit “pesimist” dhe një konsolidim fiskal më i fortë në rastin e skenarit “optimist”.

Në skenarin “pesimist”, zbutja e politikës fiskale, krahasuar me skenarin “bazë”, do të materializohet deri në masën që të gjithë parametrat kryesor të financave publike (p.sh. raporti i borxhit ndaj PBB-së, bilanci primar dhe bilanci aktual) do të mbeten në të njëjtën kohë, në përputhje me të gjitha rregullat përkatëse fiskale të përcaktuara në LOB. Rregullimet (masat) e nevojshme të shpenzimeve për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat fiskale sipas skenarit “pesimist” kryhen në “shpenzimet e kapitalit me financim të brendshëm”, si dhe në “shpenzimet operacionale dhe të mirëmbajtjes”.

Në skenarin “optimist” të gjithë zërat diskrecionalë të shpenzimeve, në terma nominalë, supozohen identikë si në skenarin “bazë” dhe të gjitha të ardhurat e papritura reflektohen si një bilanc i përgjithshëm fiskal më i lartë (d.m.th. deficit më i ulët) për çdo vit, krahasuar me skenarin “bazë”.

➤ *Risku: Mosrealizimi/devijimi i parashikimeve nga skenari bazë*

Karakteristikat e riskut: Me anë të kuadrit makroekonomik e fiskal (KMF) përcaktohen përparësitë strategjike të qeverisë. Ai projekton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit, duke prezumuar ndikimet e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm që mund të ndikojnë në zhvillimet ekonomike në vend.

Impakti: (i ulët) Skenari bazë, miratuar me anë të dokumentit “KMF” vlerësohet të ketë probabilitet më të lartë për t’u materializuar. Megjithatë, parashikimi i skenarëve alternativë, duke supozuar se një pjesë e risqeve të ndryshme që rrethojnë skenarin bazë mund të materializohen, është një komponent i rëndësishëm i planifikimit të financave publike.

Masat e marra (mitigimi i riskut):

Në mënyrë që të rritet cilësia e planifikimit dhe të ketë një menaxhim më efikas të fondeve publike, në çdo situatë që ka një probabilitet të caktuar për të ndodhur, MF për çdo vit buxhetor përgatit dy skenarë alternativë, në mënyrë specifike një skenar “pesimist” dhe një skenar “optimist”. Secili nga skenarët alternativë supozon që një grup risqesh negative (në rastin e një skenari “pesimist”) ose risqesh pozitive (në rastin e një skenari “optimist”) do të materializohen.

Ky grup risqesh supozon devijime nga parashikimet në skenarin bazë për treguesit kryesor makroekonomik për periudhën afatmesme 2024-2027, duke përfshirë:

- Kreditimin e ekonomisë;
- Ecurinë e ekonomisë së Eurozonës me efektet që ka në eksportin e mallrave dhe të shërbimeve, në remitanca, në flukset e kapitaleve të huaja;
- Kursin e këmbimit;
- Normën e interesit;
- Ritmin dhe ndikimin e reformave të politikave strukturore të planifikuara për periudhën afatmesme etj.

Tabela A1. Supozimet alternative për secilin skenar

	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
					Fakt	Para.	Para.	Para.
Rritja reale e PBB (%)								
<i>Bazë</i>	-3.3	9.0	4.8	3.9	4.0	3.9	4.0	3.9
<i>Pesimist</i>						2.4	2.5	2.4
<i>Optimist</i>						4.4	4.5	4.4
Rritja nominale e PBB (%)								
<i>Bazë</i>	-3.3	12.7	15.2	10.2	6.8	5.1	5.2	5.1
<i>Pesimist</i>						3.2	3.4	3.3
<i>Optimist</i>						5.6	5.7	5.6


PBB nominale (miliardë lekë)								
Bazë	1,656	1,867	2,150	2,370	2,530	2,621	2,757	2,898
Pesimist						2,575	2,662	2,750
Optimist						2,633	2,783	2,940
Norma efektive e interesit të Borxhit Publik (%)								
Bazë	3.2	3.0	3.0	3.6	4.0	4.7	4.6	4.5
Pesimist						4.7	4.6	4.5
Optimist						4.7	4.6	4.5
Kursi i Këmbimit Nominal, mesatar (Lek/Euro)								
Bazë	123.8	122.5	119.0	108.8	100.7	100.0	100.0	100.0
Pesimist						100.0	100.0	100.0
Optimist						100.0	100.0	100.0
Totali i të Ardhurave (% PBB)								
Bazë	25.7	27.4	26.6	27.2	28.1	28.9	29.0	29.3
Pesimist						28.4	28.5	28.8
Optimist						28.9	28.9	29.3
Totali i Shpenzimeve (% PBB)								
Bazë	32.4	31.9	30.3	28.5	28.8	31.5	30.8	30.8
Pesimist						30.6	30.4	30.8
Optimist						31.4	30.7	30.7
Shpenzimet Korente (% PBB)								
Bazë	25.4	24.7	23.3	23.1	24.0	25.0	24.7	24.5
Pesimist						25.2	24.9	25.1
Optimist						25.0	24.5	24.2
Shpenzimet Kapitale (% PBB)								
Bazë	6.1	6.9	5.2	5.0	4.6	6.2	6.1	6.1
Pesimist						5.1	5.4	5.4
Optimist						6.2	6.2	6.2
Balanca Fiskale (% PBB)								
Bazë	-6.7	-4.6	-3.6	-1.3	-0.7	-2.6	-1.9	-1.6
Pesimist						-2.2	-2.0	-2.0
Optimist						-2.4	-1.7	-1.4
Balanca Primare (% PBB)								
Bazë	-4.6	-2.7	-1.8	0.7	1.4	0.0	0.7	0.9
Pesimist						0.5	0.5	0.5
Optimist						0.2	0.8	1.0
Borxhi Publik Bruto (%PBB)								
Bazë	73.9	74.1	64.1	57.5	55.2*	54.8	54.0	53.2
Pesimist						55.0	54.6	54.4
Optimist						54.1	52.8	51.6
Borxhi Publik Neto nga gjendja e likuiditetit në TSA (% PBB)								
Bazë	73.5	70.2	63.5	55.5	51.6	53.1	52.5	51.5
Pesimist						52.6	53.0	53.4
Optimist						51.5	50.6	49.4

Burimi: Ministria e Financave (2025)

*Niveli i borxhit bruto për vitin 2024 është në përputhje me parashikimet në “Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2026-2028”.

Niveli aktual i borxhit për vitin 2024 qëndron në 54.0% të PBB-së.

Grafiku A2. Dinamika e treguesve kryesor në skenarë të ndryshëm



Shtojca B

Risqet fiskale të ndërmarrjeve shtetërore të monitoruara nga MF për vitin 2024, (Përshkrimi i risqeve dhe masat e marra/masat e pritshme).

Për vitin 2024, Ministria e Financave ka monitoruar periodikisht mbi baza tremujore, performancën financiare të NSH-ve kryesore me qëllim evidentimin e impaktit potencial që këto ndërmarrje mund të kenë mbi buxhetin e shtetit. Ndërmarrjet të cilat rezultojnë me një performancë financiare pozitive janë: OSHEE Group, OST, UKT, Albcontrol, dhe APD. Ndërkohë ndërmarrjet me performancë të ulët janë: KESH, HSH, AlbGaz, RTSH, Albpetrol dhe Posta Shqiptare. Në mënyrë të përmblëdhur, paraqiten risqet financiare evidentuar gjatë vitit 2024 si dhe masat e marra/pritshme për zbutjen e tyre listohen si më poshtë.

Tabela B1. Risqet fiskale për vitin paraardhës për ndërmarrjet shtetërore

Ndërmarrjet	Përshkrimi i risqeve	Masat e marra / Masat e pritshme
<u>OSHEE Group sh.a</u>	- Risku i detyrimeve të larta të trashëguara si rezultat i performancës negative financiare të shoqërisë gjatë periudhës 2009–2014 (kur shoqëria administrohej nga shoqëria CEZ a.s.) si dhe humbjet financiare në vitin 2021, si pasojë e krizës globale energjetike. - Problemet financiare të trashëguara kanë rritur së tepërmi riskun e likuiditetit.	- Masat e marra nga shoqëria në drejtim të uljes së shpenzimeve operative kanë përmirësuar performancën dhe ulur riskun financiar. - Plani i OSHEE Group në uljen e detyrimeve të prapambetura. Pavarësisht vështirësive me likuiditetet, shoqëria arriti të ulë detyrimet e prapambetura, kryesisht detyrimet ndaj furnitorëve (investime dhe materiale të trashëguara nga vitet e kaluara) si dhe një pjesë të detyrimeve të prapambetura ndaj KESH sh.a.
<u>KESH sh.a</u>	- Risku i Tregut të Energjisë, si pasojë e luhatjeve të çmimeve të energjisë në bursat globale. - Risku Hidrik, si pasojë i ndryshimeve klimatike dhe periudhave të thata/situatave jo të favorshme hidrike, vitet 2019, 2020 dhe 2022. - Risku i portofolit të prodhimit, si mungesë e burimeve të diversifikuara. - Risku i likuiditetit.	- Blerje në avancë të energjisë me qëllim garantimin e rezervës hidrike. - Pas ndërtimit të impiantit gjenerues fotovoltai në Digën e Qyrasqit-HEC Vau i Dejës, shtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese me burime të diversifikuara, si ndërtimi i impiantit PV Diga e Zadejës-Vau i Dejës dhe impiantit PV lundruar në liqenin e Vaut të Dejës. - Intensifikimi i shkëmbimit të energjisë veçanërisht me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), duke siguruar rezervë energjetike reciproke ndërmjet palëve në periudhat e nevojshme.
<u>OST sh.a</u>	- Risku nga ndryshimet në tarifën e nevojshme të transmetimit të energjisë elektrike. - Risku nga ndryshimet në çmimet e tregut për blerjen e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe kostot e tjera të energjisë elektrike. - Risku nga ndryshimet e kurseve të këmbimit. - Risku i likuiditetit.	- Për minimizimin e riskut të tarifës së transmetimit, OST sh.a. në mënyrë periodike aplikon në ERE për tarifën e nevojshme të transmetimit, tarifë e cila reflekton kostot e aktivitetit të OST sh.a. - Lidhur me riskun e çmimit të blerjes së humbjeve, OST sh.a., me fillimin e operimit të Bursës Shqiptare të Energjisë, ka marrë masat për të siguruar fondet për blerjen e sasisë së nevojshme të humbjeve në transmetim.
<u>UKT sh.a</u>	- Kushtet atmosferike. - Dëmtimi i linjave të shpërndarjes. - Mungesa e likuiditetit afatshkurtër. - Risku i kordinimit ndërsektorial në përgatitjen edhe analizimin e dokumentacionit financiar dhe kontabël.	- Spostimi i linjave, shtyrja e punimeve në kushte të pafavorshme atmosferike dhe kryerjen e kontrolleve të vazhdueshme nga sektorët përkatës. - Krijimi i alternativave të reja për furnizim me ujë. - Menaxhimi në kohë i dosjeve dhe dokumentacionit financiar. - Hartimi dhe mbajtja e regjistrit të riskut.

Ndërmarrjet	Përshkrimi i risqeve	Masat e marra / Masat e pritshme
<u>Hekurudha Shqiptare sh.a</u>	- Risku i Likuiditetit dhe paaftësia për të përballuar detyrimet financiare të prapambetura. - Risku nga dështimi në reformimin strukturor dhe zbatimin e ndarjes funksionale sipas ligjit. - Risku i vonesave dhe paaftësisë për të përthithur investime në infrastrukturën hekurudhore.	- Miratimi i ligjit që synon përshejtimin dhe qartësimin e procesit të ndarjes funksionale të HSH-së. - Miratimi i urdhërave ministror nr. 286 datë 19.11.2024, si dhe nr. 300 dhe 301 datë 27.11.2024, për vendosjen e kuadrit rregullator për ndarjen reale të funksioneve midis operatorëve dhe menaxherit të infrastrukturës hekurudhore, në përputhje me kërkesat e BE-së. - Miratimi i VKM Nr. 848/2024 për miratimin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2025.
<u>Posta Shqiptare sh.a</u>	- Dobësi në gjenerimin dhe mbledhjen e të ardhurave. - Risku financiar dhe i likuiditetit. - Shpenzime të larta operative dhe mungesë investimesh.	- Rritja e transparencës dhe forcimi i kontrollit të brendshëm. - Modernizimi teknologjik dhe automatizimi i proceseve. - Zhvillimi i kapaciteteve dhe kultura e integritetit.
<u>AlbGaz sh.a</u>	- Mosrealizimi i të ardhurave dhe mungesa e likuiditetit. - Varësia nga dividendi si burimi kryesor i të ardhurave, rrit ekspozimin ndaj faktorëve jashtë kontrollit të shoqërisë.	- Ulje e kostove operative përmes reduktimit të stafit. - Rritje të disiplinës fiskale, me realizim të plotë të të ardhurave të planifikuara dhe përdorim efikas të fondeve për të siguruar stabilitet afatshkurtër.
<u>Albcontrol sh.a</u>	- Risku i bllokimit të të ardhurave si pasojë e ekzekutimit të dy vendimeve të arbitrazhi kundër Republikës së Shqipërisë. - Risku i likuiditetit, apo pamjaftueshmëri për të përmbushur detyrimet financiare dhe zhvillimore. - Risku i mosrealizimit të shpenzimeve/investimeve të planifikuara si rrjedhojë e mungesës së likuiditetit.	- Ndjekje aktive e procesit në gjykatë me mbështetje nga Avokatura e Shtetit dhe Eurocontrol. - Sigurimi i financimit nga aksionari dhe vlerësimi i burimeve të tjera të financimit. - Shtyrje e përkohshme e shpenzimeve dhe investimeve. - Sigurimi i fondeve alternative për vitin raportues.
<u>Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)</u>	- Risku i tejkalimit të planit të shpenzimeve si rezultat i shpenzimeve që nuk mund të parashikohen. - Risku i arkëtimit me vonesë të të ardhurave.	- Masa në drejtim të planifikimit të shpenzimeve vjetore. - Marrëveshje të reja me debitorët për shlyerjen në kohë të detyrimeve. - Masa në drejtim të uljes së konsumit të energjisë dhe për kontrollin e konsumit në përgjithësi.
<u>Albpetrol sh.a</u>	- Risku i likuiditetit. - Risku i kreditimit. - Siguria mjedisore dhe teknike gjatë shfrytëzimit të vendburimeve të naftës.	- Monitorimi në mënyrë të vazhdueshme i flukseve monetare aktuale. - Përmirësime në drejtim të vlerësimit të riskut të kreditimit. - Monitorim në mënyrë të vazhdueshme të risqeve mjedisore.
<u>Autoriteti Portual Durrës (APD)</u>	- Risku i fillimit me vonesë të investimit strategjik për Portin e Ri të Integruar në Porto Romano. - Risku i arkëtimit me vonesë të të ardhurave. - Risku i tejkalimit të planit të shpenzimeve. - Risqet e lidhura me koncesionet, mbi mosdeklarimin e saktë të volumeve të punës dhe të ardhurave të krijuara. - Risqet fiskale të lidhura me fatkeqësi natyrore (tërmeti).	- Rihapje brenda vitit të procedurës së prokurimit për Portin e Ri të Integruar, për të minimizuar vonesën e nisjes së investimit strategjik. - Ndryshime në buxhet për të akomoduar shpenzime shtesë nga arbitrazhet. - Marrëveshje të reja me debitorët për shlyerjen në kohë të detyrimeve. - Monitorim i vazhdueshëm i kontratave nga APD dhe Forca e Sigurisë. - Masa për menaxhimin e risqeve nga fatkeqësitë natyrore (sigurimi i ndërtesave, planifikimi i fondeve).

Burimi: Ministria e Financave (2025)

Shtojca C

SOE Health Check Tool (HCT)

Nëpërmjet SOE HCT, performanca e NSH-ve vlerësohet mbi disa parametra ndërkombëtarë si: niveli i likuiditetit, treguesit e borxhit (solvency), përfitueshmëria etj., të cilat grupohen në 5 kategori (**Kategoria 1/Risk i ulët** - **Kategoria 5/Risk i lartë**).

Çfarë ofron SOE HCT:

- Vlerëson performancën dhe risqet financiare për NSH (max 40 NSH).
- Në bazë të disa parametrave ndërkombëtarë, NSH kategorizohen dhe vlerësohen sipas nivelit të tyre të riskut.
- Mundëson raporte, grafikë dhe matricën e riskut për të analizuar ndërmarrjet shtetërore.
- Rezultate mbi qëndrueshmërinë financiare të sektorit të NSH-ve.

Disa nga kufizimet në përdorimin e SOE HCT janë:

- Analiza mbi baza vjetore, duke limituar përdorimin e tij për vlerësimin e pasqyrave financiare 3-mujore.
- Monitorimi i treguesve financiarë të miratuar, pa gjeneruar të dhëna mbi parashikime financiare.
- Përdor të njëjta tavane risku për të gjithë portofolin e NSH-ve, edhe pse risqet variojnë sipas sektorëve.
- Përpunon të dhëna deri në 40 ndërmarrje për një periudhë kohore deri në 15 vite.

Rasti Studimor 1. Ndërmarrjet Shtetërore të Sektorit Energjetik

Më poshtë jepet një analizë mbi ecurinë financiare të portofolit të sektorit energjetik për periudhën 2020-2024, duke përdorur SOE HCT.


Tabela C1. Matrica e Riskut (2020-2024), sipas SOE HCT

Treguesit Financiarë (Mesatarja e Ponderuar Për Të Gjithë Portofolin)							
	2020	2021	2022	2023	2024		
Përfitueshmëria						Kategoria 5 Kategoria 4 Kategoria 3 Kategoria 2 Kategoria 1	Risk i Lartë ↑ ↓ Risk i Ulët
Kthimi mbi Aktivët (ROA)	(0.02)	(0.01)	(0.03)	0.04	0.02		
Kthimi mbi Kapitalin (ROE)	(0.04)	(0.03)	(0.09)	0.10	0.08		
Rikuperimi i Kostos	0.97	0.98	0.88	1.24	1.11		
Likuiditeti							
Raporti Korent	0.79	0.87	0.86	0.94	0.91		
Raporti i Shpejtë	0.73	0.80	0.81	0.89	0.85		
Aftësia Paguese							
Borxhi Total ndaj Aktiveve	0.58	0.60	0.62	0.58	0.70		
Borxhi Total ndaj Kapitalit	1.36	1.48	1.61	1.37	2.28		
Mbulimi Cash i Interesit	2.87	2.34	(1.09)	5.99	4.71		
Niveli i Përgjithshëm i Riskut - Mesatarja e Ponderuar*	4.15	4.08	4.38	3.15	3.38		

Burimi: Ministria e Financave 2025, SOE HCT

Sipas Matricës së Riskut, vërehet që, gjatë viteve 2020-2022 Sektori Energjetik ka dëshmuar një nivel të lartë risku, ku ‘Vlerësimi i përgjithshëm i riskut’ arrin nivelet 4.15 – 4.38 (**Kategoria 4**). Këto vite përkohë me periudhën e shpalljes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike. Ndërkohë, për vitet 2023-2024 shihen përmirësime të situatës financiare, ndonëse të lehta, me një nivel të përgjithshëm risku 3.15 – 3.38 (**Kategoria 3**), kjo kryesisht si rezultat i përmirësimeve në treguesit e përfitueshmërisë. Gjatë vitit 2024, shoqëritë e sektorit energjetik kanë rezultuar me fitim neto pozitiv, megjithatë në vlera më të ulëta se ai i vitit 2023, duke konsideruar rënien e lehtë të raporteve të përfitueshmërisë. Kjo ndikuar nga kushtet meteorologjike në vend, ku pjesa e fundit e vitit pati mungesë reshjesh duke u shoqëruar me një rënie të të ardhurave. Ndërkohë, likuiditeti mbetet treguesi më me risk i shoqërive, dhe vlerat e tij nën 1 sinjalizojnë mungesë të aktiveve për të mbuluar detyrimet. Për sa i përket borxhit dhe aftësisë paguese, treguesit përkatës dëshmojnë një nivel risku të moderuar (**Kategoria 3**). Portofoli i sektorit energjetik vijon të mbështetet në vlera të konsiderueshme në huamarrje, dhe pavarësisht aftësisë së mirë në mbulimin e interesit, ka një mungesë të qëndrueshmërisë financiare.

Grafiku C1. Treguesit financiar për Sektorin Energjetik për periudhën 2020-2024, sipas SOE HCT



Burimi: MF 2025, SOE HCT

Në grafikët e mësipërm vërehet që, për vitin 2024:

- Marzhi neto dhe marzhi operativ kanë patur një trend rënës krahasuar me vitet paraardhëse. Kjo rënie i atribuohet nivelit të të ardhurave të shoqërisë KESH sh.a për shkak të kushteve klimatike.
- Treguesit e borxhit (Solvency) kanë patur një rritje të lehtë, krahasuar me vitet parardhëse.
- Raportet e mbulimit të interesit dëshmojnë për një gjendje të mjaftueshme likuiditeti, për të përmbushur detyrimet ndaj kreditorëve të jashtëm (interesat).
- Aftësia e sektorit për të mbuluar detyrimet A-SH është në rritje, mbështetur nga rënia e lehtë e detyrimeve afatshkurtra dhe rritja e lehtë e aktiveve afatshkurtra.

Rasti Studimor 2. Ndërmarrjet Shtetërore kryesore të monitoruar jashtë Sektorit Energjetik

Më poshtë jepet një analizë mbi ecurinë financiare të portofolit të NSH-ve kryesore të monitoruara, jashtë sektorit energjetik për periudhën 2020-2024, duke përdorur SOE HCT.

Tabela C2. Matrica e Riskut e NSH-ve kryesore të monitoruara, jashtë sektorit Energjetik (2020-2024), sipas SOE HCT

Treguesit Financiar (Mesatarja e Ponderuar për të gjithë portofolin e NSH-ve kryesore të monitoruar, jashtë Sektorit Energjetik)					
	2020	2021	2022	2023	2024
Përfitueshmëria					
Kthimi mbi Aktivët (ROA)	(0.03)	0.00	(0.01)	0.01	0.02
Kthimi mbi Kapitalin (ROE)	(0.04)	0.00	(0.01)	0.01	0.03
Rikuperimi i Kostove	0.68	1.05	0.97	1.09	1.24
Likuiditeti					
Raporti Korent	1.42	1.25	1.25	1.31	1.35
Raporti i Shpejte	1.24	1.12	1.13	1.20	1.26
Treguesit e Borxhit (Solvency)					
Detyrimet ndaj Aseteve	0.23	0.24	0.25	0.29	0.29
Detyrimet ndaj Kapitalit	0.30	0.31	0.34	0.40	0.41
Mbulimi Cash i Interesit	(3.52)	16.07	5.05	5.63	(16.33)
Vlerësimi i Përgjithshëm i Riskut	3.00	2.13	2.75	2.13	2.38

Kategoria 5
Kategoria 4
Kategoria 3
Kategoria 2
Kategoria 1

Risk i Lartë
↑
↓
Risk i Ulët

Burimi: Ministria e Financave 2025, SOE HCT

Tabela C3. Matrica e Riskut të NSH-ve kryesore të monitoruar, jashtë sektorit Energjetik për vitin 2024, sipas SOE HCT

Vlerësimi i risqeve të NSH-ve (2024)									
	Përfitueshmëria			Likuiditeti		Treguesit e Borxhit (Solvency)			Vlerësim i Përgjithshëm i Riskut
	Kthimi mbi Aktivitet (ROA)	Kthimi mbi kapitalin (ROE)	Rikuperimi i Kostove	Raporti Korrent	Raporti i Shpejtë	Detyrimet ndaj Aseteve	Detyrimet ndaj Kapitalit	Mbulimi Cash i Interesit	
Albpetrol	Kategoria 4	Kategoria 4	Kategoria 4	Kategoria 3	Kategoria 2	Kategoria 2	Kategoria 1	Kategoria 5	Kategoria 3
UKT	Kategoria 2	Kategoria 1	Kategoria 2	Kategoria 5	Kategoria 4	Kategoria 3	Kategoria 3	Kategoria 1	Kategoria 3
Albcontrol	Kategoria 1	Kategoria 1	Kategoria 5	Kategoria 1	Kategoria 1	Kategoria 3	Kategoria 4	Kategoria 5	Kategoria 2
HSH	Kategoria 4	Kategoria 4	Kategoria 4	Kategoria 5	Kategoria 5	Kategoria 1	Kategoria 1	Kategoria 1	Kategoria 3
RTSH	Kategoria 5	Kategoria 5	Kategoria 5	Kategoria 5	Kategoria 5	Kategoria 3	Kategoria 4		Kategoria 5
APD	Kategoria 2	Kategoria 3	Kategoria 3	Kategoria 4	Kategoria 3	Kategoria 1	Kategoria 1	Kategoria 1	Kategoria 2
AlbGaz	Kategoria 4	Kategoria 4	Kategoria 5	Kategoria 1	Kategoria 1	Kategoria 2	Kategoria 2		Kategoria 3


Shënim: NSH janë në rend zbritës sipas vlerës së detyrimeve në bilancin përkatës

Për vitin 2023, nuk ka pasur raportim nga ndërmarrjet Posta Shqiptare sh.a. dhe Ujësjellës Kanalizime Rajonale Durrës (UKRD). Mos raportimi i të dhënave financiare në kohë nga ana e subjekteve të sipërpërmendura argumentohet me vonesat në miratimin e pasqyrave të tyre financiare.

Burimi: Ministria e Financave 2025, SOE HCT

Sipas Matricës së Riskut në tabelën nr.2, vërejmë që vitet 2020 dhe 2022 kanë dëshmuar një nivel mesatar risku, ku ‘Vlerësimi i përgjithshëm i riskut’ arrin nivelet 3.00 dhe 2.75 (**Kategoria 3**). Këto vite përkojnë me periudhën e vështirë të pandemisë Covid-19, ndikimet e së cilës janë ndjerë përgjatë vitit 2020, si dhe me efektet e krizës globale energjetike, luftës në Ukrainë, luhatjeve të çmimeve të energjisë, karburanteve dhe inputeve, ndjerë kryesisht përgjatë vitit 2022. Ndërkohë, gjatë vitit 2023, shihet një përmirësim i ndjeshëm i situatës financiare me një nivel risku mesatar 2.13 (**Kategoria 2**), situatë e cila vijon dhe vitin 2024, ku niveli i riskut, ndonëse ka një rritje të lehtë, vijon dhe qëndron në kategorinë 2 dhe përgjatë këtij viti. Si në portofolin e energjisë dhe në portofolin e ndërmarrjeve të tjera shtetërore, likuiditeti vijon të mbetet një tregues që paraqet risk të lartë. Për shumicën e ndërmarrjeve, viti 2024 tregon nivele të ulëta përfitueshmërie, për shkak të realizimit të ulët të të ardhurave, megjithatë duhen konsideruar dhe karakteristikat individuale të ndërmarrjeve, ku disa janë në fazë investimesh, disa në proces ristrukturimi, ndërsa të tjera kanë pasur aktivitet të ulët gjatë periudhës raportuese etj. Ndërsa treguesit e borxhit paraqesin përgjithësisht risk në nivele mesatare për shumicën e ndërmarrjeve.

Grafiku C2. Treguesit financiar të NSH-ve kryesore të monitoruara jashtë Sektorin Energjetik për periudhën 2020-2024, sipas SOE HCT



Burimi: MF 2025, SOE HCT

Në grafikët e mësipërm vërehet që, për vitin 2024:

- Marzhi neto dhe marzhi operativ kanë patur një trend rritës krahasuar me vitet paraardhëse. Kjo rritje i atribuohet shtimit të të ardhurave nga aktivitetet kryesore dhe financiare të shoqërive.
- Treguesit e borxhit (Solvency) kanë patur një trend në rënie, krahasuar me vitet parardhëse.
- Raportet e mbulimit të interesit dëshmojnë për një gjendje të pamjaftueshme likuiditeti, për të përmbushur detyrimet ndaj kreditorëve të jashtëm (interesat).
- Aftësia e ndërmarrjeve për të mbuluar detyrimet A-SH është në rritje, mbështetur nga rënia e lehtë e detyrimeve afatshkurtra dhe rritja e lehtë e aktiveve afatshkurtra.

Shtojca D

Tabela D1. Informacioni i mëposhtëm paraqet përdorimin e buxhetit sipas natyrës së riskut për secilën nga bashkitë që kanë raportuar. (në lekë)

Nr	Bashkitë	Buxheti i përdorur Risku i Përmblytjeve		Buxheti i përdorur Risku i Zjarreve		Buxheti i përdorur Multirisk		Buxheti i përdorur Risku i Rrëshqitjeve		Buxheti i përdorur Risku i Tërmetit		Totali bashkive
		Shpenzime (602-604)	Investime 231	Shpenzime (602-604)	Investime 231	Shpenzime (602-604)	Investime 231	Shpenzime (602-604)	Investime 231	Shpenzime (602-604)	Invensti me 231	
1	Lezhë	2,920,431		5,498,451		124,986		1,794,480				10,338,348
2	Kukës			2,267,002						19,453,640		21,720,642
3	Dropull		2,477,829					2,266,346				4,744,175
4	Korcë		47,634,285	8,131,853		11,263,560						67,029,698
5	Finiq		18,407	1,745					9,537			29,689
6	Has		47,112,200	2,501,137		490,986						50,104,323
7	Librazhd	5,215,249	15,881,800	1,674,800				1,141,461		299,838		24,213,148
8	Kurbin	15,156,690										15,156,690
9	Maliq		52,278,046	3,000,000		4,562,412						59,840,458
10	Shkodër	2,467,584	21,439,496	15,879,560								39,786,640
11	Pukë		2,008,084	800,000								2,808,084
12	Rrogozhinë	6,000,000										6,000,000
13	Durrës	3,884,500		9,962,577					5,541,743			19,388,820
14	Lushnje			2,160,480								2,160,480
15	Patos			5,215,980					19,844,810			25,060,790
16	Gjirokastër	4,468,404							34,541,507			39,009,911
17	Krujë	27,847,772	11,410,200	3,084,816								42,342,788
18	Tiranë		32,261,028	62,163,235								94,424,263
19	Elbasan	19,089,830	19,766,820	3,652,398		5,165,382		583,000		6,932,602		55,190,032
20	Devoll	3,750,000		430,577								4,180,577
21	Libohovë			320,005								320,005
22	Kolonjë	838,800				1,845,600						2,684,400
23	Përmet	356,944	9,296,664	1,541,610		462,000		601,428				12,258,646
24	Roskovec	2,045,541	17,959,626	300,201				1,503,840				21,809,208
25	Dimal				4,800,000							4,800,000
26	Klos					1,680,701	105,913,248			1,954,612		109,548,561
27	Mirditë	1,572,696		2,369,614								3,942,310
28	Prrenjas	2,665,634	28,248,888	535,179								31,449,701
29	Vau i Dejës		19,518,283	294,918					2,847,585	2,524,367		25,185,153

30	Tropojë	466,900	11,722,209	3,803,512		712,140						16,704,761
31	Gramsh									6,911,898		6,911,898
32	Skrapar							43,611,639	600,000			44,211,639
33	Divjakë	6,223,313										6,223,313
TOTALI		104,970,288	339,033,865	135,589,650	4,800,000	26,307,767	105,913,248	51,502,194	63,385,182	38,076,957		869,579,151

Burimi: AKMC 2025